


# HEJZA



**Shqiponja Axhami Trota, shkrimtare**  
***LETËRSIA IME NISI NGA NJË MUNGESË***

Nën thjerrë

# DOZIMI I KULTURËS

**A e kuptuan ndonjëherë politikanët shqiptarë se, në asnjë pyetësor, në asnjë program e strategji të pushtetit maqedonas nuk flitet për kulturën shqiptare në Maqedoninë e Veriut. Gjithandej prezantohet, propagandohet dhe nënvizohet se këtu frymon vetëm kultura maqedonase e cila ka "mirëkuptim" për përpëlitjet kulturore marginale të bashkësive të tjera etnike**



**Nga Avni HALIMI**

Në Komisionin parlamentar për kulturë, më vitin 2010, shpesh u loz loja e njëjtë politike "me një të ramedy të vramë"! Së fundmi, shumica etnike parlamentare maqedonase përfitoi pikë politike te ndërkom-bëtarët, ndërsa sërish e provokoi nervozizmin te shqiptarët duke ua nxjerrë në shesh mosnjohuritë mbi mënyrën e zhvillimit dhe avancimit të jetës kulturore në vend. Komisioni në fjalë, veç të tjerash miratoi edhe shënimin e disa përvjetorëve me rëndësi historike e kulturore për shqiptarët e vendit. Jo po na u deshtën nëntë manifestime të tilla, jo po mjaftojnë vetëm pesë, jo po u shpreh diskriminimi kulturor kundër shqiptarëve, jo po partia shqiptare në pushtet paskësh arritur që me këto pesë shënime ta ndërrojë karakterin e shtetit të Maqedonisë së Veriut prej shtetit monokulturor në atë shumëkulturor! Këto batuta edhe një herë dëshmuar për diletantizmin kulturor të deputetëve shqiptarë! Disa ditë më vonë, pastaj, do të pasojnë titujt e shkrimeve si dhe deklaratat e deputetëve shqiptarë në Parlament se, Ministria e Kulturës nuk i përfill vendimet e Parlamentit për sa i përket shënimin të përvjetorëve historike e kulturore shqiptare. Nëse nuk përkrahen edhe kësaj radhe këto vendime të Parlamentit të Maqedonisë, atëherë ashiqare paskemi të bëjmë me diskriminim

kulturor që po e ushtruaka kjo Ministri kundër shqiptarëve të Maqedonisë së Veriut! Kështu rezonohej atëbotë! Po a do të binte poshtë ky konstatim i pamohueshëm nëse do të financoheshin pesë përvjetorët që i kërkoniin deputetët shqiptar? Avazi vazhdon!

**Parlamenti nuk është OJQ**

Deputetet shqiptarë assesi të kuptojnë se kjo me këto shënime përvjetorësh është vetëm një bllof i ulët dhe asgjë tjetër! Sepse, Parlamenti nuk është organizatë joqeveritare që merret me të tilla aktivitete, sepse Parlamenti nuk aplikon dhe nuk konkurren në asnjë sektor të Ministrisë së Kulturës, sepse Parlamenti çdo vit, një muaj më parë miraton buxhetin vjetor të Qeverisë, rrjedhimisht edhe atë të Ministrisë së Kulturës, buxhet ky që hartohet në bazë të projekteve, programeve të subjekteve të ndryshme por edhe në bazë të prioriteteve nacionale të kësaj Ministrie, sepse Parlamenti miraton Ligjin për shpenzim të buxhetit dhe, tek pas një muajve, si rëndomë, debaton për shënime historike e për aktivitete nacionale kulturore. Deputetët shqiptarë duhet të dinë se ky Komision parlamentar ka obligim që të përcjellë zbatimin e programit nacional të Ministrisë së Kulturës dhe jo të aplikojë me projekte në këtë Ministri. Përvjetorët shqiptarë asnjëherë nuk konsiderohen si aktivitete që përfshihen në strategjinë për kulturë nacionale, ndaj dhe qeveria nuk reagon me

buxhet shtesë për aktivitete të tilla "të paparashikueshme"! Kurse Ministria e Kulturës vazhdimisht përgjigjet se "askush nuk mund t'i imponojë aktivitete e projekte për të cilat paraprakisht nuk janë ndarë buxhet nga ana e komisioneve që me muaj punojnë për programin nacional të Ministrisë". Deputetët shqiptarë duhet t'i japin fund lojës e cila nga deputetët maqedonasë shfrytëzohet sa për t'i dëshmuar aftësitë e tyre manipulative. "Pjetër Bogdani" (nën këtë emër ishte ngritur iniciativa për themelimin e Institutit për trashëgimi kulturore dhe shpirtërore të shqiptarëve-Shkup) është Institucioni më i thirrur për të vlerësuar se cilët përvjetorë do të mund të shënoheshin, se cilat aktivitete nacionale do të mund të organizoheshin në sferën e kulturës. Natyrisht, edhe asociacionet e ndryshme kulturore, ansamblet, edhe shoqatat historike, edhe fakultetet, edhe universitetet, edhe komuna dhe katunde, të gjithë mund të organizojnë përvjetorë përkatës, aktivitete kulturore, promovime e tubime shken-core, madje pa marrë leje dhe pa priturr miratime as nga Parlamenti dhe as nga asnjë institucion tjetër shtetëror. Ndërsa financimi i tyre sigurohet ose me donacione, ose me sponsorizime, ose nga buxheti shtetëror. Por, për të përfituar nga ky buxhet paraprakisht duhet të aplikohet dhe të konkurrohet në konkursin për programin nacional, në rastin konkret, të Ministrisë së Kulturës. Kurse për t'i shtyrë ato

projekte përpara, këtu duhet të këmbëngulin anëtarët shqiptarë nëpër komisionet e Ministrisë së Kulturës, që janë të deleguar nga partitë që participojnë në pushtet. Partitë, ashtu siç këmbëngulin në kalimin e domosdoshëm të një libri të dobët që mund të jetë i një militanti partiak, ashtu mund të këmbëngulin edhe në kalimin me buxhet te respektueshëm të përvjetorëve që shënojnë ngjarje apo personalitete kombëtare.

**Programi nacional për kulturë pa kulturë shqiptare**

Moskalimi i projekteve shqiptare, apo kalimi i tyre në numër minimum gjithsesi që është një diskriminim kulturor ndaj shqiptarëve, i cili po ushtrohet në mënyrë permanente dhe tepër ortodokse! Pa dyshim që diskriminimet kulturore në mënyrë kaq klasike si te ne mund të hasen vetëm në politika të egra nacionale e raciste. Kjo politikë në ditët e sotme botën e civilizuar do ta tmerronte deri në palcë, atëherë, pse nuk ka dhe nuk shprehet asnjë shqetësim për këtë diskriminim nga vëzhgues e diplomatë perëndimorë që veprojnë te ne, sidomos nga ata faktorë që janë mburojë dhe përkrahës të denjë të diversitetit kulturor! Nuk ka shqetësim nga "faktorët monitorues", sepse nuk ka ankesa serioze nga "shqiptarët" në pushtet, të cilët, gjithnjë e më shumë po mburren se ia kanë dalur që Maqedoninë e Veriut ta shndërrojnë

në shtet multietnik e multikulturor! Shoqatat dhe individët e ndryshëm shqiptarë vazhdimisht ankohen dhe reagojnë për moskalim të projekteve "kombëtare"! Eliminimi i diskriminimit kulturor ndaj një etnie duhet të jetë brengë dhe punë e subjektit politik që participon në pushtet dhe jo e një shtëpie botuese apo i një asociacioni minor e entuziast. Diskriminimi kulturor duhet të parandalohet që në strategjitë politike që fshihen nëpër programet nacionale! Ish-ministrja për Kulturë, Elizabeta Kançevska Milevska, me t'u emëruar në këtë post lëshoi një letër qarkore deri te të gjithë institucionet kulturore të vendit që janë shfrytëzues të buxhetit shtetëror, prej të cilëve kërkoi që sa më parë të përgjigjen me shkrim për prioritetet kulturore në periudhën e ardhshme katërvjeçare 2011-2015. Nëse një i huaj e lexon me kujdes këtë "gjest" do të mrekullohet nga gatishmëria e kësaj Ministrie për të investuar në avancimin dhe në ruajtjen e diversitetit kulturor në vend. Në atë "manifest elizabetian" ka plotë teori, plot përkushtime për mbrojtjen dhe avancimin e vlerave kulturore të bashkësive të tjera etnike! Në botën e civilizuar ministritë përkatëse përkujdesen për institucionet nacionale, ndërsa asociacionet kulturore dhe organizatat jofitimprurëse përkujdesen që të sigurojnë sa më shumë donacione dhe përkrahje për projektet kulturore! Aktualisht, në Maqedoni funksionojnë rreth 120 institucione kulturore shfrytëzues të buxhetit! Prej tyre nja 5 a 6 janë që menaxhohen nga drejtorë shqiptarë. Është shumë e arsyetueshme që këta drejtorë të shtrojnë më shumë prioritetet dhe të kërkojnë më shumë për t'u avancuar vlerat kulturore të shqiptarëve të këtushëm. Por, që në start do të cunohen e masakrohen ato prioritetet shqiptare. Ky program nacional me këta prioritetet kulturore pastaj shtrihet në kuadrin e planit pesëvjeçar që paraqitet si strategji nacionale e qeverisë së vendit. Edhe nga kjo strategji faktorët ndërkombëtarë mbesin gojëhapur! Aty do të hasen plotë teori për angazhimin

e qeverisë për avancim dhe përkrahje të çdo kulture në çdo cep të vendit, për ruajtjen dhe mbrojtjen e trashëgimisë kulturore, për përkujdesje të veçantë për artistë e kulturologë të vendit, për ruajtjen me xheloz të vlerave të mirëfillta kulturore... Në të mirë të kësaj propagande antishqiptare do të jenë edhe prononcimet e politikaneve tanë të papërgjegjshëm që për t'i ruajtur përfitimet nga të qenët në pushtet do të deklarojnë se, situata e përgjithshme e shqiptarëve të Maqedonisë së Veriut është shumë e mirë ndaj të gjithë duhet të angazhohemi në zgjidhjen e konteksteve ndër-kombëtare të shtetit për euro-integrimet që e presin! Këta politikanë dhe subjektet e tyre partiake, duke qenë të kënaqur me financimin e dy-tre librave, me financimin e dy-tre shfaqjeve teatrale, me financimin e dy-tre koncerteve amatore, nuk çanë kokë për atë se çka po i ndodhë Institutit për Trashëgimi Kulturor të Shqiptarëve të Maqedonisë, si u dëbua nga selia e vet, në Kurshumli-han, fare nuk u "shqetësuan" nga prezantimi promovues i dhjetëra asociacioneve kulturore maqedonase, i artistëve maqedonas, nga mbajtja e qindra ditëve kulturore ekskluzivisht maqedonase nëpër botë që u organizuan përgjatë viteve 2010-2011! A e kuptuan ndonjëherë politikanët shqiptarë se si u plotësua Pyetësori për implementimin e Konventës së UNESCO-s e vitit 2005! Në asnjë raport, në asnjë pyetësor, në asnjë program e strategji të pushtetit maqedonas nuk flitet për kulturën shqiptare në këtë hapësirë. Gjithandej prezantohet, propagandohet dhe nënvizohet se këtu frymon vetëm kultura maqedonase, e cila ka "mirëkuptim" për përpëlitjet e kulturave të bashkësive të tjera etnike margjinale! Kur të kihet parasysh të gjitha këto fakte - kush mund të jetë ai sagllam njeri që mund të vlerësojë se, mosshënimi i një date të rëndësishme shqiptare nuk duhet të na zmbrapsë nga angazhimi kombëtar për ta zgjidhur çështjen e flamurit, pastaj të emrit, pastaj të konteksteve kulturo-historike me bullgarët etj. "Shqiptarët" e

Parlamentit të Maqedonisë prioritet i kishin këta probleme, ndërsa maqedonasit e Gruevskit e të Zajevit kishin për prioritet ngulftatjen e çdo kulture tjetër në të mirë të kulturës së tyre që do t'ua zgjidhë çështjen e shtetit komb!

#### Përçmimi institucional i kulturës

Nëse i bëjmë një krahasim zhvillimeve të ndryshme shoqërore në raport me zhvillimet kulturore te ne, sakaq do të dilnim të përfundimi se, fatkeqësisht, jemi për t'u vajuar! Nuk mund të thuhet se nuk kemi korniza ligjore për sa i përket jetës së gjithmbarshme kulturore. I kemi, madje janë në harmoni të plotë me kërkesat ligjore evropiane. Strategjitë nacionale për kulturë, i kemi, janë të mahnitshme në lexim të parë! A kemi mekanizëm kontrollues, mbikëqyrës, motivues, mbi të gjitha, sanksionues, kundër neglizhuesve dhe sabotuesve të këtyre ligjeve dhe strategjive? Janë mijëra e mijëra godina banesore, janë qindra mijëra biznese, qindra korporata, qindra institucione shëndetësore, bankare etj. I tërë ky zhvillim në fakt paraqet vetëm "zhvillimin e manipulueshëm", mundësinë e përfitimëve të mëdha të oligarkëve, por edhe mundësinë e përfitimëve shtetërore nga taksat! Nga ana tjetër, nuk kemi institucione kulturore rishtas të themeluara! Kemi dy-tre teatro private, dy-tre manifestime private, nja dhjetëra shtëpi botuese që përkujdesen për botimin e librit; nuk kemi operë, filarmoni, balet, nuk kemi institucione kërkimore kulturore. Nuk i kemi sepse kërkojnë kosto të paimagjinueshme, të papërbalueshme për buxhetet shtetërore, ndonëse, tërë ky "mastraf" do të mund lehtësisht të përballohej vetëm nga konfiskimi i pasurive të fituara pandershmërisht, nga ndëshkimi i korrupsionit dhe përfitimëve të ndryshme në rrugë jolligjore. Shqipëria dhe Kosova tashmë e kanë edhe Ligjin për sponsorizim të kulturës rinisë dhe sportit, ligje këto që krijojnë përshtypjen se, intenca e shtetarëve tanë është që më shumë të tallen me kulturën se sa ta ndihmojnë! A nuk është ky një përçmim insti-

tucional që i bëhet kulturës?! Ky ligj do të duhej të ishte enkas për kulturën, pastaj le të ketë ligje të ngjashme edhe për rininë dhe sportin etj. Sepse, këto ligje gjithëpërfshirëse, nuk kanë ravigëzuar bie fjala, kufirin në mes të kulturës dhe argëtimit. Së këndejmi, aktivitetet argëtuese-sportive nuk mund të jenë jetë kulturore! Ligjet në fjalë, sponsorizuesve të aktiviteteve rinore e sportive u njihet zbritja tridhjetë për qind (30%) nga tatimi në fitim. Kurse, për aktivitetet kulturore kjo zbritje prek vetëm njëzet përqindëshin (20%)! Ligji i ngjashëm ekziston edhe në Maqedoninë e Veriut! Pse nuk kemi sponsorizim të aktiviteteve gjurmuese-arkelgjike, të repertorit të një filarmonie, të një opere, të një baleti, nuk kemi sponsorizim të një shfaqje teatrale, të botimeve ekskluzivisht të talenteve të reja; pse nuk kemi një ekspozitë të sponsorizuar, nuk kemi koloni artistësh, nuk kemi një manifestim letrar gjithëkombëtar! Sepse, të gjitha këto aktivitete janë elitare dhe nuk u krijojnë kurrfarë përfitimë sponsorizuesve. Prandaj, sponsorizuesit i kemi të pranishëm më tepër tek estrada argëtuese-zbavitëse, e cila, nuk paraqet kurrfarë aktiviteti kulturor. Sepse, një aktivitet i estradës siguron masë të gjerë vizitorësh, ku edhe reklama për donatorin është më masovike, kurse një ekspozitë pikturash mund të sigurojë maksimumin nja 1000 vizitorë! Një libër mund të vërehet se është donuar, më së shumti nga nja 30-50 lexues dhe, reklamimi i sponsorizusit shkon vetëm tek ky numër i popullit! Sponsorizimi i aktiviteteve kulturore, me prioritetet të caktuara institucionalisht, do të duhej që "t'i amnistonte" nga tatimet të gjithë subjektet që dëshirojnë të kontribuojnë në jetën gjithmbarshme kulturore. Shteti ka mekanizma për ta kontrolluar këtë sponsorizim dhe për t'u lehtësuar nga financimi i të gjitha atyre aktiviteteve që ndihmohen nga dashamirët e kulturës! Kjo do të krijojë një garë ndër-biznesore si dhe një koegzistencë të mrekullueshme biznes-kulturë, në interes të zhvillimit të gjithmbarshëm shoqëror!

## Qasje

# FAN S. NOLI DHE SIMBOLIZMI

**Vargjet noliane duket sikur u ngjajnë tingujve të Wagnerit. Dridhjet dhe tonet janë origjinale dhe të veçanta karshi poetëve bashkëkohës që kanë praninë e këtij tipari nëpër poezitë e tyre. Poezia e Nolit është lirike, por nuk është e butë, ajo buçet, është e fortë**

#### Bujar MEHOLLI

Shumë simbolistë e mbështesnin idenë se i gjithë arti duhet të aspirojë me gjendjen muzikore, e cila konsiderohej si mediumi emocional më i drejtpërdrejtë estetik. Ky muzikalitet u arrit përmes poezive simbo- like me ritëm, aliteracion, asonancë dhe zbukurime retorike. Kur flasim për simbolizmin vlen të përmendet kompozitori francez Claude Debussy i cili ishte shumë i lidhur me këtë drejtim. Ai kompozoi disa poezi dhe poema të Bodlerit dhe Mallarmesë. Poema "Pasditja e një fauni" e këtij të fundit u kompozua nga Debussy që arriti të bëhet figurë qendrore e muzikës përmes simbolizmit, sikurse kompozitori gjerman Richard Wagner për të cilin u interesuan shumë poetët simbolistë. Fan S. Noli i dëgjonte me pasion këta kompozi-

torë dhe vihet nën ndikimin e simbolizmit kur bën art. Për këtë ndikim, Rexhep Qosja te Panteoni i rralluar shprehet: "Intonimi muzikor i vargjeve të tij flet qartë sesa shumë ishte nën ndikimin e simbolistëve. Kjo vërehet edhe në futjen e ideve të tij politike brenda kornizës së simboleve të Biblës. Prej këtyre dy fakteve mund të shihet, gjithashtu, sesa bukur e ka ditur ai kahun e zhvillimit të poezisë bashkëkohore dhe sesa i ri është treguar me ndjeshmërinë e vet poetike".

Simbolistët e shihnin poezinë të lidhur fort me muzikën. Ata ishin të mendimit se poezia është superio- re të muzika dhe se aty ajo merr kuptim diskursiv. Mallarme kishte bindjen se letërsia është art suprem dhe se muzika ka premisa të jetë kulti i fundit plenar i njeriut. Ky poet simbolist ëndërronte ta kri-

jonte një religjion të ri, ritet e së cil- it do ta kishin burimin te ndërthurja e vallëzimit, poezisë dhe muzikës. Vargjet noliane duket sikur u ngjajnë tingujve të Wagnerit. Dridhjet dhe tonet janë origjinale dhe të veçanta karshi poetëve bashkëkohës që kanë praninë e këtij tipari nëpër poezitë e tyre. Poezia e Nolit është lirike, por nuk është e butë, ajo buçet, është e fortë. Përmes këtij stili, Noli harmonizon përmbajtjen dhe formën. Përveç muzikalitetit, tipare tjera kryesore të artit poetik nolian janë, siç i përmendëm, simbolet me domethëniet e tyre dhe forma (rima, ritmi, toni, struktura sintaksore). Me përsëritjet e ndryshme në fjalë, tinguj e shprehje, Noli mund ta ndërtojë atmosferën e vargut me "temperamentin poetik vullkanik" siç shprehet studiuesi dhe kritiku Mensur Raifi, i cili thotë se Noli shkroi

poezi me tone apolegjetiko-retorike: "Fan S. Noli ka shkruar vjersha patriotike, satirike dhe elegjiake me tone apolegjetiko-retorike. Temperamenti i tij poetik "vullkanik" trajtoi në poezi "kazuistikën personale" të kryeministrit të qeverisë që doli nga revolucioni demokratik borgjez i qershorit të vitit 1924 në Shqipëri". Duke qenë se Fan S. Noli ishte i lidhur me muzikën qysh në fëmijëri, ky formim nuk është i rastësishëm, andaj ai i kushtoi rëndësi të madhe ritmit në ato pak poezi që shkroi. Gjurmimi në poezinë popullore shqipe po ashtu ishte ndikues në poetikën noliane, sepse poezia popullore siç dihet është mjaft e pasur me ritëm dhe formë të brendshme. Këtë e vë në pah edhe profesori dhe albanologu Eqrem Çabej kur thotë: "Është një influencë e madhe e poezisë popullore mbi shkrimtarin.

Kjo shpjegohet me lidhjen e ngushtë që ka poezia popullore me jetën shpirtërore të këtyre popujve. Poezia popullore është ndër këta e gjallë e produktive, prandaj komponentja e këngës popullore është kudo e dukshme. Kjo influencë shprehet në lëndë, në formën e përbrendshme, në ritëm, metrikë si dhe në veçantira. Dhe kjo influencë popullore vërehet në vargun nolian, i cili përputhet me brendinë dhe me ndjenjat e mendimet që shfaqen duke arritur melodinë ritmike. Vargu merr kadenca ritmike të ndryshme, nganjëherë ngjitëse, nganjëherë zbritëse, herë me ashpërsi herë me butësi, duke kumbuar herë si varg epik, herë si lirik. Për ta organizuar vargun, Noli e vë theksin te ritmi i vargjeve, duke i mbushur me larmi që i bën ato të gjalla artistikisht. Për ta arritur këtë ritëm përdor rimën në mënyrë që t'i shpreh mendimet. Po ashtu përsëritja është një veçanti për organizimin e vargut. Noli përsërit nganjëherë të njëjtën zanore dhe bashkëtingëllore duke

krijuar ngjyrim të veçantë muzikor dhe përcim të ndjenjave, si në këto raste:  
Ti na çthure, na çkule, na çduke çdo fe (Marshi i Barabbajt)  
Kryetrim, që lëfton, triumfon për at-dhe (Marshi i Krishtit)  
Simbolisti Stefan Mallarme, botën e shihte si simbol dhe gjuhën si shenjë të saj. Religjioni pati një reflektim të veçantë në veprën e tij poetike. Sikurse Noli, Mallarme interesohej për liturgjinë meshtarë dhe lidhjet e njeriut me hyjnoren. Duke qenë një botë e tërë mistike e mbushur me sekretet spirituale, ajo ka si drejtues poetin i cili e gjen frymëzimin te religjioni dhe këtë tërheqje përpiqet që ta transmetojë përmes vargjeve te lexuesi. Në këtë rol, Fan S. Noli zgjodhi figurat më të spikatura të letërsisë gojore e popullore dhe i përdori në mënyrë që më lehtë t'i tërheq lexuesit drejt botës së tij, me figura si aliteracioni e anafora ai i bëri vargjet melodioze dhe si të tilla ato ishin të përshtatshme edhe për t'u mbajtur në mend edhe për t'u transmet-

uar nëpër popull. E shohim se këto përsëritje paraqiten shpesh, madje ato fitojnë mëvetësi dhe pavarësi për t'u bërë karakteristika të poezisë së Nolit. Përsëritja e thjeshtë brenda një vargu është mjaft e përdorur, nuancat e së cilës ndryshohen varësisht si në këto vargje:  
Pres një shenj' e pres një dritë... (Anës lumenjve)  
Pranë vatrës, pranë punës... (Anës lumenjve)  
Ky ilaç e ky kushtim, më bën djal' e më bën trim... (Anës lumenjve)  
Dhe pastaj anafora në vargjet si:  
Na e vran' e na e shanë... (Syrgjyn-vdekur). Edhe përdorimi i zanores "o" e rrit ndjeshëm muzikalitetin kur Noli e përdor varësisht, herë në fillim herë në mes, herë në fund. Nëse shohim letërsinë popullore hasim mjaft përdorime të tilla nga të cilat Noli u ndikua dhe i përdori që përveç muzikalitetit t'i përforcojë ndjenjat dhe mesazhet:  
O vënd e vatr' o nën' e babë... (Hymni i flamurit)  
Thirr e zbraz, o gurma: Hosanna,

hossana! (Marshi i Krishtit)  
O i fort' o i urt' o i ëmbël Jesu... (Marshi i Krishtit)  
Poezia del e përsosur për sa i përket strukturës formale të saj ndër-sa përmes muzikalitetit lidhet me simbolizmin, i cili në thelb kishte kundërvënien ndaj artit tradicional. Është ky tipari kryesor që poezinë e Nolit e lidh me simbolizmin, kur fjala shfrytëzohet për t'i arritur efektet muzikale e kuptimore. Fan S. Noli, si intelektual i angazhuar në jetën politike dhe sociale, bëhet përfaqësues tipik i idealeve që janë në kundërshtim me klasën politike që ishte në pushtet. I pajisur me dituri të gjerë, ai e bëri poezinë qëllim të përhapjes së ideve, shfaqti përjetimet personale dhe përmes sarkazmit goditi klerin reaksionar dhe anakronizmin. Lirikat e tij u ndërtuan duke u shfrytëzuar simbolet biblike dhe alegoria që ngjizen me realitetin shqiptar të atyre viteve kur jetoi dhe krijoi Fan S. Noli.



*Për HEJZËN flet Shqiponja Axhami Trota, shkrimtare*

# LETËRSIA IME NISI NGA NJË MUNGESË

**Raportin e një shkrimtari me atdheun, mund ta përkufizoj një si nëmë, që të ndjek ngado. Një nëmë para së cilës ti duhet të jesh në rrallë të parë i vetëdijshëm dhe në radhë të dytë i devotshëm, që ta shndërrosh në bekim**

## Shkëlzen HALIMI

Shqiponja Axhami Trota u lindi në Shtiqën të Kukësit (1977). Ka mbaruar studimet në Universitetin e Tiranës, Dega gjuhë - letërsi. Aktualisht jeton në Mbretërinë e Bashkuar.

Ka shkruar disa libra me poezi dhe prozë: "Psherëtima pranë shelgut lotues" (novelë, Prishtinë, 2008), "E imja kjo rrugë" (poezi, botimet Vllamasi, 2009), "Fantazma me fustan të kuq" (roman, botimet Vllamasi, 2012), "Vajza dhe lulekamomili"

(përralla për fëmijë, botimet Vllamasi, 2013), "Udha e zogjve" (poezi, Klubi i Poezisë, 2015), "Zoti zbret mbi jaseminë" (poezi, Onufri, 2016), "Këngë për brezin tim" (poezi, Uegen, 2021), "Pengu i një varrmihësi", (trëgime, Uegen 2022) dhe "Fundit i Us-

kanës" (roman, Buzuku, 2024). "Zoti zbret mbi Jasemine" është botuar edhe në gjuhën angleze nga Shtëpia botuese Europa Edicione dhe në gjuhën italiane nga Shtëpia botuese Besa Editrice.



**HEJZA:** Libri Juaj i fundit që kohë më parë u botua nga Shtëpia botuese "Buzuku" (Prishtinë), mban titullin "Fundit i Uskanës". Pse pikërisht Uskana dhe çfarë Ju motivoi ta shkruani këtë roman?

**SH. AXHAMI TROTA:** E vërtetë, vetëm para pak javësh doli nga shtypi romani im, "Fundit i Uskanës". I jam mirënjohëse zotit Abdullah Zeneli, Shtëpisë botuese "Buzuku" dhe gjithë skuadrës së saj. Uskana, ose Hyscana, ishte një qytet i lashtë, i cili shtrihej në territorin e fisit Ilir, Penestë. Ky qytet antik supozohet se ka qenë në afërsi të qytetit të sotëm të Kërçovës. Më tej, historia e këtyre vendeve, pushtimet romake, osmane, sllave, dyndjet, barbarizmat, deri në masakrat e vonshme mbi shqiptarë, më krijuan sfondin e duhur ku të vendosja ngjarjet e romanit dhe t'i jepja kahen e duhur idesë dhe qëllimit të tij. Nga ana tjetër, fryma që mbart romani, një gjendje mes piskamës, ofshamës, vajit, por dhe këngës, i përshpërndanë emri Uskanë. Emri Uskanë tingëllon si një ofshamë drejt shpërbërjes në tingull. Ndër-

sa motivi që më ka nxitur të shkruaj këtë roman, është e tëra ime në një fis, fshat dhe vend i destinuar të jetë varr i përjetshëm, nën një absurd enigmatik, zanafillash, religjionesh, pushtimesh, diktaturash, pseudo-demokracish etj... Pak njerëz mund të kenë një "fat" të tillë. Unë i përkas një brezi që na u desh të rritemi mes shumë mungesash, frikash dhe paradoksesh, që as sot nuk arrijmë t'i shpjegojmë dot. Për shembull, nëse nga radioja ime ngjyre kafe (emri i saj, 30 - vjetori i çlirim-it), dëgjoja propaganda antifetare, "se si të zhdokim nga rrënjët mbetjet fetare", nga cepi i dhomës më grishnin lutjet e gjyshes, një Zoti, që unë nuk duhej ta përmendja me zë të lartë. Nga ana tjetër, motra e madhe më urdhëronte ta shoqëroja që të lidhnim të ligjt e të mbjellave, Ditën e Verës. Ndërsa mbyllja ditën duke ndërtuar aeroplanë me gazetën, "Zëri i popullit", dhe duke përsëritur refrenin e këngëve që këndonin nëna ime, mbi vek. Por, thellë-thellë brenda vetes rreksha të gjeja një shpjegim; kujt i lutej gjyshja dhe pse i lidhte me penj mizat, motra... Të shtrira nën një këndvështrim

tredimensional, këto mungesa, frika, makthe, paradokse rithes, besimesh, që shpesh herë ngatërrohen me njëra-tjetrën sa shpërftyrojnë dhe të vërtetën, zanafillën, më shtynë që të shkruaj këtë roman.

**HEJZA:** Kur kuptuat se letërsia është ajo që të shtrëngon në shpirt. Si ishin fillimet e Juaja të para në botën magjike të fjalës artistike?

**SH. AXHAMI TROTA:** Letërsia, ose fjala në art, erdhi tek unë ditën kur nuk mundja të dëgjoja më këngët e nënës. Ajo iku herët nga kjo botë, kur unë isha rreth 12-vjeç. Dhe ato rima, ato këngë, unë nisa t'i shpik dhe t'i shkruaj në një fletore diktimi, me bindjen prej fëmije, që ajo i lexonte. Orvatja për të mbushur hapësirën e një mungese me një lëndë amorfë, fluide, që çon në shndërrimin e gjendjes, bën atë që një ekip më i zgjuar se unë e quajmë, arti i fjalës. E tillë nis letërsia ime, nga një mungesë, ashtu siç dhe ju e theksoni në pyetje "diçka që shtrëngon në shpirt." Më vonë mbaj mend që kam nisur të shkruaj proza të shkurtra, por dhe poezi, një prej të cilave ka qenë ajo

me titull "Roja". Një poezi me fjalë të thjeshta që fliste për një roje, që nuk na linte të merrnin fruta nga një fermë poshtë shtëpisë... Poezinë e kam të rishkruar, përpunuar, në librin me poezi, "Këngë për brezin tim". Në këtë përmbledhje përfshihen të gjitha ngjarjet e fëmijërisë, ato që kanë lënë më shumë varr brenda meje.

**HEJZA:** Fati deshi që të jetoni larg Shqipërisë, por kjo nuk do të thotë se Ju i keni shkëputur lidhjet me Atdheun. Si do ta përkufizonit raportin e shkrimtarit me Atdheun?

**SH. AXHAMI TROTA:** Shpresoj që të ketë qenë "fati", ai që më grishi që të lë dheun e atit. Por, mendoj që fatin e bëjnë rrethanat. Në rrethanat aspak të përshtatshme për një jetë të sigurt dhe më të mirë, duke m'u mbyllur shumë dyer, deri dhe dyer ministrash etj, jam detyruar që të marr rrugën e mërgimit. Dhe prej disa vitesh jetoj si rezidente në Mbretërinë e Bashkuar. Por, lidhjet me atdheun nuk shkëputen asnjëherë. Këtu, përpara së të dëgjojmë BBC - në, në dëgjojmë lajmet në shqip. Edhe ëndrrat i shohim në vendlindje. Ndjaj janë të pashkëputshme lidhjet me vendin e lindjes. Ndërsa raportin e një shkrimtari me atdheun, mund ta përkufizoj një si nëmë, që të ndjek ngado. Një nëmë para së cilës ti duhet të jesh në rrallë të parë i vetëdijshëm dhe në radhë të dytë i devotshëm, që ta shndërrosh në bekim.

**HEJZA:** Larg atdheut, larg vlerave kulturore të kombit, me valixhet plot kujtime, ndrydhur në vetmi e përmallime, lemerisur nga pesha e përbalueshme e asimilimit - ky është motivi krijues, apo është ai fat që i ndjek të mërguarit për të bërë letërsi të mirëfilltë?

**SH. AXHAMI TROTA:** Është e vërtetë, larg atdheut pëshpëlllohes nga një tis i zymtë gjendje, disi i tjetërsuar, nën peshën e një amullie të parajetë, vetmie, mungese, etj. Por, nuk mendoj që kjo peshë duhet të jetë motiv krijues. Një shkrimtar mund të ndihet i vetmuar edhe në atdheun e vet. Vetmia, malli, kujtimet i bëjnë rrethanat krijuese më vitale, por nuk duhet të ndikojnë në thelbin e të bërit një letërsi të mirëfilltë. Letërsinë unë e ndjej dhe shoh në një perceptim tredimensional dhe bërje. Për mua të qenët e përmallur, nuk më grish të shkruaj për mallin, por rrekem të gjej disa gjendje, që varen nga vetëdija dhe nënvetëdija dhe që çojnë drejt tij, mallit, në këtë rast. Për shembull, "Zonja Kler", është tregimi im i fundit. Më kujtohet se në ditët kur e kam shkruar këtë tregim, kam qenë e ngarkuar emocionalisht, pozitivisht. Në fakt "Zonja Kler", është një grua që vuan nga Alzheimeri dhe përpigjet të shpjegojë paradoksin e jetës së saj, mes harresës dhe kujtesës. Jeta e saj është tmerrsisht e vrazhdë. Kështu që, të paktën për mua, një gjendje shpirtërore më sjell një gjendje krejt tjetër në të shkruar dhe as vetë nuk arrij ta kuptoj se përse. Por, gjithsesi mendoj se shkrimtari është i destinuar të qëndrojë pezull, mes të qenët një homosapiens në një gjendje të caktuar shpirtërore dhe një homosapiens i "çmendur", që orvatet t'i afrohet një gjendjeje të mbinatyrshe, hyjnore, si derivat i gjendjes së krijimit. Përsa i përket "fatit" që e ndjek

një të mërguar për të bërë letërsi të mirëfilltë, po, e drejtë. Është krejt e natyrshme që një autor i mërguar të rreket të shkruaj një letërsi moderne, me parametra universalë të tematikës, subjektit etj. Por një shkrim, prozë apo poezi, letërsia në përgjithësi, sipas mendimit tim, nuk mund ta identifikojë kurrë një autor, nëse ai shpërfill vlerat më të jashtëzakonshme që burojnë nga folku, kultura, që mbart dhe trashëgon nga vendi i tij i lindjes. Do të mjaftonte një baladë, thelbi i saj, që një autor të shkruante një kryevepër me parametra universal. Përshatja e lëndës së shkruar, e shijes së kultivuar estetike, pa iu shmangur qasjes fillestare, që zë fill tek gjeneza individuale, trashëgimia kulturore, është motivi që duhet të nxisë çdo shkrimtar, që jeton në një vend të huaj. Kjo do të tërhiqte vëmendjen e lexuesit të huaj.

**HEJZA:** Cili është raporti i atdheut me krijuesit shqiptarë të diasporës? Shtëpitë tona botuese që i kemi me bollëk, dinë gjë për këta shkrimtarë, apo nisin e i njohin sapo ndonjëri prej tyre të shpreh gatishmëri për vetëfinancim të veprave të veta? A mendoni se vetëfinancimi i botimeve është një "korrupsion kulturor", i cili duhet të ndiqet, madje edhe me mbyllje të shtëpisë botuese nga organet përkatëse shtetërore?

**SH. AXHAMI TROTA:** Termi raport ka të bëjë me përpjesëtimin e dy a më shumë anëve, dukurive, etj. Gjykuar në këtë sens unë "fatkeqësisht" bëj pjesë në anën e krijuesve të diasporës, por nuk mund t'i imponohem anës tjetër, atdheut tim, për sa kohë e kam braktisur atë. Gjithsesi, unë e kuptoj thelbin e pyetjes. Mbështetja, vlerësimi, promovimi i artistëve, shkrimtarëve të diasporës është një vlerë e shtuar dhe besoj e domosdoshme për çdo vend, E kundërta do ta linte në hije të mjerueshme, përjetësisht...Se sa është arritur dhe sa bëhet në këtë pikë, nuk di të përgjigjem saktë, ose më shkoqur preferoj të hesht. Përpara se t'i përgjigjem pjesës tjetër të pyetjes, dua të theksoj që shtëpitë botuese në Shqipëri dhe më gjerë janë "fatkeqe". Problematika më e madhe e tyre besoj qëndron në faktin mjerues, që ato nuk mbështeten sa duhet nga institucionet shtetërore, ministritë etj. Këtu e kam fjalën për tri dekadat e fundit pas rënies së diktaturës. Nëse do të kuptosh se sa i zhvilluar është një qytet, duhet të shohësh se sa biblioteka ka dhe sa cilësore i ka ato. Nëse një grup turistësh do të vizitonte çdo bashki të çdo qytetit në Shqipëri, do të mahnitej me luksin dhe bukuritë e zyrave dhe do të lemerisej me "katastrofën" e bibliotekave. Gjykuar në këto rrethana, një shtëpi botuese, me shumë pak lexues të interesuar për librin, është e destinuar të mbijetojë dhe si e tillë, pranon çdo lloj "paçavure" kontrate dhe botimi. Nëse shtëpitë botuese do të kishin një bashkëpunim të shëndetshëm me institucionet shtetërore, uljen e taksave, shpërndarjen e librit nëpër bibliotekat e shkollave ato të qytetit, situata do të ishte ndryshe. Kështu që unë këtë "korrupsion kulturor", siç e quani ju, e shoh gjetkë, zanafilla e tij është aty ku qëndron thelbi i çdo kombi, shteti. Përpara së organet përkatëse shtetërore të mbyllin një shtëpi botuese, ato duhet të hapin një bibliotekë.



Dhe, përmes një hierarkie bindëse institucionale, hartimit të planeve për mbështetjen financiare të shtëpive botuese, kontrollit të cilësisë dhe shpërndarjes së librit, sidomos të teksteve shkollore, do të arrihej ajo që ju denonconi, asgjësimi i "korrupsionit kulturor" dhe zëvendësimi i tij me zhvillimin kulturor.

**HEJZA:** A e ka thënë akoma fjalën e vet kritika letrare për krijimtarinë që po zhvillohet në diasporë. Apo, janë dy vlera që po ecin paralelisht dhe assesi të takohen diku sy më sy!

**SH. AXHAMI TROTA:** E thashë edhe në fillim të intervistës, unë i përkas një brezi të rritur mes frikash dhe mungesash. Kjo fjalë - "kritikë", më kujton fletë - rrufetë kur mbanim më shumë se një lopë, duke mos e dorëzuar në kooperativë, ose kur thyenim rregullat e sistemit, etj. Më e keqja ishte se jo vetëm që të ngjitej emri, fotoja (në këto fletë-rrufe), por kush kalonte bënte shkarravina mbi to, ose shkruante fjalë të pista...Përballë fletë-rrufëve vendoseshin tabelat e nderit. Për dreq edhe këtu nëse të dilte fotoja, emri, ishe i destinuar të prisje reagimet dashakeqe, shkarravina, fjalë të pista etj. Kështu që mendoj se sado t'i bësh kritikën e mirë ose kritikën e keqe një veprë letrare, do të ketë zëra që i mëshojnë të kundërtës. Por, nuk qëndron këtu problemi. Problemi, sipas mendimit tim, qëndron në faktin që, kritika mund të bëhet vetëm për gjëra të kapshme konceptualisht, numerikisht, etj. Arti qëndron mbi këto parametra, ndaj sado të përpiqesh t'i bësh kritikën e duhur, do mбетesh disi larg thelbit. Gjithsesi, këtu ku jetoj unë ka shkolla të kritikës letrare, që nxjerrin individë që zhbirojnë në skajet më të epërme të një veprë letrare, duke e përgatitur lexuesin për atë që i ofron kjo vepër. Këto për kritikën në përgjithësi. Ndërsa përsa i

përket pyetjes që ju bëni, kur kritika letrare shqiptare do të institucionalizohet përmes shkollave të parametrave evropiane, kur institucionet akademike do të bëjnë të duhurën dhe doktoraturat nuk do të jena ofshama plagjiature, atëherë mund të japim një përgjigje të saktë. Gjithsesi, meqë jemi në këtë pikë, dua të theksoj një fakt të çuditshëm që ndodh këtu në Britani. Një qendër e zhvillimit të letërsisë në West Midlands, Birmingham, ku unë jam pjesë e një grupi prej disa vitesh, "kritikat" për një vepër të shkruar fillojnë me analiza të thjeshta mes shkrimtarësh, në formën e një takimi çaji, "Literary Saloon", etj. Janë analiza të thjeshta mes shkrimtarësh që përgëzojnë autorin dhe tërheqin lexuesit e ftuar. Nuk jam në dijeni nëse këto takime organizohen në Shqipëri. Unë në Shqipëri kam miq, autorë të njohur të prozës dhe poezisë, që kanë mbajtur dhe mbajnë poste të rëndësishme shtetërore, ministri, ambasada dhe mund të bëjnë diçka në lidhje me krijimin e një imazhi të besueshëm në promovimin e vlerave të mirëfillta letrare.. Sot fjala është e lirë, nuk jemi edhe aq të varfër sa para 30 vjetësh, atëherë pse e kërkojmë problemin gjetkë, "nuk funksionoka kritika letrare", kur nuk arrijmë të bëjmë vetë një gjë të tillë, mes miqve. Është e vërtetë, një autor është natyrë e ndjeshme dhe nuk mund të jetë kurrë një kritik i jashtëzakonshëm. Kritika kërkon njerëz të ftohtë, strikt, por një grup autorësh që mblidhen e flasin për një vepër, mund të ketë një efekt të madh tek një grup lexuesish, që i ndjek me adhurim. Ndaj, nëse kritika letrare nuk e paska thënë fjalën e saj për krijimtarinë në përgjithësi, por edhe për krijimtarinë që po zhvillohet në diasporë, pse të mos e bëjmë ne, autorët për njëri-tjetrin. I kam ndjekur me vëmendje dhe i përgëzoj disa shkrime eseistike të disa autorëve që shkruajnë për autorë të tjerë.

**HEJZA:** Në hapësirën shqiptare ambienti letrar fatkeqësisht që moti është kontaminuar me lloj - lloj mbeturinash, që dukshëm ia kanë zënë frymën letërsisë së mirëfilltë. Sot kemi më shumë botime se lexues, kemi diletantizëm, injorantë dhe çka jo tjetër? Vlerat e vërteta u përmbysën për shkak se demokracia vazhdon të trajtohet me mjete të anarkisë. Pse ndodhi kjo dhe si ta dekontaminojmë këtë ambient letrar?

**SH. AXHAMI TROTA:** Ne si popull kemi kaluar një diktaturë të ethshme 45 vjeçare. Më tej, 30 vite në një demokraci të çekuilibruar dhe të brishtë. Ne kemi qenë të babëzitur për çdo gjë, mish, qumësht, djathë, padyshim edhe për lirinë e fjalës. Siç e theksova, këto 30 vite "demokraci" nuk janë shumë që të ngopemi. Një diktaturë e ethshme 45- vjeçare lë pasojat e saja tek një popull, edhe atë për një kohë të gjatë. Mund të ndodhë që edhe pas 100 vjetësh të ndihen metastazat e saj. Ndaj, sipas mendimit tim, nuk duhet të çuditemi pse kemi shumë botues, shkrimtarë, gazetarë, etj. Mund të imagjinoi një fëmijë të keq-ushqyer prej muajsh. Edhe pse e ushqen, atë e ndjek instinkti i urisë, grindet, qan, frikësohet. Fatkeqësisht, kur ka uri edhe "diletantizmi dhe injoranca", është frikësuese pasoja e shkatërrimit, ndaj duhet vëmendje... Dekontaminimi, pastrimi i këtij ambienti letrar mendoj që është një proces jo i lehtë, që kërkon kohë. Koha është kritiku më i mirë që filtron vlerat nga antivlerat. Por, kjo nuk do të thotë që duhet të presim. Ndryshimi duhet të fillojë nga vetë ne, unë, ju, çdo autor dhe gazetar... Ndjej që rrethohemi nga një heshtje sfilitesh, që shpesh më ngjan me viktimizimin, por që shpresoj që nuk do jetë jetëgjatë...


**HEJZA:** A i ndiqni aktivitetet letrare - artistike në Shqipëri dhe me gjerë, botimet e antologjive të ndryshme dhe a ju vjen keq që nuk jeni pjesë e tyre?

**SH. AXHAMI TROTA:** Këtu është një dinamizëm i ethshëm, deri frikësues, i jetës në përgjithësi. Dhe kemi shumë pak kohë, që të ulemi dhe të shohim ato që na i ndjell zemra. Por, unë përpiqem që të ndjek, me aq sa mundem, aktivitetet e ndryshme letrare-artistike që organizohen atje. Edhe një aktivitet i një shkolle në Tiranë dhe gjetkë, për gjuhën, për letërsinë, festat etj, na bën të ndihemi mirë dhe ngazëllyeshëm. Duhet të jetosh larg vendit tënd, që ta kuptosh një ndjesi të tillë. Kam ndjekur dhe ndjek me një interes të veçantë edhe aktivitetet e Qendrës Kombëtare të Librit dhe Leximit. Unë i ndjej dhe shoh një mënyrë krejt të paanshme këto aktivitete dhe dua të theksoj që kjo Qendër duhet vlerësuar. Kam vënë re që ftohen, promovohen, investohen autorë të rinj. Është tejet e rëndësishme kjo. Edhe këtu ku jam unë, këshilli, që do të thotë bashkia, investon shumë më shumë për autorë të rinj, se sa për emra që njihen. Gjithashtu, zgjedhja e laureatëve, dy emra të admirueshëm të poezisë moderne shqipe dhe më gjerë, na entuziazmon dhe na jep shpresën se diçka po bëhet, për mirë. A ka mangësi, padyshim që po. Por, e rëndësishme është që po rreket të bëhet. Ne duhet t'i shikojmë risitë, aktivitetet si një vlerë e shtuar kombëtare dhe jo në mënyrë

të njëanshme dhe me duf personal. Dufi personal, mania për të qenë të parët, është një "virozë", që na ka ndjekur historikisht, fatkeqësisht. Përsa i përket pjesës së dytë të pyetjes, Antologjitë bartin një peshë të rëndë, jashtëzakonisht të rëndë, sipas perceptimit tim. Ndaj të përfshihesh në to është një përgjegjësi e madhe. Unë jam ftuar jo pak herë të jem pjesë e antologjive dhe nuk kam pranuar. Nuk kam pranuar me bindjen që në një antologji duhet të përfshihen emra të padiskutueshëm, që kanë zënë rrënjë në historinë e zhvillimit letrar të vendit, prej dekadash. Padyshim që në një antologji mund të përfshihen edhe emra të rinj, por kur këta emra janë futur bindshëm në procesin e zhvillimit të poezisë, duke lënë gjurmë dhe duke iu përgjigjur funksionit estetik letrar. Unë jam ende herët. Por, kur hartohen Antologji në të cilën përfshihen emra që nuk kanë të bëjnë aspak, ose fare pak me poezinë e mirëfilltë, të krijohet një pështjellim, më shumë se neveritës, keqardhës. Imagjinoni për një çast një qytet të djegur, pas 50 vjetësh. Nëse dikush kalon pranë ndonjë biblioteke të tij, do të hezitonte të merrte cilindo libër të shpëtuar, përpara një antologjie... Atëherë lind pyetja, si do i justifikohemi përballë kohës, me antologji të tilla...Nuk po zgjatem më tej, por shpresoj që në të ardhmen të ngrihet një grup që njeh mirë zhvillimin historik-letrar të vendit, ka shije të kultivuar estetike, dhe të hartojnë Antologji të mirëfillta të poezisë shqipe, që koha të mos na lëshojë nëmë...

**HEJZA:** Atje ku Ju jetoni, a e keni gjetur veten si autore dhe a keni ndonjë bashkëpunim në aktivitetet vendase. Si e kanë vlerësuar artin Tuaj?

**SH. AXHAMI TROTA:** Në fakt është e çuditshme mes pështjellimit që sjell largimi nga vendi yt dhe jetesa në një vend të madh si Britania e Madhe, unë gjendem befasisht në një skenë. Ftohesha të recitoja disa poezi nga libri "Zoti zbrer mbi jaseminë", në një aktivitet që zhvillohej në Birmingham, në përkrahje të Ukrainës. E befasuar pyes organizatorët dhe



më thonë që kanë ftuar të gjithë autorët e zonës. Si duket kishin kërkuar në Google, mbi shkrimtarët që jetojnë dhe punojnë në zonë. E cilësoj këtë fakt, sepse këtu institucionet shkojnë tek autorët, përpiqen t'i afirmojnë ata, dhe jo e anasjelltas. Pas festivalit me poezi, jam ftuar në të gjitha ngjarjet e zhvillimit të letërsisë, festivaleve, work shopeve, takimeve në zoom, etj. Këto ngjar-

je zhvillohen, sponsorizohen nga institucione që mbajnë përgjegjësi për zhvillimin e letërsisë, si Writing West Midlands etj. Thënë shkurt, më kanë mbështetur dhe vazhdojnë ta bëjnë. Libri im me tregime "Pengu i një varrmihësi", është në proces redaktimi nga Roos Woolner, një shkrimtare dhe përkthyes vendase, më qëllimin e botimit. Jonathan Davidson, shef ekskluziv i kësaj Qendre dhe një

ekip prej disa autorësh, e kanë lexuar librin dhe janë shprehur, meqë ju pyesni: si një prozë e pahasur më parë... Të tjerat le t'ia lëmë kohës...

**HEJZA:** Në Angli është edhe një komunitet relativisht në numër i artistëve shqiptarë. A ekziston ndonjë organizim apo bashkëpunim midis këtij komuniteti?

**SH. AXHAMI TROTA:** E vërtetë, këtu ka një numër relativisht të madh shqiptarësh, që kanë dhe japin kontributin e tyre në shumë fusha. Duhet theksuar kjo, kudo ku jetojnë shqiptarë ka individë të devotshëm që dinë t'i japin vendit ku jetojnë vlera të jashtëzakonshme në shumë fusha. Organizimet dhe bashkëpunimet midis komunitetit janë të fokusuar më shumë në njohjen dhe promovimin e artistëve të rinj, këngëtarë, etj, që shpesh vijnë dhe organizojnë koncerte etj. Të larmishme janë edhe aktivitetet që organizon ambasada shqiptare, për festat e ndryshme, njohje, promovim etj, kryesisht në Londër.

**HEJZA:** Me siguri në laboratorin Tuaj krijues janë në proces edhe realizimi i projekteve të reja. Çfarë mund të presim pas librit "Fundi i Uskanës"?

**SH. AXHAMI TROTA:** Fundi i Uskanës është një roman i shkruar relativisht para disa vitesh. Nuk e di mbase vetë kompleksiteti i tij ndolli një farë ngërçi dhe nuk u botua. Por, kjo shërbeu për mirë, sepse e kam rishikuar disa herë. Pas shkrimit të tij (mbetur në dorëshkrim), kam botuar dy libra të tjerë, vëllimin me tregime "Pengu i një varrmihësi" dhe atë me poezi, "Këngë për brezin tim", nga shtëpia botuese, Uegen. Gjej rastin ta falënderoj publikisht një njeri fisnik dhe me vlera të jashtëzakonshme, që rrallë hasen në ditët e sotme, zotin Xhevair Lleshi, që rrallë hasen sot. Për t'i dhënë përgjigje pyetjes, kam në dorëshkrim një roman të përfunduar, një përmbledhje me tregime dhe një me poezi, por që më duhet t'u jap kohën e duhur te redaktimi, derisa të bindem për botim...

*Fady Joudah, poetit të cilit lufta në Gaza ia ndryshoi veprën*

# VALLËZIMI MIDIS QARTËSISË DHE VEÇORISË

**Misticizmi e sheh ekzistencën njerëzore përmes fazave të dashurisë. Të gjitha dëshimet, ligësia, dëshirat dhe çlirimet tona janë faza të dashurisë**

**Aria ABER**

Po hyjmë në muajin e gjashtë të luftës më të fundit në Gaza dhe kam pyetur veten për rolin e poezisë dhe kam kërkuar nga poetët që të më ndihmojnë të kuptoj se çfarë po ndodh. Një prej tyre është poeti dhe mjeku palestinez-amerikan, Fady Joudah, i cili ka raportuar se sulmet ajrore izraelite kanë vlarë më shumë se njëqind anëtarë të familjes së tij në Gaza. Gjatë këtyre muajve të fundit, ai ka botuar poezi dhe ese të reja të animuara nga pikël-

limi i padepërtueshëm dhe inteligjenca e zjarrtë, ndërsa është shfaqur në televizion dhe radio për të diskutuar situatën në zhvillim. Daljet e tij publike kanë ilustruar për mua mundësinë e një bote ku fjalëve të një poeti i jepet rëndësia që meriton. Libri i ri befasues dhe filozofik i Joudah [...] - (titulli i librit), doli në muajin mars. Titulli, siç më shpjegoi Joudah, funksionon si një piktoqram: një simbol piktorial që transporton kuptimin duke përfaqësuar një objekt fizik. Gjithashtu ngjall heshtje dhe fshirje - shoh një hapë-

sirë të mbyllur, një ndërtesë të rrënuar me njerëz brenda, apo edhe një libër. Brenda faqeve të tij, zëri i poetit udhëton nëpër shekuj dhe kontinente, duke historizuar fatin e popullit palestinez, ndërsa ndriçon hutimin, erodin dhe spiritualitetin e jetës së përditshme. Integriteti dhe mjeshtëria e Joudah elastikojnë kufijtë e lirikës dhe përqafojnë një llogari me dhunën koloniale. Por, këto poezi me vezulluese, të shtresuara, sfidojnë kategorizimin e lehtë, edhe pse ato janë të mbushura me mençurinë që trashëgojmë nga të vdekurit:

*"Kohë pas kohe gjuha vdes. Po vdes tani.*

*Kush është i gjallë ta flasë?"*

*- Më pëlqeu libri juaj [...] jo vetëm për urgjencën dhe peshën e tij, por për qetësinë dhe bukurinë e tij dhe, herë pas here, lojën. Libri fillon në medias res (në mes të një ngjarjeje), folësi pohon: "Unë jam punë e papërfunduar". E di që disa nga këto poezi janë shkruar "në kohë reale" si përgjigje ndaj luftës më të fundit në Gaza. Sa kohë ju desh për të shkruar poezitë dhe kur e dinit se*

do të del një libër?

**F. JOUDAH:** Unë do të thoja rreth dhjetë javë. Midis tetorit dhe dhjetorit, 2023. Në nëntor e dija se kisha një libër. Dhe u dorëzova në botim. Më mbajti disi mendjemprehtë, me shpresë për t'u zhytur në një të ardhme ku fjalët që shkruaj do t'i mbijetonin fuqive që donin ato të vdisnin. Edhe pasi ia dorëzova dorëshkrimin botuesit tim, shkrova një grusht [...] poezish të reja. Por, ia vlen të kujtojmë se palestinezët kanë jetuar për kaq shumë kohë me një qartësi të thjeshtë në një botë që verbohët. Një botë, veçanërisht në Amerikë, është e sigurt se e sheh jo vetëm aq mirë, por, në fakt, shumë më mirë sesa një palestinez. Në një mënyrë të folurit, këto poezi më erdhën menjëherë, sepse ato kishin ekzistuar në mua, në karuselin palestinez, prej vitesh: çnjerëzimi, bashkëfajësia, heshtja, përbuzja dhe procesi i shfarosjes së dëmshme. Por edhe bukuria, muzika dhe dëshira kishin jetuar në mua po aq plotësisht. Mbijetesa. Palestinezët janë shumë më tepër se një depo plagësh; të na portretizosh si të tillë nuk mund të çojë në shumë më tepër sesa keqardhje. Në të gjithë librat e mi, kam punuar në regjistra të shumtë, i fiksuar pas vallëzimit midis qartësisë dhe veçorisë; Punimet e mia i mendoj si partitura të gjata muzikore. Por, në veprën [...], ngjarja historike botërore që është Gaza-Palestinë në 2024, na sjell në fokus më të mprehtë. Poezia ime "Papritur unë" u bë më e identifikueshme, më e dallueshme. Sikur zëri im është më së shumti i lexueshëm kur në një regjistër të caktuar në sintoni me daullen bota po rreh për asgjësimin tim. Kjo është një enigmë e komunitetit për poetin, veçanërisht për poetin palestinez apo edhe arab në anglisht.

**-Nuk mund të mos mendoj se poezia është veçanërisht e rëndësishme tani. Shumë poetë palestinezë thuhet se janë vrarë gjatë kësaj lufte; të tjerët dyshohet se janë torturuar. Kur Dr. Refaat Alareer u vra ose kur Mosab Abu Toha u arrestua papritur, distanca midis poezisë amerikane dhe poezisë palestineze u shemb për një çast. Shumë njerëzve iu kujtua një e vërtetë që ju dhe unë, si shkrimtarë në mërgim nga vendet e shkatërruara nga lufta, e dimë nga afër: se puna e një poeti nuk është një pozicion apolitik. Ndosh-ta si përgjigje ndaj shkatërrimit të qëllimshëm të kulturës, ekziston një uri e vërtetë që poetët që tani t'i japin zë dhunës që duket "e papërshkrueshme". Cila mendoni se është përgjegjësia e poetit?**

**F. JOUDAH:** Poeti nuk ka një lloj përgjegjësie të vetme, as përgjegjësia e poetit nuk përcaktohet nga madhësia e një ngjarjeje, private apo publike. Në poezinë e një sekuence të gjatë në [...], "Më duket sikur jam", udhëtoj pas në kohë për të biseduar me poezinë klasike arabe si një arkiv se si poetët e lashtë flisnin për kalimin e kohës. Në një mënyrë të folurit [...] është një bisedë formale me kohën (prandaj epigrafi i saj nga al-Mutanabbi). Njeriu dhe jo-njerëzorja shkrihen, që do të thotë koha njerëzore dhe koha jo-njerëzore bëhen të paqarta. Fatkeqësisht fshin vetveten. Dashuria është e bindur se ajo është burimi i jetës dhe



jeta është e bindur se pa të dashuria nuk është asgjë. Dhe në fakt, jeta jo-njerëzore në Tokë, që është pjesa më e madhe e jetës, nuk ka nevojë për dashuri. Dashuria është e nevojshme për njerëzit, sepse pa të ne jemi shkatërrues të botëve dhe me të, ne ende luftojmë që të mos jemi shkatërrues. Përgjegjësia e po-

etit? Mentori im mjekësor, një hebre nga Waco, Teksas, thoshte se një bollëk kërkimesh të vazhdueshme mbi një temë të caktuar mjekësore tregon se ne ende nuk dimë mjaftueshëm për atë temë. Dhe kështu ndihem për përgjegjësinë e poetit. Ne vazhdojmë të flasim për të, sepse është pamëshirshëm i ndryshue-



shëm, pluripotent. Asnjëherë nuk jemi të kënaqur me përgjigjet tona. Shpesh mendoj se përgjegjësia e poetit është të përpiqet të bëhet kujtesa që njerëzit mund të zotërojnë në të ardhmen për atë që do të thotë të jesh njeri: një konstante që ndryshon vazhdimisht. Në poezi vargu i metaforave dhe temave është i kufizuar, i parashikueshëm, por stilet janë të panumërta. Mendoni se si lexojmë poezi të shekujve më parë dhe nuk na shqetëson më thënia e saj e vjetruar. Gjithçka që ka mbetur nga poezia e vjetër është muzika e asaj që do të thotë të jesh njeri. Dhe ndosh-ta kjo është gjithçka që duam nga poezia. Një gjuhë e jetës. Më pëlqen ky citim i J. M. Coetzee: "Mjeshtrit e informacionit kanë harruar poezinë, ku fjalët mund të kenë një kuptim krejt të ndryshëm nga ai që thotë leksiku, ku shkëndija metaforike është gjithmonë një kërcim përpara funksionit të dekodimit, ku një lexim tjetër, i paparashikuar është gjithmonë i mundur."

**-Jemi në një moment censure të ashpër; gjuha ndihet e ngarkuar dhe e ndezshme. Në Gjermani, për shembull, protestuesve u ndalohet të bërtasin sloganin "Nga lumi në det". Disa harta fshijnë qartë emrat e fshatrave të vjetra palestineze. Prandaj nuk është për t'u habitur që kur ndesha titullin [...] mendja ime u mbush menjëherë bosh me fjalën "Palestinë" ose emrin e saj të vërtetë arab, "Falastin". Por, duke lexuar poezitë, jam më pak i sigurt. [...] është i pakapshëm, vezullues, i shtrirë. Elipsa çahet dhe hesht, por gjithashtu lejon që imagjinata jonë të zërë rrënjë. Si arritët te ky titull?**

**F. JOUDAH:** Titulli i librit nuk pranoi të shkruhej. Insistonte të ishte pa fjalë. Unë kisha menduar për librarinë. Si arritëm të besojmë se përmbledhjet me poezi duhet të ndërtohen në një mënyrë të caktuar? Është shumë reduktuese të thuhet se jetojmë në një epokë ku kapitalizmi ka dominuar në librari, por nuk është e pasaktë ta thuash. Pavarësisht nga shumëllojshmëria dhe hibriditeti i librave me poezi sot, një shabllon për atë që përbën një përmbledhje poetike ende dominon mendimin tonë. Historikisht, poezia sapo lundroi në kujtesën e njerëzve pa tituj, që jetonin në fragmente. Ne priremi të mendojmë se jetojmë në epokën e arkivit të pakthyeshëm, që ndryshe nga epokat e mëparshme, gjithçka që dokumentojmë, do të zgjasë përgjithmonë. Kur filloi asgjësimi i Gazës, titujt ishin të paimagjinueshëm për mua. Megjithatë, më tërhoqi nocioni i piktogramit. Nuk e kisha idenë se çfarë mund të hapej në libër dhe për lexuesin, me kohë. Për ironi, doli që pyetja "Si e thoni?" ose "Si do ta kërkojnë njerëzit në internet ose në librari?", ishin pyetje që nuk i mendoja. Pyetje të kapitalit, të audiencës, të industrisë së kulturës. I njëjti kryeqytet që nxiti shkatërrimin e Palestinës, ndër të tjera. Megjithatë nuk po mendoja për të gjitha këto gjëra. Nga ana shpirtërore, asnjë titull nuk më fliste dhe doja ta dëgjoja atë heshtje. Por pastaj u befasova, për shembull, nga tabela e përmbajtjes. U shfaq një fantazmë tjetër, siç më tregoi shoqja ime, Deema Shehabi. Tabela e përmbajtjes i ngjan një peizazhi palestinez, qoftë në vitin 1948 apo në 2024: i pari një peizazh i depopulluar prej afro pesëqind fsha-



trash dhe qytetesh, i dyti një masakër rrënojash. Nuk e kam parashikuar gjithashtu mënyrën se si kopertina do të bëhet poezia e parë në libër: Emri im në arabisht shton peshën e të pathënës në anglisht. Dhe pastaj shfaqen më shumë jehona. Motra ime, studiuesja, me shaka më thotë se ka "ankth citimi" kur shikon tabelën e përmbajtjes. Poezitë që kanë tituj, megjithatë, janë ose jehonë të poemave të mia të mëparshme me tituj të ngjashëm ose janë të koncepteve arabo-islame si "Kufic", "Maqam" ose "Barzakh", koncepte që nuk përfaqësohen për ndërtim në anglisht, por si objekte arti. Këtu e kam fjalën për pasojat e piktogramit, jo për fillimin e tij. Kaq shumë rezistojnë ta quajnë gjenocid, por pyetjet se çfarë të quash [...] janë të përsëritura.

**-U befasova nga ashpërsia e këtyre rreshtave:**

*"Shpresa më la por nuk është e vërtetë." ose: "Në arabisht, dhimbja është një anagram i shpresës." Për mua, kthimi në poezi është një kthim në shpresë, për t'i bërë hapësirë besimit në një botë më të mirë, edhe nëse poezia diagnostikon vetëm plagët e kohës sonë. Çfarë roli luan shpresa në [...]"*

**F. JOUDAH:** Roli që luan shpresa në [...] është nga lumi në det. Citi mi i dytë të cilit i referoheni është në një poezi që i drejtohet profetit Jusuf në Kur'an. Kaptina e Jusufit në Kur'an ishte kaptina ime e preferuar si fëmijë. Është kaptina e vetme me një fije të vetme narrative të qëndrueshme. Jusufi në arabisht bëhet figura e bukurisë universale, bukurisë hyjnore. Në tregimin kuranor, historia ka një fund të lumtur. Nuk ka dënim, vetëm falje, përfshirje dhe ribashkim. Më vonë, në letërsinë arabe dhe farsi, Jusufi arrin lartësi të caktuara ku humbet gjinia. "Ti je Jusufi i bukurisë", thotë një varg i famshëm i poetit egjiptian, Ahmad Shawqi, për shembull: folësi, një burrë, duke iu drejtuar një gruajë të dashur. Ose jo. Në bukuri, ne jemi të gjithë Jusuf dhe historia e Jusufit, përtej interpretimit të ëndrrave. Nuk ka dashuri që ia vlen emri i saj që të mos jetë shumë, poroze (shkëmb ose material tjetër që ka hapësira ose vrime të vogla nëpër të cilat mund të kalojë lëngu ose ajri). Gjatë një mbledhjeje fondesh të kohëve të fundit për Agjencinë e Kombeve të Bashkuara për Ndihmën dhe Punën për Refugjatët Palestinë në Lindjen e Afërt (UNRWA), lexova "Dedikim", poezia më e gjatë në [...]. Imami ishte mbledhësi i fondeve dhe

erdhi pas meje. Ai foli për shpresën. Historia që ai përdori për të ilustruar shpresën ishte një tjetër rrëfim kuranor, për Ezrën, i cili nuk mund të besonte se një qytet i shkatërruar dhe njerëzit mund të ringjallehin. Por, Perëndia i tregoi Ezrës se ata mundën. Nëse njeriu i shenjtë në Kur'an është i njëjti Ezra në shkrimet e tjera të shenjta apo një kimerë e njeriut dhe engjëllit, nuk ka rëndësi për mua. Qytetërimet vijnë dhe shkojnë. Shpresa nuk ka etni, nuk ka nacionalizëm, nuk ka kufizime identitare, nuk ka monopol në kohë. Ne mund ta bëjmë atë zgjedhje për shpresën.

**-Duke lexuar këto poezi, m'u kujtua ky varg nga poeti Aimé Césaire: "Jeta nuk është një spektakël, një det mjerimesh, nuk është një proscenium (paraskenë-perde), një burrë që bërtet nuk është një ari që kërcen". Poezitë tuaja e refuzojnë spektaklin, ato e ndriçojnë njeriun si një njeri. Folësi dëshiron "dashuri të pafund" dhe i drejtohet kujt dhe çfarë nuk mund të mbahet. Mund të flisni pak për erosin në këtë libër?**

**F. JOUDAH:** Ka eros që është në varësi të psikologjisë, dhe ka eros që është përtej mundësive të psikologjisë. Dua të synoj mundësinë e fundit. Misticizmi e sheh ekzistencën njerëzore përmes fazave të

dashurisë. Të gjitha dështimet, ligësia, dëshirat dhe çlirimet tona janë faza të dashurisë. Erosi është një shënues i jetës, kundër tjetërsimit, kundër vdekjes si një mjet që imponon nënshtrimin. Unë jam një burrë palestinez. Një burrë arab. Një burrë mysliman. Dëshirat e mia janë të zakonshme. Brishtësia ime gjithashtu. Në këto poezi të mallit, unë e rifitoj trupin tim nga kultura që dëshiron të më dëgjojë dhe të më lexojë vetëm si një zë pas fatkeqësisë dhe si një plagë jo shumë më tepër. Ndonjëherë ajo që ne e quajmë poezi e dëshmitarit, e cila është e ndryshme nga dëshmia e poezisë, e lidh poetin me stereotipin. Dhe tregu ushqen një stereotip, ushqen keqardhjen më shumë se ndjeshmërinë aktive, derisa, sigurisht, empatia aktive të rezultojë fitimprurëse dhe gjëja e duhur për të bërë. Tragjedia palestineze është ende në matematikë duke u llogaritur për ta përfunduar atë, një matematikë prej njëqind vjetësh. Erosi triumfon mbi atë matematikë. Për mua ka rëndësi të imagjinoj një kohë në të cilën [...] përjetohet si një festë e jetës, një triumf mbi historinë. Kjo nuk është e mundur pa intimitetin e mallit, të një udhëtimit kalimtar, sensual në trup dhe mbrapa. "Edhe qelizat prekin njëra-tjetrën për të thënë lamtumirë." (Yalereview.org)

**Solli në shqip: Fitim Nuhui**

## Libra të veçantë

# TMERRI I NJË LUFTE TEK ASGJË E RE NGA FRONTI I PERËNDIMIT

**Libri i shkruar nga Remark cilësohet si një roman klasik kundër luftës, i cili ofron një portret të mprehtë e pikëllues të përvojës së ushtarëve gjermanë gjatë Luftës së Parë Botërore**

### Leonard VEIZI

Mizoritë e një lufte nuk mund të përshkruheshin më mirë se nga dora e një mendje brilante që ishte instaluar brenda qenies njerëzore të Erih Maria Remark. "All Quiet on the Western Front", në anglisht por që në gjuhën origjinale gjermane kishte këtë kontekst: "Im Westen nichts Neues" do të ishte romani i tij i pazakontë, i cili edhe pse pas debateve e replikave të shumta u përkthye në rreth 50 gjuhë, vazhdon të provokojë reagime të polarizuara... Për herë të parë, - ajo që në shqip erdhi si përkthimi i pazakontë i Robert Shvarcit: "Asgjë të re nga fronti i perëndimit", - u botua në vitin 1929. Lufta e Parë Botërore kishte të paktën 11 vjet që kishte mbaruar. Por gjurmët dhe dhimbja ishte e freskët. Ndërsa sot, pas gati 100 vitesh romani mbetet si një nga librat më të rëndësishëm të shkruar me subjekt ngjarjet e Luftës së Madhe.

### Publikimi

"Im Westen nichts Neues", u publikua për herë të parë pjesë-pjesë nga datat 10 nëntor - 9 dhjetor 1928, në revistën "Vossische Zeitung". Ndërsa u botua i plotë një vit më pas, duke shitur mbi një milionë e gjysmë kopje brenda atij viti. Paraqitja realiste nga Remark e luftës së llogoreve

nga perspektiva e ushtarëve të rinj, provokoi reagime të forta, si pozitive ashtu edhe negative, në mbarë botën. Romani u përkthye në shumë gjuhë të botës, dhe u përshtat në një film të mirënjohur amerikan që në vitin 1930. Ndërsa më pas pati edhe përshtatje të tjera filmike. Kritikët më të ashpër të Remark, qenë vetë bashkatdhetarët e tij, shumë prej të cilëve mendonin se libri denigronte luftën gjermane, dhe se shkrimtari i kishte zmadhuar qëllimisht tmerrin e luftës në funksion të axhendës së tij paqësore. Nuk është e habitshme që zërat më të fortë kundër Remark erdhën nga Partia Nacional Socialiste (naziste), një grup ultranacionalist i udhëhequr nga Adolf Hitler. Në vitin 1933, kur nazistët u ngjiten në pushtet, "Asgjë e re nga Fronti i Perëndimit", u bë një nga librat e parë që u dogjën publikisht duke u përjashtuar nga bibliotekat dhe leximet.

### Romani

Libri i shkruar nga Remark cilësohet si një roman klasik kundër luftës, i cili ofron një portret të mprehtë e pikëllues të përvojës së ushtarëve gjermanë gjatë Luftës së Parë Botërore. Protagonisti i romanit "Asnjë e re nga Fronti i Perëndimit", është Pol Baumer, një ushtar i ri gjerman që lufton në llogoret e

Luftës së Madhe. Pikërisht në vitin 1914, një dhomë plot me nxënës gjermanë, me fytyra idealiste, nxitën nga mësuesi i tyre të shkojnë në "luftën e lavdishme". Me zjarrin dhe patriotizmin e rinisë ata regjistruhen në ushtri. Ajo që vijon më pas është historia prekëse e një "ushitari të panjohur" që përjeton tmerrin dhe zhgënjimin e jetës në llogore. Në vitin 1917, gjysma e kompanisë së Baumer - shumica e tyre shokë e gjimnazit - janë vrarë në betejë. Vetë Pol plagoset dhe shtrohet në spital, kthehet në shtëpi me leje dhe pas disa ditësh rikthehet në front, vetëm për t'u vrarë një javë para armëpushimit dhe fundit të luftës në vitin 1918. Kantoreku është profesor i Baumer, Kropit, Mylerit dhe Lerit, 18-vjeçarë gjermanë kur oshitimat e predhave të luftës së madhe gjëmojnë nga njëra anë e Evropës në tjetrën. Një burrec i rreptë i veshur në gri, me një fytyrë prej miu, kërkon të jetë udhëzues i të rinjve në botën e punës, të kulturës dhe të progresit. Në orët e gjimnastikës, ai i shigjeton djemtë me vështrim të rreptë dhe u mban fjalime për atdheun në rrezik apo për madhësinë për t'i shërbyer shtetit, duke i udhëzuar e frymëzuar që të shkojnë vullnetarë. Por kur janë në front, nxënësit e Kantorekut, nga Albert Kropi më inteligjenti i shkollës e deri te Pol Baumer, poeti që kërkon të shkruajë drama, e kuptojnë shpe-

jt që nuk janë aspak "rinia e hekurt", e thirrur për të mbrojtur Gjermaninë në rrezik. Zbulimi se terrori i vdekjes është më i fortë sesa madhështia për t'i shërbyer atdheut i befason qysh atë ditë kur, gjatë një sulmi, Jozef Bem, një shok shkolle i shëndoshë dhe i qetë, vritet egërsisht në llogore. Në pak muaj nxënësit e Kantorekut e ndiejnë veten të plakur, të dërrmuar, të privuar jo vetëm nga rinia por nga çdo e shkuar, ëndërr e shprese.

### Në shqip

Në kujtimet e përkthyesit të njohur Robert Shvarc, të botuara në Revista Përpjekja, nr. 13-14, 1998 thuhet se romani "Asgjë e re nga Fronti i Perëndimit", u botua në shqip në vitin 1988, në tre numra radhazi në të vetmen revistë letrare të asaj kohe, "Nëntori". Ndërsa në vitin 1992, romani u ribotua edhe si libër më vete, me një parathënie nga Ismail Kadare. Në parathënien e tij mes të tjerash Kadare do të shkruante: "Asgjë e re nga Fronti i Perëndimit" ishte një paralajmërim në kohë e duhur. Në qoftë se nuk hyri sa duhej në punë në kohën e vet, ai e ruan vlerën e tij për aq kohë sa në botë do të ketë kërcënim, agresorë, ethe dhune dhe barbari. Një letërsi e tërë, një opinion i tërë botëror përparimtar u kundërvihet gjithmonë forcave agresive kudo në botë. Në këtë arse-



nal të fuqishëm libri i Remar- kut mund të duket i thjeshtë, por s'duhet harruar se ai u shkrua më se gjysmë shekulli më parë, nga një ish – ushtar i frontit, të cilit, kur afro- nin vranësi e vjeshtës, i dhemb- bnin vendet e plagëve të luftës. Si i tillë ai të trondit, veç të tjerash, me autenticitetin e tij". Në fakt "Im Westen nichts Neues" apo siç njihet në anglisht "All Quiet on the West- ern Front" nuk është thjesht au- tobiografik, siç supozojnë shumë lexues. Studiuesit shkruajnë se Re- mark nuk shërbeu në llogore, por si pjesë e trupave xheniere prapa vi- jave të frontit, dhe ai ishte në aksion vetëm për rreth gjashtë javë përpa- ra se një plagë e marrë do ta nxirrte nga detyrimi për të punuar. Meg- jithatë, ai e njihnte temën dhe rit- mi i rrëfimit të tij, me shpërthime të egra që ndërhyjnë në mag- jitë e mërzisë, u bë një shabllon për histori të panumërta të mëv- onshme të luftës. Po me të njëjtin përkthim të Robert Shvarc "Asgjë e re nga Fronti i Perëndimit" njo- hu dhe botime të tjera nga shtëpi të tjera botuese, si nga shtëpia "Hor- izont" në vitin 1999 por dhe nga

"Dituria" në vitin 2018.

#### Filmi 1930

I konsideruar si një nga përshkrimet më të singerta dhe autentike të luftës në letërsi, romani i njohur i Re- mark u përshtat për herë të parë për ekranin në filmin: "Gjithçka e qetë në Frontin Perëndimor". Ai është një film amerikan epik antiluftë i vi- tit 1930. Me regji të Luis Milestone, në film luajnë Lev Aires, Luis Vol- heim, Xhon Vrai, Arnold Lusi dhe Ben Aleksandër. "Gjithçka e qetë në Frontin Perëndimor" pati një vlerë- sim të gjerë në Shtetet e Bashkuara. Në vitin 1990, filmi u zgjodh dhe u ruajt nga Regjistri Kombëtar i Filmit i Bibliotekës së Kongresit të Shteteve të Bashkuara i konsideruar si "kul- turor, historikisht ose estetikisht i rëndësishëm". I konsideruar si një rrëfim realist dhe tronditës i Luftës së Parë Botërore, ai u rendit në listën e 100 filmave të Institutit Ameri- kan të Filmit në 1997. Një dekadë më vonë, pasi e njëjta organizatë anke- toi mbi 1501 filma, "All Quiet on the Western Front" u rendit filmi i shtatë më i mirë epik amerikan. Filmi ishte

i pari që fitoi çmimet e Akademisë si për prodhim të jashtëzakonshëm ashtu edhe për regjisorin më të mirë. Është fituesi i parë i filmit më të mirë i bazuar në një roman. Për shkak se është një film i prodhuar në vitin 1930, ai do të hyjë në domenin pub- lik më 1 janar 2026, pas skadimit të së drejtës së autorit për romanin në vitin 2024.

#### Filmi 1979

"All Quiet on the Western Front" është një film epik televiziv kundër luftës i prodhuar nga ITC Entertain- ment. Ai u publikua më 14 nëntor 1979. Bazuar në librin e vitit 1929 me të njëjtin emër nga Erih Maria Remark, në të luajnë Riçard Tomas dhe Ernest Borgnine. Me regji të Del- bert Man, ky film është një prodhim i përbashkët britanik dhe amerikan për të cilin shumica e xhirimeve u zhvilluan në Çekosllovakia.

#### Filmi 2022

"Qetësi në frontin perëndimor" që në gjermanisht njihet si: "Im Westen nichts Neues", është një film

epik gjerman i prodhuar në vitin 2022. Ky prodhim është përshtatja e tretë filmike e librit, pas version- eve të 1930 dhe 1979. Drejtuar nga Eduard Berger, në film luajnë Feliks Kamerer, Albricht Shuh, Daniel Brühl, Sebastian Hulk, Aron Hilmer, Edin Hasanovic dhe Devid Shtrisov. "Im Westen nichts Neues" u shfaq pre- mierë në Festivalin Ndërkombëtar të Filmit në Toronto më 12 shta- tor 2022 dhe u publikua për trans- metim në Netflix më 28 tetor. Ma- teriali burimor, me disa sekuenca kryesore nga romani janë hequr ose ndryshuar. Ndërkohë që kri- tikët ishin të ndarë ndaj Re- mark në lidhje me besnikërinë e filmit. Megjithatë filmi mori vlerë- sime pozitive të drejtuara ndaj tonit të tij, grimit, partiturave muziko- re të Volker Bertelmann, regjisë së Bergerit dhe mesazhit përkatës kundër luftës. Ai mori 14 nominime kryesore në çmimet e 76-të të Aka- demisë Britanike të Filmit. Ai u no- minua në dymbëdhjetë kategori për Çmimet e Filmit Gjerman 2023, dhe fitoi tetë prej tyre, plus Çmimin e Argjendtë për filmin më të mirë.

*Në shiritin e kohës*

# NJË LETËR DREJTUAR POETIT ZEF ZORBA

**(U lind më 31 mars 1920 në Kotorr të Malit të Zi - ndërroi jetë në 6 janar të vitit 1993 në Shkodër)**

#### **Xhahid BUSHATI**

Njohja ime me poetin Zef Zorba ishte e shkurtër, mbase më të shkurtat në botë. Kur njohjen time, që sapo zuri fill, e kisha ëndërruar të ishte përjetshme, deri në frymën e fundit të jetës sime, ndoshta edhe përtej... Kam menduar gjithnjë se ëndrrat

nuk duhet të jenë kaq jetëshkurtra sa njohja ime. Besoj, që edhe ato përral- la, ku zgjidhjet e ngjarjes apo përm- bylljet e tyre i kanë përmes ëndrrës, nuk do ta pranonin një shkurtësi të tillë. Se përrallat janë aq nazike sa nuk dëshirojnë t'i humbin magjitë e tyre, ku shpesh këtyre magjive zor- biane edhe vetë ëndrrat ia kanë be-

suar magjitë e tyre. Kështu ndodhi me të nderuarin Zef Zorba, kur në mendje kisha projektuar takime të rëndësishme, pyetje të vlefshme, ku- riozitetet e labirinte jete të jetës së tij, të mësoja se çdo të thotë të jesh qën- drestarë në heshtje, por edhe i hes- htur në buzëqeshje... Por, i fshiu pa mëshirë vdekja atij fillimi janari

të vitit 1993, kur "buzët t'i ngrinte i ftohti" e, kur mua i ftohti ma ru- ajti lotin, ma ktheu në kujtim e në mos-harrim... Humba modelin e një intelektualit që nuk është aq lehtë për ta gjetur, realisht humba një "Uni- versitet... E, unë këtë burrë 73-vjeçar që jeta e lodhi por nuk e mposhti, dëshiroj ta shoh, duke ecur ngadalë

e mendueshëm, me çantë në dorë si një bibliotekë lëvizëse; dëshiroj ta shoh tek ngjit shkallët e Universitetit "Luigj Gurakuqi" të Shkodrës, teksa hyn në auditor dhe studentët në heshtje, të privilegjuar e të nderuar presin leksionin e tij të parë... E shoh kështu, dhe nuk dua ta pranoj vdekjen e tij... Më shumë shkrimtarët e më pak studiuesit kanë folur e rrëfyer për jetën dhe krijimtarinë e Zef Zorbës... Ky raport jetë - krijimtari e ka një kod, ku së jashtmi dhe së brendshmi të këtij kodi "flasin" ngjyrat dhe nuancat ngjyrore sa njerëzore aq dhe shpirtërore, flasin tingëllimat e instrumenteve e muzikaliteti, flet filozofia dhe ëndërrimi... E gjithë kjo sofër e begatë, njëkohësisht e dritshme ka nevojë për thellësi interpretimi. Po përse nuk është arritur deri tani kjo?! Mbase mungon përballja kulturore dhe standardet në këtë lëmi. Mbase... Zorbën e kanë parë ata pak studiues që i kanë kthyer sytë nga ai: mes kohës së poetit dhe kohës ekzistuese, si krijues i veçantë hermetik e i një letërsie sirtari ... E gjitha kjo i ngjan një qielli të vogël për Zorbën, kur Zorba është një qiell pafund, ishte shpirt-qielli... Mbase, ai qiell i vogël i pameritueshëm i ngjan, siç thotë studiuesi Ardian Ndreca, sepse ndoshta: "... jeta e tij ka pak data"; por të mos harrojmë, vazhdon interpretimin Ardiani: "Te vargu i Zorbës ajo çka ka ma shumë randësi asht hija e objekteve sesa vetë përmasat e tyre reale". Ndërsa shkrimtari Ismail Kadare, teksa flet për kohën e poetit Zef Zorba thotë se: - "... , ende nuk më kishte qëlluar ta njihja librin e vetëm të tij, të botuar më 1994, një vit pas vdekjes së poetit, pothuajse pa asnjë jehonë mediatike."; - Ai (nënkupto: Zef Zorba) zgjodhi rrugën e krijimit të poezisë që nuk do të shihte dritën e botimit."; - Zef Zorba zgjodhi rrugën më të natyrshme: atë të artit."; - Ai (nënkupto: Zef Zorba) zgjodhi



hermetizmin, si formën më natyrale që i shkonte poetit me atë fat."; - "... është nga të rrallët poetë shqiptarë, bibliotekë lëvizëse; dëshiroj ta shoh tek ngjit shkallët e Universitetit "Luigj Gurakuqi" të Shkodrës, teksa hyn në auditor dhe studentët në heshtje, të privilegjuar e të nderuar presin leksionin e tij të parë... E shoh kështu, dhe nuk dua ta pranoj vdekjen e tij... Më shumë shkrimtarët e më pak studiuesit kanë folur e rrëfyer për jetën dhe krijimtarinë e Zef Zorbës... Ky raport jetë - krijimtari e ka një kod, ku së jashtmi dhe së brendshmi të këtij kodi "flasin" ngjyrat dhe nuancat ngjyrore sa njerëzore aq dhe shpirtërore, flasin tingëllimat e instrumenteve e muzikaliteti, flet filozofia dhe ëndërrimi... E gjithë kjo sofër e begatë, njëkohësisht e dritshme ka nevojë për thellësi interpretimi. Po përse nuk është arritur deri tani kjo?! Mbase mungon përballja kulturore dhe standardet në këtë lëmi. Mbase... Zorbën e kanë parë ata pak studiues që i kanë kthyer sytë nga ai: mes kohës së

poetit dhe kohës ekzistuese, si krijues i veçantë hermetik e i një letërsie sirtari ... E gjitha kjo i ngjan një qielli të vogël për Zorbën, kur Zorba është një qiell pafund, ishte shpirt-qielli... Mbase, ai qiell i vogël i pameritueshëm i ngjan, siç thotë studiuesi Ardian Ndreca, sepse ndoshta: "... jeta e tij ka pak data"; por të mos harrojmë, vazhdon interpretimin Ardiani: "Te vargu i Zorbës ajo çka ka ma shumë randësi asht hija e objekteve sesa vetë përmasat e tyre reale". Ndërsa shkrimtari Ismail Kadare, teksa flet për kohën e poetit Zef Zorba thotë se: - "... , ende nuk më kishte qëlluar ta njihja librin e vetëm të tij, të botuar më 1994, një vit pas vdekjes së poetit, pothuajse pa asnjë jehonë mediatike."; - Ai (nënkupto: Zef Zorba) zgjodhi rrugën e krijimit të poezisë që nuk do të shihte dritën e botimit."; - Zef Zorba zgjodhi rrugën më të natyrshme: atë të artit."; - Ai (nënkupto: Zef Zorba) zgjodhi hermetizmin, si formën më natyrale që i shkonte poetit me atë fat."; - "... është nga të rrallët poetë shqiptarë, që bëri eksperimente avangardiste, aq pak të pranishme në poezinë shqipe". Kurse studiuesi Stefan Çapaliku ndalet në vlerat e librit "Buzë të ngrira në gaz", ku marrëdhënia poet-vepër, vepër-poet jetuan dhe përjetuan një heshtje të gjatë dekadash. Ai shprehet: - "... një publikim vlerash nuk është vonë kurrë e që nga ky çast bibliotekës së letërsisë shqiptare i hyn një libër nderi.; - ""Buzë të ngrira në gaz" është shenjë e kohës së ndaluar, e ironisë tragjike shqiptare, e gjithçkaje që na lidh e zgjidh me të kaluarën, me të tashmen e me të ardhmen." I nderuari Zef Zorba! Si një intelektual i ditur që ishe, dua t'u përmend një urtësi të poetit të madh Shell-i, i cili thoshte: "Poezia është profeci, ligj dhe dituri". Këto tri vatra të dritshme i pashë në çdo poezi të krijimtarisë tënde poetike, gjatë leximit, rileximit dhe studimit tim.

## Në fokus

# GIORGIO AGAMBEN: TOTALITARIZMI BASHKËKOHOR (I)

**Sipas Agamben, ideja platonike e diçkaje në fakt është "të kesh një emër", përkatësinë e saj, "të qenurit në gjuhë" të saj. Idetë nuk kanë emra të përveçëm, por shprehen me termin grek (auto). Ideja është homonimi anonime, që është pikërisht kuptimi i shprehjes "çfarëdo". Njësia "çfarëdo qoftë" është një singularitet për aq sa lidhet jo vetëm me një koncept, por edhe me një ide**

### Nga Metin IZETI

Giorgio Agamben (Giorgio Agamben, Romë 1942-), i ngjashëm me filozofin francez Jacques Ranciere (Jacques Ranciere, 1940-), është një profesor i estetikës që u bë i famshëm kryesisht për punën e tij në fushën e filozofisë politike. Është një nga filozofët më të njohur italianë bashkëkohorë. Ai jep estetikë në Universitetin e Veronës. U diplomua në Universitetin e Romës si student i shkencave juridike. Në filmin e Pier Paolo Pasolini (1922-1975) Ungjilli i Mateut (1964), ai luajti rolin e Shën Filipit. Agamben nuk i filloi studimet për filozofi derisa u regjistrua në studimet pasuniversitare dhe mori pjesë në seminarët e

Martin Heidegger (Martin Heidegger, 1889-1976) nga viti 1966 deri në 1968 në Freiburg, Gjermani. Interesi i tij i mëvonshëm teorik lidhej kryesisht me marrëdhëniet midis filozofisë dhe teorisë letrare. Ai botoi libra të shumtë në fushën e estetikës, si: Fjala dhe fantazma në kulturën perëndimore, Gjuha dhe vdekja, Vendi i Negativitetit dhe Ideja e Prozës. Ishte gjithashtu redaktor i botimit italian të veprave të mbledhura të Walter Benjamin (Walter Benjamin, 1892-1940).

### Gjendje e përhershme e të jashtmes

Me Gilles Deleuze (1925-1995), ai botoi një libër për filmin Bartleby, *Formula e Creation*, (1995). I kushtoi

i vëmendje kryesisht teorisë politike pas vitit 1989. Ndër veprat e tij më të rëndësishme në këtë fushë kërkimore janë librat: *Shoqëria që po vjen*, *Teoria përtej kufijve*, *Mjetet pa qëllime*: *Shënime mbi politikën*, *Mbetjet e Aushvicit*: *Arkivi dhe dëshmia dhe vepra e tij më e njohur*, *Homo sacer*: *Fuqia Sovrane dhe Jeta e Zhveshur*. Agamben në veprën e tij të parë të rëndësishme, *Shoqëria që do të vijë*, në të njëjtat linja me filozofin francez Alain Badiou (Alain Badiou, 1937-), prezanton baza të reja të marrëdhënies midis gjuhës, ontologjisë dhe politikës dhe vendos koncepte të reja të politikës si dhe komunitetit si një bashkësi pa esencë. Ky lloj komuniteti ekziston vetëm

në formën e "mundësisë së pastër", pasi qenia njerëzore (singulariteti) si qenie për Agamben është e mendueshme vetëm si qenie e gjuhës dhe falë kësaj mund të shmanget hi-postaza tradicionale e kategorizimit ose kurthi metafizik i universalizimit, të cilat gjithmonë nënkuptojnë përjashtimin e një entiteti. metafizik i universalizimit, të cilat gjithmonë nënkuptojnë përjashtimin e një entiteti. Në librat që botoi më pas, Agamben zhvillon teorinë e tij të re të sovranitetit, e cila bazohet në të ashtuquajturën "gjendje e përhershme e të jashtmes" dhe në homo sacer si subjekt i vërtetë i të drejtave bashkëkohore të njeriut. Agamben në vepra e tij filozofike, *Open: Man and Animal*



dhe *Time Remains: Commentary on the Letter to Romans* zhvillon pikëpamjet e tij mbi mesianizmin dhe çështjen e besimit në fund të historisë. Është një lloj përgjigjeje ndaj debatit të famshëm midis George Bataille (George Bataille, 1897–1962) dhe Aleksandr Kojève (Aleksandr Vladimirovič Kozhevnikov, 1902–1968) mbi problemin e interpretimit të konceptit të Hegelit për fundin e historisë. Në këtë libër, ai e kupton mesianizmin hebre dhe të krishterë si një lloj veprimi të ligjit pas shkatërrimit të tij, duke e krahasuar atë me konceptin e universalizimit të ligjit të Shën Palit nga pikëpamja e fundit të historisë. Veprat e tij që kanë të bëjnë ekskluzivisht me estetikën janë: *Gjuha dhe vdekja*, *Stanzas: Word and Phantasm in Western Culture*, *The Idea of Prose* dhe libri më i botuar së fundmi *Profanity*. Në fakt, teoria e Agamben ka dy anë domethënëse. Nga njëra anë, ai heton problemet tradicionale metafizike dhe ontologjike dhe fushën e gjuhës, etikës, estetikës dhe historisë (kryesisht teorinë e mesianizmit të Walter Benjamin), ndërsa, nga ana tjetër, ai zhvillon një teori të re të sovranitetit si një pezullim i përhershëm i të së drejtës dhe të kuptimit tradicional të politikës, ku ndryshe nga teoria politike e Hannah Arendt (Hannah Arendt, 1906–1975), pretendon se bartësi i vërtetë i të drejtave të njeriut nuk është njeriu (njeriu) në krahasim me qytetarin, por “jeta e zhveshur”. , hendeku midis zoes së pastër (jetës biologjike) dhe bios (jetës politike), si të papajtueshëm, pra, hendeku midis qytetarit dhe njeriut. Këtu përfshihet edhe përkufizimi i tij i rinovuar për biopolitikën, i cili, ndryshe nga përkufizimi i parë i biopolitikës i dhënë nga Michel Foucault (Michel Foucault, 1926–1984), nuk nënkupton braktisjen e plotë të konceptit tradi-

cional të sovranitetit (kushtetutë, ligj) në favor të vendosjes së një sundimi të ri biopolitik mbi popullsinë përmes normave në vend të ligjeve, por e shikon biopolitikën si thelbin më thelbësor të përkufizimit klasik të pushtetit sovran që nga polisi grek deri në ditët e sotme. Sipas Agamben, i vetmi ndryshim midis formës klasike të sovranitetit dhe biopolitikës moderne është se maska, të cilën forma klasike e pushtetit nuk e hoqi, ra në epokën e modernitetit dhe se sot jemi dëshmitarë të fytyrës së vërtetë të pushtetit si një gjendje përjashtimi, dhe jeta e zhveshur (homo sacer) si bazë e saj origjinale.

#### **Boshllëku midis universales dhe të veçantës**

Megjithatë, mbetet një pyetje e hapur nëse dy aspektet e përmendura të punës së Agamben kanë ndonjë gjë të përbashkët dhe nëse kërkimi i tij gjuhësor në singularitetin e pastër të “çfarë dinjiteti” në gjuhë dhe ontologji mund të sjellë një subjektivitet të ri politik dhe pozicion etik në epokën e demokracisë globale si një mbretërim i plotë i indiferencës midis ligjit dhe faktit dhe kampeve të përqendrimit si paradigma mbizotëruese të pushtetit bashkëkohor. Në këtë mënyrë, të qenit “i tillë”, që mbetet vazhdimisht i fshëhur brenda gjendjes së përkatësisë (“ka një x të tillë që i përket y-së) dhe që nuk është ndonjë kallëzues real, shfaqet si i tillë. Singulariteti që shfaqet në këtë mënyrë është i ashtuquajturit singularitet “çfarëdo”. Sipas Agamben, antinomia midis së veçantës dhe universales është e natyrshme në vetë gjuhën. Gjuha i shndërron singularitetet në anëtarë të klasës dhe përcakton karakteristikat e përgjithshme. Në teorinë matematikore të bashkësive në logjikën moderne, përkufizimi i bash-

kësive është i barabartë me përkufizimin gjuhësor, kështu që emri përcakton kriterin për bashkësinë “M” të “m”-ve individuale. Problemi që sheh Agamben këtu është paradoksi themelor i teorisë së grupeve. Një grup në të vërtetë përcaktohet nga një ent i caktuar gjuhësor, i cili është njëkohësisht një bashkësi dhe një veçori, dhe simboli meta-matematikor për anëtarësimin (x është një element i y) nuk mund të mbushë kurrë boshllëkun midis universales dhe të veçantës, ose zgjidh këtë paradoks. I vetmi koncept që i shpëton këtij paradoksi gjuhësor është “shembulli” gjuhësor, i cili vlen për të gjithë anëtarët e së njëjtës specie dhe është njëkohësisht njëri prej tyre. Ai nuk është as i veçantë dhe as universal dhe shfaq singularitetin e tij si i tillë. Në fakt, shembulli ekziston në hapësirën boshe të ekzistencës së tij të pastër gjuhësore. Nga ky këndvështrim, Agamben kërkon singularitete të pas-tra, të cilat mund të komunikojnë me njëra-tjetrën vetëm në hapësirën e zbrazët të shembujve, sepse atyre u mungon ndonjë pronë apo identitet i përbashkët. Ato janë të përvetësuar nga të gjitha identitetet, kështu që i mohojnë vetes përkatësinë si të tillë, përkatësisht një shenjë të përkatësisë matematikore të një grupi si të tillë. Agamben tregon të njëjtin paradoks në të ashtuquajturat koncepte jo predikative, të cilat nuk përcaktojnë asnjë lloj ose specie, dhe të cilat u analizuan nga logjikani i famshëm britanik Bertrand Russell (Bertrand Russell, 1872–1970). Ato janë të ngjashme me të ashtuquajturat “ndryshore të dukshme” si “të gjitha”, “çdo”, “cilado”, të cilat Russell i sheh si totalitete të rreme, sepse ata vetëm pretendojnë të jenë pjesë e tërësisë që përcaktojnë. Megjithatë, për Agamben, të gjitha fjalët si entitete të “të qenit në gjuhë” kanë po-

thua një status si “ndryshore të dukshme”, sepse ato mund të kuptohen si specie që i përkasin dhe në të njëjtën kohë nuk i përkasin vetes, duke pasur parasysh se tashtë “të qenit në gjuhë” për Agamben është një lloj karakteristike “jo-predikative” par excellence. Me pak fjalë, çdo fjalë vepron si një shprehje gjuhësore që nuk mund të ketë fare një emër të duhur, sepse sapo përpigemi të kapim një shprehje të tillë, ajo shndërrohet në çast në një objekt përkufizimi dhe bëhet i pandashëm nga gjëja e kuptuar. Të njëjtin problem e gjejmë në kuptimin e Aristotelit për marrëdhënien midis “idesë” platonike dhe morisë së fenomeneve. Dukuritë janë sinonime në raport me njëra-tjetrën, por janë homonime për sa i përket idesë, e cila vendos homoniminë e të gjitha sinonimeve (dukurive) të shumëfish-ta dhe e cila, si pjesë e qenësishme e çdo lloji, i transformon dukuritë, duke u nisur nga përkatësia e tyre predikative, në homonime të thjeshta që manifestojnë “qënien në gjuhë” të tyre të pastër. Sipas Agamben, ideja platonike e diçkaje në fakt është “të kesh një emër”, përkatësinë e saj, “të qenurit në gjuhë” të saj. Idetë nuk kanë emra të përveçëm, por shprehen me termin grek (auto). Ideja është homonimi anonime, që është pikërisht kuptimi i shprehjes “çfarëdo”. Njësia “çfarëdo qoftë” është një singularitet për aq sa lidhet jo vetëm me një koncept, por edhe me një ide. Nuk formon një specie, por është e pranishme në të gjitha speciet. Është diçka që përjashton entitetet nga sinonimia (që i përkasin një klase të caktuar), por jo në kuptimin e mungesës së klasës (specieve) apo përkatësisë, por përkundrazi fokusohet në vetë emrin si homonimi e pastër anonime. Kjo është arsyeja pse, në pjesën e fundit të librit *Shoqëria e ardhshme*, Agamben thirret në aktin

politik të të ashtuquajturave ngjarje të Tiananmenit të vitit 1989 në Pekin si një shembull për idenë e tij për një komunitet individësh "çfarëdo qoftë", i cili ka mundësi për t'u bërë një paradigme e politikës së ardhshme, si një lloj sfide ndaj grackave të biopolitikës bashkëkohore - meqenëse politika e këtyre singulariteteve në të ardhmen mund të realizohet përmes një komuniteti që nuk ndërmjetësohet nga përkatësia (e kuqe, italiane apo komuniste), as nga mungesa e kushteve të përkatësisë, por nga përkatësia si e tillë. E ardhmja e politikës për Agamben nuk është një luftë për kontroll mbi pushtetin shtetëror, por një betejë midis "shtetit dhe joshtetit (njerëzimit)", ndarja e "çfarëdo veçorie" nga organizimi shtetëror. Kjo nuk ka të bëjë fare me dallimin mes shoqërisë civile dhe shtetit, sepse "çfarëdo veçorie" nuk mund të formojnë asnjë shoqëri dhe nuk varën nga asnjë identitet.

#### Lidhja me "të përjashtuarin"

Nëse do ta kishim përshkruar përmbytjen e librit të Agamben *Homo sacer: pushteti sovran dhe jeta e zhveshur* me një fjali si: marrëdhënia midis pushtetit sovran dhe jetës së zhveshur është marrëdhënia midis dëbimit dhe strukturës logjike ose gjuhësore të përjashtimit. Trilogjia

e Agamben *Homo sacer* e paraqet këtë problem nga tre këndvështrime të ndryshme. Jeta e zhveshur është pragu i mosdallimit midis pushtetit dhe individit, ku ligji bëhet njësh me natyrën (eksterieritetin e saj). Me shfaqjen e biopolitikës, linja e ndarjes midis strumbullarit të pushtetit dhe strumbullarit të subjektit mjegullohet dhe pushteti bëhet njëkohësisht i gjithëpranishëm dhe inekzistent. Fillimet e para të kësaj marrëdhënieje midis ligjit dhe përjashtimit, Agamben i gjen në të drejtën arkaikë romake dhe vazhdon me një vështrim të përgjithshëm të zhvillimit historik të ndërhyrjes midis strumbullarëve të përmendur në periudha të ndryshme historike, deri në atë pikë ku ai përcakton thelbin e kësaj marrëdhënieje të mishëruar në të ashtuquajturin "Musellmannen" (të burgosur të kampit të përqendrimit që jetonin në një vijë të hollë midis njeriut dhe jo-njerëzorit, siç përshkruhet nga shokët e tyre në Gjermani gjatë Luftës së Dytë Botërore). Sipas Agamben, shkrijra përfundimtare e dy strumbullarëve të lartpërmendur arrijnë një dimension absolut në kohën e tanishme, në sferën e mosdallimit të tyre. Në teorinë e Agamben-it ka një risi domethënëse në lidhje me konceptin e biopolitikës, i cili u krijua për herë të parë nga Michel Foucault. Agamben përpiket ta përballojë këtë

koncept nga të dyja anët, nga ana e pushtetit dhe nga ana e subjektit, njëkohësisht. Ai e gjen "jetën e zhveshur" si bazën e tyre të përbashkët. Mbetet pyetja nëse tashmë mund ta konsiderojmë "jetën e zhveshur" si një subjekt të biopolitikës, pasi Michel Foucault e ndau rreptësisht problemin e subjektit kur trajtonte çështjet e pushtetit dhe në mënyrë implicite çështjet e biopolitikës. Është gjithashtu e mundur të kuptohet sikur pushteti sovran bazohet pikërisht në jetën e zhveshur, pasi nuk i ka mbetur asnjë qëllim tjetër politik. Në kapitullin e tretë të *Homo sacer*, Agamben paraqet kampin e përqendrimit si një paradigme të politikës moderne dhe si një shembull të marrëdhënies imanente midis pushtetit sovran dhe jetës së zhveshur. Duke trajtuar këtë problem, Agamben fillimisht analizon strumbullarin e pushtetit sovran. Ai fillon me paradoksin sovran, siç paraqitet nga Carl Schmitt (1888-1985), i cili në librin e tij *Teologjia politike* pohon se vetëm pushteti sovran ka aftësinë të shpallë një gjendje të jashtëzakonshme (si një gjendje përjashtimi) si një përjashtim ndaj vetvetes në format e rregullave. Pushteti ka strukturën e një përjashtimi, pasi bartësi i pushtetit është njëkohësisht brenda dhe jashtë ligjit. Rregulli vendoset vetëm nëpërmjet përjashtimit dhe nuk

ekziston në të vërtetë, përveçse ndryshon nga gjendja e shfuqizimit të tij. Ky përjashtim vepron si një lloj ndalimi. Rregulli del dhe vazhdon nëpërmjet veprimit të ndalimit. Është domethënëse që rregulli nuk përjashton diçka dhe e lë atë, por mbetet i lidhur me "të përjashtuarin". Nëse Foucault në librin e tij *Disciplinë dhe Ndëshkim*; Lindja e Burgut argumenton se pushteti disiplinor ruhet përmes përfshirjes së të përjashtuarve, i cili është i ndryshëm nga forma klasike e pushtetit, atëherë për Agamben kushtetuta klasike (pushteti ose ligji) nuk ka vend tjetër veprimi përveç përjashtimi, dhe ekziston falë fuqisë së vendosjes së gjendjes së jashtëzakonshme, e cila mjegullon dallimin midis të brendshmes dhe të jashtmes, midis asaj që përjashton dhe asaj që përjashtohet. Ekziston një topologji e mosdallimit midis faktit dhe rendit juridik, midis brendësisë dhe të jashtmes, e cila sipas Karl Schmitt është vendi aktual i efektivitetit të ligjit (Ortung). Në vend të shembullit të Foucault-it të një burgu (Bentham's /Jeremy Bentham, 1748-1832/ Panopticon /Panopticon/) si një veprim i fuqisë disiplinore, Agamben merr shembullin e një kampi përqendrimi, ku rendi ligjor (përmes gjykatës) është efektivi vetëm brenda vetë mërgimit. (Përfundon në numrin e ardhshëm)

## Në spikamë

# RIKTHIMI I FJALËS ARTISTIKE QË U DOGJ NË FLUTURIMIN E PARË TË SAJ

(Disa fjalë për ribotimin e vëllimit poetik "Katërbëdhjetë autorë", botoi Klubit Letrar "De Rada" në Ferizaj)

#### Kemajl ALIU

Në vitin 1985, këtu e 39 vite më parë, teksta poetët e rinj, e prisnin me padurim daljen në dritë të librit "Katërbëdhjetë autorë" të Klubit Letrar "De Rada" në Ferizaj (libër ky, në të cilin ishte bërë prezantimi më i plotë i tyre i deriatëhershëm), ndodhi ajo më e paparashikueshëmja: libri përpos që nuk u hodh në qarkullim, ndaj tij u organizua proces kompleks penal gjyqësor, në të cilin iu shqiptua dënimi: asgjësim me DJ-EGIE. Akt i tillë ishte një shembull aq obskur, sa që ngjashmërinë për nga brutaliteti mund t'ia gjeje vetëm në Gjermaninë naziste të viteve 40-ta.

\*\*\*

Libri "Katërbëdhjetë autorë", i përgatitur për botim nga poeti dhe studiuesi R. Tuda, prezantonte një gjeneratë poetësh të një moshe fare të re (19-30 vjet), si; A. Demiri, B. Frangu, I. Aliu, Xh. Rexhepi, K. Aliu, B. Mehmeti, G. Bytyçi, S. Vranovci, M. Leka, F. Tuda, etj, të cilët atëbotë po bënin hapat e parë krijues, duke publikuar shkrimet e tyre në periodikun letrar të kohës, si: "Bota e re" "Zëri i Rinisë", "Rilindja", etj. Por, pushteti jugosllav i asaj kohe kishte vendosur që ndalesën e këtyre poetëve ta bënte me zjarr, moment ky, i cili për pasojë pati pastaj ndjekjen dhe persekutimin e këtyre autorëve në mënyra nga më të

ndryshmet për afro pesë vite rresht. Shkrimtarët shqiptarë në regjimin politik të ish-Jugosllavisë, në vazhdimësi ishin përballur me ndjekje, persekutime dhe dënime, për shkak të fjalës së tyre të lirë artistike: A. Demaçit i ishte ndaluar romani "Gjarpinjtë e gjakut", T. Dervishi kishte vuajtur dënime absurde në burgun famëkeq të "Goli Otokut", E. Mekuli, me dekada të tëra ishte përballur me përcjelljen, censurën, ndërsa A.Podrimja, për shkak vetëm të një vargu... vargut epik lapidar "Miq, Kosova është gjaku im që nuk falet", ishte kërcënuar, ndjekur dhe përndjekur në bankat shkollore si gjimnazist. Një numër i madh i shkrimtarëve shqiptarë nuk mund të botonin veprat e tyre. Ata ishin të ndaluar. Por, këto ndalesa në aspektin formal nuk bëheshin me shkrim, për shkak të një pasqyre të rreme që Jugosllavia kishte arritur ta plasonte në Evropën e atëhershme për sistemin e saj politik. Mirëpo, ndalesa e tyre bazohet në vendime të pashkruara fund e krye arbitrare, kontrollimin dhe përmbarimin e të cilave e bënte kryesisht UDB-a jugosllave. Për nga natyra shkrimtarët përgjithësisht janë problemor për sistemet politike. Janë më problemor për regjimet pushtuese, dhe ekskluzivisht janë problemor për regjimet diktatoriale. Prandaj akti i djegies së librit "Katërbëdhjetë autorë" ishte

i pangjashëm dhe nuk kishte asnjë rast analog me ndonjë rast tjetër. Nëse ky libër, për nga censurimi dhe ndalimi kishte mjaft shembuj analog, rasti i ndalimit të tij për nga brutaliteti (vënia e flakës librit) i kalonte të gjitha përmasat, ishte një akt inkuizitor mesjetar, ishte një sui generis për kohën. Censurimi, ndalimi, përcjellja, ndjekja dhe përndjekja si dhe vrasja është fat historik i shkrimtarëve në vende dhe sisteme të ndryshme politike. Por, më të përndjekurit, gjegjësisht më të censuruarit, më të persekutuarit dhe më të ndaluarit ka ngjarë ATA të jenë në diktaturat socialiste për faktin e një problemi esencial që kanë sistemet e tilla me lirinë e shprehjes (edhe Jugosllavia ishte diktaturë socialiste). Në parim pushtetet diktatoriale socialiste shpallin të përfunduar misionin e lirisë, nuk e pranojnë lirinë si kërkim dhe vazhdimësi, por si një problem të zgjidhur. Prandaj se çfarë do të jenë raportet e diktaturës me shkrimtarin, këtë më së miri e ka sqaruar shkrimtari ynë i madh, I. Kadare, i cili në një rast, duke folur për racën e shkrimtarëve thotë: "...Shkrimtarët janë mbi Lirinë". Dhe, përderisa shkrimtarët besojnë në këtë kushtimisht, diktatura socialiste e mohon apriori atë. Shkrimtarët janë problemor edhe për demokracitë. Janë problemor për demokracitë nga më të hershmet e duke mos i përjashtuar gjithse-

si edhe ato më të zhvilluarat: Kujtoni, në këtë rast, romanin "Vuajtjet e Verterit të ri" të shkrimtarit gjerman J.W. Goethe, në shekullin e XVIII, (shteti danez). Rastin e Jean Paull Sartre, shekulli i XX (shteti francez), apo edhe rastin më të ri, kur shkrimtari, mallkimi, ndjekja, liria dhe siguria e tij bëhet problem i disa kontinenteve "Salman Rushdi, me veprën e tij "Vargjet satanike". Shkrimtari francez Albert Camus, në veprën e tij "Miti i Sizifit" thoshte: "Unë nuk mund ta di se çfarë mund të jetë një liri, që do të ma jepte një qenie më e lartë. Nuk e kam idenë e hierarkisë". Andaj, pak a shumë, edhe "Katërbëdhjetë autorët" sikur udhëhiqen nga kjo premisë ... dhe përkundër disa paralajmërimeve se libri nuk mund të botohej, se do të ndalohej, e botuan atë.

\*\*\*

Fatin e hidhur të ndalesës së librit në ata sistem politik e kishte përjetuar kohë më parë para librit "Katërbëdhjetë autorët" edhe antologjia poetike "Lulet në ballkon", e cila doli në edicionin e "Zërit të Rinisë" më 1982, (pa dyshim ndër antologjitë poetike më të mira për gjysmë shekulli). Aty përfshiheshin poetët të rinj të asaj kohe, si; E. Basha, S. Hamiti, A. Mala, I. Berisha, F. Brovina, F. Selimi, R. Musliu, T. Desku, M. Xhemaili, A. Konushevcu etj. Libri u ndalua duke u hequr nga qarkullimi për shkak të

biografisë politike të M. Xhemailit. Mirëpo, në vitin 1985, kishin ndër-ruar metodat. Regjimi politik i Jugosllavisë kishte vendosur që akteve kulturore të shqiptarëve t'u përgjigjej me zjarr. Aty ku digjen librat.. do të digjen njerëzit. Dhe vërtetë, 7 vite më

vonë filloi lufta në ish- Jugosllavi.

\*\*\*

Fjala artistike nuk digjet...Ajo mund të shihet duke u djegur nën flakët e zjarrit, por nuk ndodhë ashtu, mos i besoni asaj që shihni... Ajo do të

rishfaqet përsëri, sepse ka diçka prej Feniksi. Kështu ndodhi edhe me librin "Katërmëdhjetë autorë", të cilin në vitin 2020, e ribotoi Klubi Letrar "De Rada" në Ferizaj. Kështu, ata e morën atë nga dora e "gjqqtarit" të asaj kohe "... për t'ia

dorëzuar në dorë, në këtë rast një gjyqtari tjetër, Lexuesit, për të cilin, N.V. Gogol do të thoshte: "Ai është i vetmi gjyqtar Suprem..."



*Mbi vëllimin poetik "Mëkatet e Adamit" të Musa Ramadanit*

# ADRESIMI I STREHËS SË MËKATIT

**Vëllimi i tij i parë, qysh në titull, shpërfaq intencën e autorit për të sjell diçka të re në letërsinë tonë, për të trajtuar çështje universale, të tilla që jo vetëm i tejkalonin preokupimet e zakonshme që vegjetonin brenda kufijve kombëtarë e rajonalë, por edhe që mëtonin të gjurmonin të keqen në rrënjët e saj, në fëmijërinë e njerëzimit**

## Zyrafete SHALA

Faktet që ofron historia e letërsisë flasin se botimi debutues i një shkrimtari përveç që ofron bërthamën e preokupimeve tematike të tij, shpeshherë vjen edhe si paralajmërimi fazave të evolucionit artistik të atij zëri, të padëgjuar më parë. I tillë është rasti me përmbledhjen inauguruese të poezive të Musa Ramadanit, *Mëkatet e Adamit*, një vepër kjo që përveç stilit unik, shënon edhe një largim të guximshëm nga krijimtaria konvencionale e kohës. Si gjenezë e një udhëtimi të gjatë letrar, ky libër i botuar nga Rilindja në Prishtinë, në vitin 1969,

erdhi në një kohë kur po ndodh- nin transformime rrënjësore, të cilat shënuan kthesë historike në mendësinë dhe qytetërimin evropian. Këto rrethana, i përvijon në mënyrë të thuktë Rugova, në një shkrim të mëvonshëm për krijimtarinë e Musa Ramadanit, ku veç tjerash thekson se vëllimi "Mëkatet e Adamit" lindi në kohën kur Evropa po ziente nga revoltat e të rinjve, pakënaqësia e studentëve, që kishin për qëllim çlirimin shpirtëror nga lufta e dytë dhe tejkalimin e ngufatjes që kishte prodhuar Lufta e Ftohtë. Ishte e natyrshme që efekti i këtij vullkani kulturor evropian të arrinte të vijej re edhe te shqiptarët e viseve të

mbetura jashtë kufijve të Shqipërisë, që atëbotë po përpiqeshin të krijonin një vend, pak më të sigurt në kuadër të federatës së përzier të popujve sllavë. Mirëpo, si edhe shumë herë më parë, kjo lëvizje, ky revolucion modern botës perëndimore, deri te ne arriti i ndryshuar dhe i transformuar, për të marr së fundi trajtën e një rizgjimi kombëtar dhe rikthimi në domosdoshmërinë e ruajtjes së shtyllave identitare. Pavarësisht nga ato rrethana, që krijuan një klimë të volitshme për të intensifikuar zellin e kultivimit të vlerave kombëtare, që në letërsi nënkuptonte kthimin nga poezia e traditës, në Kosovë u shfaq një brez krijuesish që

atë moment historik e shikuan edhe nga një këndvështrim tjetër, duke e vlerësuar si një udhëkryq vendimtar që krijonte mundësinë e komunikimit me botën dhe i hapte shtigje të reja letërsisë sonë. ndimtar që krijonte mundësinë e komunikimit me botën dhe i hapte shtigje të reja letërsisë sonë. E formësuar nga literatura dhe veprat e shkrimtarëve më eminentë të letërsisë së përbotshme, ndjeshmëria e këtij brezi kërkonte forma të reja të shprehësisë e teknika të reja krijuese, që përveç tjerash, doemos kërkonin edhe guxim. Nga ky brez, një nga shkrimtarët që e kishte guximin dhe kureshtjen për të eksperimentuar me poezinë, pa



dyschim ishte Musa Ramadani, që hyrinë letërsinë shqipe me një pjekuri artistike të pazakontë për autorët debutues. Vëllimi i tij i parë, qysh në titull, shpërfaq intencën e autorit për të sjell diçka të re në letërsinë tonë, për të trajtuar çështje universale, të tilla që jo vetëm i tejkalonin preokupimet e zakonshme që vegjetonin brenda kufijve kombëtarë e rajonalë, por edhe që mëtonin të gjurmonin të keqen në rrënjët e saj, në fëmijërinë e njerëzimit. Libri hapet me paratekstin e marrë nga *Dhjata e Vjetër*, kaptina 6 e *Librit të parë-Zanafilla*: "Dhe u pendua Perëndia / që e krijoi Njeriun në tokë / dhe u zemërua në veten e tij ..." - citat ky që e thotë në mënyrë të përmbledhur motivin e autorit për t'i bërë një radiografi të detajuar mëkateve njerëzore, por edhe vetë njeriut si bartës i tyre. Mëkatit, që ndërkohë u kthye në lajtmotiv të krijimtarisë së tij, Ramadani i qaset me mjete të reja letrare, që e bëjnë poezinë e tij mjaft të pakapshme për lexuesin kohës kur u botua, por jo aq të këndshme edhe për kritikën e indoktrinuara letrare. Poezitë e Musa Ramadani brenda këtij vëllimi, reflektive për nga natyra, në rrafshin tematik, gjurmojnë strukturën komplekse të natyrës njerëzore, por edhe trajektoren e formësimit të saj. Poeti mediton mbi origjinën e veseve dhe pamundësinë e çrrënjësjes së tyre. Ligjërimin e tij e karakterizon të menduarit abstrakt, shprehësia eliptike, e kondensuar, e ngarkuar në aspektin semantik, por edhe mjaft e zhveshur nga emocionet sipërfaqësore. Ngase vetë mënyra reflektive e të shprehurit kërkon diçka më shumë, sesa vetëdije dhe konstatim; të menduarit reflektiv është një proces dinamik që përpiket të përcjellë përvoja, ide, pikëpamje e bindje, t'i përçojë ato tek të tjerët. Pjesa dërmuese e poezive të vëllimit Mëkatet e Adamit shoqëro-

hen nga një ton i topitur, që ndryn në vete një dozë zemërimi, zemërim ky që bart ngjyrimet e çdo epoke, të çdo brezi që është përpjekur të rreflektojë mbi mangësitë e devijimet e llojit njerëzor. Vetë vënia e theksit te Adami, babai i njerëzimit, në njëfarë mënyre e adreson edhe strehën e mëkatit, për të vazhduar më tej të jap përmasat, por edhe rëndesën e tij në brezat vijues. Në anën tjetër, pamundësia e njeriut për krijimin e një relacioni korrekt dhe të qëndrueshëm me kohën, duket të jetë ekuivalente me pamundësinë e gjetjes së një gjuhe të përbashkët për komunikim mes vete. Këtë problematikë e ndërthen në vete poezia Dialog i parëndomtë, ku në vargjet e fundit poeti nxjerr klithmën e kohës: O me shkop përmbropa njerëzit i ndoqa / Njëri-tjetrin diku në hapësirë ta mbërrijnë / Duarte zemrat që t'i bëjnë njëherë një / Por... / Koha foli kështu e kurrë më nuk u ndi. Te kjo poezi, ashtu si edhe te shumica e poezive të këtij vëllimi, veçohen tri topose, mbi të cilat ndërtohet universi poetik i autorit: njeriu, mëkati dhe koha, të cilat më tej i shohim në relacione të ndryshme mes vete. Lidhja simbiotike mes njeriut dhe mëkatit, e bëri që ai të mbetet peng në kohën e turpit (siç e quan autori te poezia Pa shpjegim), më tej, për të ndryshuar gjendjen e tij, njeriu i qaset kohës, synon ta ndjek atë, e qëllon me pushkën e mëkatit, dhe së fundi ngelet i dëshpëruar me këmbët ngjitur në baltën mëkatore (Apokalipse nate). Duke qenë simbol i mesazhit poetik, mëkati bëhet determinant i fatit të njeriut përgjatë rrugëtimit të tij historik. I kthyer në një damkë të përjetshme, i bën të pa sigurta edhe marrëdhëniet brenda vetë llojit, siç shihet te poezia Këshilla mikut tim, një dialog ky i monologjizuar dhe një nga poezitë që bartin esencën e natyrës njerëzore: Mik

/ Shtëpitë tona si gota cakërrohen / Gjerdhe as dyer përmes s'kemi bërë / Dielli / Udhën deri te ne kur e gjen / Gëzim kuj më tepër i bjen: / Ty apo mua? Edhe brenda këtyre pak vargjeve lehtësisht bie në sy përgjegjësia me të cilën poeti i qaset aktit krijues, duke bërë përzgjedhje të përpiktë të fjalëve, duke i vendosur ato saktësisht në vendin e duhur, duke eliminuar qoftë edhe një lidhëz të panevojshme, arrin që me pak fjalë të skicojë terrenin ku zë fill e keqja. Kjo pedantëri, kjo disiplinë, kjo saktësi në emërtimin e gjërave dhe ndërtimin e kuptimit, përcillet edhe te mbarështrimi i lëndës, tek organizimi poetik i vargjeve e i poezive brenda këtij vëllimi. Mendimi i tij është i thellë, shprehja shumë e sofistikuar, ngase është tejet personale, ashtu siç janë rëndom poezitë që shprehin mendim abstrakt. Duket se te vargjet e Musa Ramadani merr më shumë kuptim thënia e Eliotit: Poezia nuk është një kthim i emocioneve, por një arratisje nga emocionet; nuk është shprehje e personalitetit, por ikje nga personaliteti. -Ngase, vetëm ata që kanë personalitet dhe emocione e dinë se çfarë do të thotë të duash të shpëtosh nga to ose së paku dinë t'u vënë kod atyre dhe të komunikojnë vetëm me ata që arrijnë të zbërthejnë gjuhën e koduar. Pavarësisht nga fakti që kritika dhe lexuesi i kohës, në përgjithësi, nuk arriti ta vlerësojë sa duhet artin e Musa Ramadani, një gjë e saktë u tha edhe atëherë, se në vëllimin Mëkatet e Adamit ai: ka dhënë shenjat e një sensibiliteti çfarë në ambientin tonë do të zhvillohet vetëm pas ca vitesh, apo ndonjë deçenie... - shkruan Qosja, duke shtuar më tej se: Në qoftë se një poet i ri si M. Ramadani, e fillon rrugën krijuese me një përmbledhje ashtu serioze, është e drejtë të besohet se ai ka kuptuar që poezia bashkëkohore është një këngë

e re që don edhe instrumente të reja, që kërkon të artikulohet në mënyrë të re. Së fundi, po i rilexoj poezitë e vëllimit Mëkatet e Adamit me atë ndjesinë e kufizimit që të krijon të lexuarit me qëllim të dhënies së një mendim kritik për to. Por derisa lexoj, nuk i shmangesha dot dëshirës që kësaj radhe të mbetesha vetëm në cilësinë e lexuesit, të përjetoja atë kënaqësi estetike që të ofron letërsia elitare dhe të zhytesha në përsiatjet që nxisin vargjet e Musa Ramadani. Sigurisht, për ta përligjur atë ngulmimin për të ruajtur statusin tim të lexuesit, më erdhi ndërmend mendimi i Bartit që thotë se: Të lexosh do të thotë ta duash veprën, të identifikohesh me të... Ndërsa, të kalosh nga leximi në kritikë do të thotë ta ndryshosh dëshirën, të mos e duash më veprën, por gjuhën personale.

Shkurt, 2024

#### KËSHILLA MIKUT TIM

Mik  
Shtëpitë tona si gota cakërrohen  
Gjerdhe as dyer përmes s'kemi bërë

Dielli  
Udhën deri te ne kur e gjen  
Gëzim kuj më tepër i bjen:

Ty apo mua?  
Mik  
Livadhet tona si dashnorë puthen  
Gurë a mezhde askund s'kemi vën  
Shiu  
Sixhim teposhtë kur ligron  
Në cilin më shumë fryt lëshon:

Në tëndin apo timin?

Atëbotë  
Kujtohu mirë, lum miku im  
Përse prore më bën të druaj?

Se për dallim o dredhim  
Koha ka herë ka kaluar

# ESAD MEKULI DHE LETËRSIA SHQIPE E VITEVE '70

Figura letrare e Esad Mekulit bëhet emblematike për të gjithë krijuesit shqiptarë të Kosovës së viteve '70



## Nehas SOPAJ

Esad Mekuli dhe letërsia shqipe e viteve '70, presupozon një shqyrtim figurës letrare të poetit tonë në kontekst të kohës së apostrofuar në titull, ku kryqëzohen dhe kulmojnë vlerat e pakontestueshme të një vargu individualitetesh letrare shqiptare, kur poeti e rrumbullakoi profilin e tij letrar. Krahas tre librave poetikë, Për ty, Brigje dhe Afsha Ada, të botuara para viteve '70, gjatë dhe pas atyre viteve, që marrë në përgjithësi, nuk paraqet më tepër se një libër të trashë poetik, Esad Mekuli nuk ka botuar më vonë pothuaj asgjë, pos ndonjë poezie të rrallë. Kjo i bie se poeti ka shkruar pak, diçka si edhe Lasgush Poradeci e Migjeni, por vlerat e poezisë së tij mund të vlerësohen lehtë, ndryshe nga këta poetë, kurse për këta poetë kanë shkruar dhe shkruajnë së reshturi edhe sot. Në të vërtetë, kritika letrare e kohës, që moti e ka thënë mendimin e saj për këtë poezi. Për poezinë e poetit është shkruar më shumë se pothuaj për çdo krijues tjetër të Kosovës. Në kohën kur u botuan poezitë e poetit, kritikët letrarë e shquanin aktualitetin dhe

angazhimin e madh të autorit ndaj rrethanave kohore, kështu që mendimi i tyre përherë ishte në kolizion me atë kohë dhe në përgjithësi ishte në superlativ. Arsyeja është, sepse ajo poezi ishte përgjigje rrethanave politike të asaj kohe, të kohës së para Luftës së Dytë Botërore, gjatë dhe pas saj, prandaj ato s'ishin larg vetë ideologjisë së asaj gjuhe dhe të atij verbi poetik. Në shtypin e kohës, ka shkrime e mendime të ndryshme për poezinë e poetit, dhe kritikë të ndryshëm, shqiptarë, jugosllavë dhe të huaj, flisnin pozitivisht për poezinë e poetit, natyrën teorike të saj, vlerave të saj. Krahas shqip, poezitë e poetit qenë prezantuar dhe përkthyer edhe në gjuhë të ndryshme të hapësirës së ish Jugosllavisë dhe ato sot gjenden të prezantuara nëpër antologjitë më në zë të kohës, me përktihime të mrekullueshme që s'ishin vetëm të arealit sillav, por edhe të gjuhëve tjera të shtetit që s'është më. Me një fjalë, ndryshe nga krijuesit e tjerë, për Esad Mekulin shkruhej shqip dhe në gjuhë të tjera, dukshëm më shumë se sa për të gjithë të tjerët. Tash kjo ngjet sikur janë thënë të gjitha dhe s'ka më çka të thuhet, pos që të përsëritemi, edhe pse dik-

tuar nga aktualiteti, gjërat mund të thuhën edhe ndryshe, me metoda më të reja që shkenca e letërsisë prin me përvoja dhe ekspertiza teorike që ne akoma nuk i njohim. Do të orvatemi të flasim për Esad Mekulin në relacion me disa autorë të tjerë shqiptarë që krijonin në kohën e viteve '70. Kjo dekadë, pra vitet '70-ta është pika më neuralgjike e kulmimit të letërsisë shqipe që me shumëçka përkon dhe mund të krahasohet me letërsinë shqipe të viteve '30, pa marrë parasysh rrethanat fare të ndryshme. Në atë kohë, pra në vitet '70-ta, mblidhen dhe gërshtohen shkrime nga më të ndryshmet të disa gjeneratave dhe kjo paraqet një konglomerat stilesh, pothuaj të papërsëritshme, ku mund të shihet e veçanta e atyre krijuesve, që këtu edhe stili dhe diskursi i autorit tonë. Tani kur autori ynë nuk është më dhe kur vepra e tij gjendet në fazën e një "fjetjeje" estetike, mendoj se poeti s'meriton të harrohet, por të vazhdojë të jetë objekt trajtimi ku studiuesit mund t'i matin vlerat e tyre të vërteta, pa emocionet e vlerësim-it entuziast, kurtuaz, siç kish ndodhur më parë, por të shquhen vlerat, cilësitë dhe risitë e saj, duke folur

edhe për mangësitë eventuale, sidomos kur e marrim parasysh utopinë e kohës, kohën e vëllazërim-bashkimit të rrejtshëm etj. Të flitet për poezinë e autorit me vlerat e saj të pakontestueshme, të shpjegohet konteksti kohor me shpjegim adekuat, shoqëruar me prezantimin gjithnjë dinjitoz të shkrimtarit, i cili rri si refuzues i vërtetë i sfidave të kohës që s'është më, e me këtë opinionin lexues të bindet me zërin e arsyes së shëndoshë. Realisht, në gjithë historinë e zhvillimit, letërsia shqipe shkëlqimin e vet e arrin dy herë: në vitet '30 dhe në vitet '70 të shekullit të kaluar, dhe kjo ndodh në rrethanat e dy krizave më të mëdha botërore, herën e parë mes këtyre dy luftërave botërore dhe dy dekada pas Luftës së Dytë Botërore. Herën e parë, në vitet '30, është koha e atmosferës më morbide të të dy ideologjive supreme, fashizmit dhe komunizmit, që po luftonin për ngadhënjim, garonin që ta mbisundojnë botën mu atëherë kur populli shqiptar po përjetonte krizën më të thellë sociale dhe kur njerëzit vdisnin rrugëve nga uria. Herën e dytë, në vitet '70, në kohën kur pas ngadhënjimit të komunizmit kur



shqiptarët ranë që ta shijonin "mollën e ndaluar" të diktaturës: dhunën, represionet dhe censurën e fjalës së lirë. Në rrethanat që tashmë dihen, letërsia shqipe zhvillohej e ndarë, me dy formate stilistike: e para, në shtetin ërnë, si letërsi tërësisht e ideologjizuar, që duke dëshiruar ta krijojë prototipin e njeriut të ri, e krijon një të vërtetë të paqenë, objektivisht të pamundshme për kohën, krejt groteske sot, dhe tjetra, në pjesën e dytë të atdheut: një letërsi me pak ngjyra ideologjike, por shumë "e vështirë" për receptim, të menduar e të shkruar nën mendenat e një autocensure, me një të vërtetë të mbyllur hermetikisht për lexuesin, por që ishte e vetmja gjuhë komunikimi në mungesë të lirisë së fjalës. Letërsia e viteve '30 ka një varg individualitetesh letrare të veçanta, të verifikuar në rrafshin kombëtar. Sikundër dihet, At Gjergj Fishta, Fan Stilian Noli, Lasgush Poradeci, Migjeni, Ernest Koliqi, Et'hem Haxhiademi etj., në veprat e tyre e pasqyrojnë realitetin ashtu siç ishte: një shoqëri me përplasje të thella ekonomike. Ja paradoksi: pikërisht në flakë të kësaj letërsie, për herë të parë ndjehet pluralizmi stilistik letrar shqiptar, në të cilin njëkohësisht krijohet romantikë, realiste, realiste klasikë, realiste kritikë, pseudoklasikistë, simbolistë etj. që në fakt, variojnë me stile nga më të ndryshme të shkrimit. Pas Luftës së Dytë Botërore, pas shndërrimit të gjithë letërsisë në sociologji, dy dekada më vonë, në vitet '70, mjeshtërisht dhe me shumë sakrificë të shkrimtarëve, ky trend letrar ringritet duke e rivënë pluralizmin stilistik atje ku kishte qenë që në kohë të midis dy luftërave, tani duke transformuar dhe modifikuar edhe formacionet stilistike të shkrimit. Në veprat letrare të shkrimtarëve Jakov Xoxa, Martin Camaj, Dritëro Agolli, Ismail Kadare, Rexhep Qosja, Anton Pashku, Ali Podrimja, Teki Dervishi, Vath Koreshi, Xhevair Spahiu, Beqir Musliu, Moikom Zeqo, Zejnullah Rrahmani etj. në vitet '70, krahas realizmit socialist, tipik për shkrimtarët që krijojnë brenda shtetit amë, sërish rivendoset pluralizmi stilistik i letërsisë shqipe, i bartur tani në Kosovë me rrymimet: realizmi klasik, simbolizmi,

impresionizmi, ekspresionizmi, surealizmi deri te postmodernizmi, që kritika e kohës i identifikon si hermetizëm, por që në fakt ishte lëvizje avangarde që krijon art të mirëfilltë letrar që gjer sot akoma ka mbetur i pastudiuar. Nismëtar e bard i letërsisë së sotme shqiptare të Kosovës me kuptimin e plotë të fjalës, prej duarve të të cilit parakaluan pothuaj të gjithë krijuesit e të gjitha gjeneratave të shkrimtarëve, Esad Mekuli ka shkruar pak. Megjithatë, nëse heqim një paralele krahasimi të atyre krijuesve që kanë shkruar pak, por që qëndrojnë në fron të vlerave që kanë, siç janë psh. Lasgush Poradeci ose Migjeni, me gjithë respektin, vendi i autorit tonë nuk është i atij niveli. Nëse Lasgush Poradeci e Migjeni në vitet '30 kishin shkruar shumë pak, por që me meritë paraqesin figurat qendrore të historisë së letërsisë shqiptare, si kulme letrare të pazëvendësueshme, është sepse Lasgush Poradeci është themelues i simbolizmit dhe i poezisë së pastër shqipe, kurse Migjeni themelues i realizmit kritik. Ndërkaq Esad Mekuli, nga ana tjetër, nga poezia që është fahu i tij i angazhimit, me gjithë gjeninë dhe vlerat e pakontestueshme që ka, është e pamjaftueshme të radhitet në mesin e shembujve si më lart, pos nëse ia atribuojmë meritat me të cilat nuk do t'ia nderonin profilin krijues. Fill pas luftës e deri në vitet '70, nga gjiri i një rrethi të gjerë krijuesish të Kosovës që nisën të shquhen si vlera të pakontestuar letrare e që sot çmohen si simbolistë, ekspresionistë, impresionistë, surealistë deri edhe posmodernistë, Esad Mekuli është nismëtar i gjithë letërsisë së Kosovës dhe vazhdues i shkollës letrare sociale të Migjenit. Ndërkaq, emrat Jakov Xoxa, Martin Camaj, Dritëro Agolli, Ismail Kadare, Rexhep Qosja, Anton Pashku, Ali Podrimja, Teki Dervishi, Vath Koreshi, Xhevair Spahiu, Beqir Musliu, Moikom Zeqo, Zejnullah Rrahmani etj. që në ato vite emblematike e ngjisin letërsinë shqipe drejt majës së piramidës që sot është vlerë mbarëkombëtare, bëjnë që vepra e Esad Mekulit të na duket e minimalizuar dhe të na duket vetëm vlerë nderi e jo vlerë që konkurren me mega veprat e këtyre

autorëve. Duke u nisur nga poezitë e autorit, dhe sidomos nga bagazhi i madh i shkrimeve të shkruara për të në kohë kur ai ishte gjallë, sidomos duke e parë heshtjen e kritikës përpos ndonjë shkrimi të rrallë, mbase për shkak të ndryshimeve të mëdha që kanë ndodhur këtyre dekadave të fundit, ngjet sikur Esad Mekuli u harrua. Realisht, emri i autorit s'rrësht së lokuari me pietet edhe sot nëpër antologjitë dhe tekstet shkollore dhe universitare ku përpiluesit vazhdojnë së foluri pro figurës së tij letrare sipas plan-programeve, por kritika letrare sikur ka mejtur për të. Me këtë rast, sa për ilustrim do ta kisha përmendur Martin Camajn, krijuesin dhe poetin të cilin Esad Mekuli e kish pasur bashkë-nismëtar të veprimtarisë kur ai, Martin Camaj pra, në Prishtinë i kish botuar dy librat e tij të parë poetikë. Krahasimi është paradoksal, gjersa sot Marin Camajn e kemi në gojë përditë, dhe pa masë gëzohemi për vlerësimet që i bëhen atij edhe pse post-hum, organizohen simpoziume, bëhen studime shkencore, botohen komplete letrare të autorit etj., Esad Mekulin sikur e kemi harruar. Pa një qëllim matjeje të vlerave që kanë këta dy krijues, disproporcioneve që kanë njëri-tjetri, e quajta paradoksal, sepse nga të gjitha librat e Esad Mekulit, po t'i krahasojmë me duzinën e librave të të tri gjinive letrare të Martin Camajt, kuantiteti që flet për epërsinë shumë të madhe të të dytit ndaj të parit, me automatizëm me asgjë nuk garanton për kualitetin e krahasimit. Sepse, as shija e masës së madhe të lexuesve dhe as shkrimet e shumta kritike që shkruhen sot për akëcilin krijues, nuk garantojnë për jetëgjatësinë e veprës së tyre letrare, sepse vetëm sovranit kohë është gjykatësi më i mirë që do ta japë përgjigjen e vërtetë. Meqë Esad Mekuli ishte vetëm poet, jo rastësisht temën time dua ta reduktoj drejt krahasimit të figurës së poetit vetëm me vargun e poetëve të tjerë që lindën falë revistës letrare Jeta e Re, të cilën e drejtoi ai që nga fillimi, për të thënë se veprat e tyre më të mira poetike, prozaike e dramaturgjike, u krijuan pikërisht falë përkrahjes morale të poetit. Kur

e krahasojmë diskursin e autorit me ata të Enver Gjerqekut, Murat Isakut, Din Mehmetit, Azem Shkrelit, Adem Gajtani, Fahredin Gungës, Rrahman Dedjes, Ali Podrimjes, Besim Bokshit, Qerim Ujkanit dhe poetëve të gjeneratës më të re, siç janë poezia e Teki Dërvishit, Beqir Musliut, Musa Ramadani, Eqrem Bashës, Nexhat Halimit, Sabri Hamitit, Shaip Beqirit etj. pa i numëruar edhe dhjetëra të tjerë, me laryshinë e madhe të stileve të shkollave të ndryshme letrare që ata krijojnë, me oscilime të këtyre diskurseve, ajo që na shkon mendja menjëherë kur e bëjmë krahasimin, është se të gjithë këta krijues, në pikë neuralgjike e kanë vatrën, pra autorin, dmth. mësimet e shkollës së autorin tonë, Esad Mekuli, te poezia e tij e angazhuar. Edhe pse të gjithë vetveten e tyre, pra stilin e tyre të shkrimit, nuk e parallogarisin stilin dhe diskursin e Esad Mekulit, pra edhe pse shumica prej këtyre krijuesve herët e kanë braktisur mësimin e mësuësit, pra duke mos krijuar poezi të angazhuar, por poezi të paangazhuar, kurse disa prej tyre madje edhe duke krijuar shkollë vetanake letrare çfarë i bën krejt të mëvetëshëm që aspak nuk përkohet me të, me Esad Mekulin pra, megjithatë, në embrion, në zanafillë e kanë autorin. Që këtu, figura letrare e Esad Mekulit bëhet emblematike për të gjithë krijuesit shqiptarë të Kosovës së viteve '70, sado që ai mund të jetë tejkaluar nga disa krijues dhe filli i nismave të atyre krijuesve mund të mos duket fare, shkrimi i tij do të ndjehet si vlerë letrare konstante estetike. Kështu, distanca e "fjetjes" së gjatë të veprës letrare të Esad Mekulit, nuk na jep të drejtën ta harrojmë atë. Prandaj, nga një fjalë e urtë latine e cila thotë - jepini Cezarit atë që është e Cezarit, më lejoni ta bëj parantezën time: jepni Esad Mekulit atë që është e Esad Mekulit. Edhe atë, jo për hir të karizmës së emrit të tij, por për hir të vlerës që ka ajo vepër, sado e paktë që të jetë ajo.

## Reflekse

# DEMINUTIVËT NË POEZINË E LASGUSHIT

**Kuptimi zvogëlues e përkëdhelës që Lasgushi ua jep fjalëve në poezitë e tij, në rend të parë, motivohet nga vetë tematika e tyre**

### Hysen MATOSHI

Njëra nga veçoritë gjuhësore dhe stilistike të poezisë së Lasgush Poradecit është edhe përdorimi mjaft i dendur i deminutivëve. Fillimisht shtrohet çështja nëse deminutivët do të mund të konsideroheshin si një përbërës i rëndësishëm stilistik kundruar në kontekstin e totalitetit të veprës letrare, sidomos po të merret parasysh fakti se te ne, në të kaluarën, pak ose aspak janë trajtuar si të tillë? Lidhur me çështjen e vlerës

së secilit përbërës një përgjigje e jep studiuesi i njohur Wolfgang Kajzer: Synimi i shkencës së letërsisë, para së gjithash, është i orientuar në të kuptuarit dhe të interpretuarit e veprës letrare. Puna e tillë nuk synon që ta shqyrtojë veçmas secilën formë gjuhësore, por kontributin e saj për strukturën e gjithmbarshme të veprës letrare... Kjo bëhet bëhet me qëllim që të krijohet një pamje tërësore për veprën. Kjo punë, prandaj synon sintezën. Stili është term sintetizues për tërësinë në kuadër të së cilës

hyjnë të gjitha format gjuhësore të një veprë. Pra, po qe se mbështetemi në kriterin kontribut i një forme gjuhësore, për të cilin bën fjalë Kajzeri, do të konkludonim se rëndësia e deminutivëve në kontekstin e trajtimit stilistik del e pashmangshme. Kjo gjë mund të pohohet më pak kur është fjala për dendurinë e fjalëve që marrin kuptim zvogëlues (sado që numri i tyre është i konsiderueshëm) dhe shumë më shumë për faktin se ato i japin një ngjyrim tërësisht të veçantë stilistik e gjuhësor poezisë së

Lasgushit, ndaj vlera e tyre në rend të parë është funksionale. Kuptimi zvogëlues e përkëdhelës që Lasgushi ua jep fjalëve në poezitë e tij, në rend të parë, motivohet nga vetë tematika e tyre. Kështu, mund të vërejmë se deminutivët, në të shumtën e herave, ndeshen te krijimet me temë të dashurisë, andaj edhe mund të pohohet se deminutivimi i fjalëve është në funksion të krijimit të një situatë më të të butë adapte për temën e dashurisë - dhe për rrjedhojë ato krijojnë një ngjyrim përkëdhelie. Fo-

rmat e fjalëve, si: vashëza, zemërzë, syçkëzat, façkat, qipallëzë etj. krijojnë një lidhje të pashkëputshme me përmbajtjen erotike të lirikave të Lasgushit, herë duke e krijuar sfondin mbi të cilin do të këndohet kjo tematikë, herë duke e përshkruar bukurinë fizike të vashës. Dëshmi sesi e krijon atmosferën e butësisë për poezitë e tij të dashurisë mund të jenë këto dy strofa:

Ti po vjen që prej së largu magjiplote-e dal-nga-dal.

Ti po vjen që prej së largu dyke shkitur mbi lëndina.

Nënë thembërzat e tua përgëzohet trendelina,

Shtrihet lulejamitare e zëmbakut që t'u fal.

E si shkon me hap të matur më push-ton një dhembshuri:

Do të tretemtë kullohemnë kalimtë këmbës s'ate,

Ti pushtoj i llaftaruar ato hapëza mëkate

Ndaj kalon mbi tufë lulësh madhërisht si yll i ri.

Fjalët thembërzat dhe hapëzat, të përdorura si deminutivë në këto vargje, sado që nuk krijojnë kuptime të reja leksikore, përmes karakterit zvogëlues-përkëdhelës që marrin në sajë të prapashtesës (ë)z, i japin një ngjyrim të ri dhe një ngarkesë të veçantë emocionale poezisë. Lasgushi si krijues me talent dhe veçmas me një kulturë të gjerë nga fusha e arteve përgjithësisht dëshmohet edhe si njohës i mirë i kategorive estetike: ai është i vetëdijshëm se simpatikja si kategori estetike ndërlihet me të voglën, të brishtë, andaj hapat kthehen në hapëza, thembrat e vashës shndërrohen në thembërza dhe vetë vasha në vashëz. Gjithashtu, duke deminutivizuar një fjalë, pra duke krijuar një kuptim zvogëlues, Lasgushi synon që ta rrisë shprehshmërinë e tij poetike, ta përqendrojë vëmendjen e recipientit pikërisht në fjalën së cilës i vë një prapashtesë zvogëluese. Është e ditur se deminutivët, kundruar nga aspekti i qëllimit të përdorimit, mund të jenë trefarësh: deminutivë që shprehin një kuptim përkëdhelës, zvogëlues (ndonjëherë në të njëjtën kohë edhe përkëdhelës edhe zvogëlues) dhe pezhorativ. Duke përjashtuar llojin e tretë, që pothuajse nuk haset në krijimet e Lasgushit, do të themi se kuptimi që shprehin deminutivët e tij janë kryesisht të simbiozës përkëdheli-zvogëlim. Sa i përket formimit të deminutivëve Lasgushi përdor disa nga prapashtesat që në gjuhën shqipe në këtë funksion hasen më dendur. Pa dyshin që prapashtesa më e pranishme në këtë kontekst është prapashtesa zë (por ndeshet edhe si ëz dhe z, varësisht nga përbërja tingullore e fjalës që deminutivizohet). Funkzioni i saj i rëndomtë edhe në poezinë e Lasgushit është të krijuarit e kuptimeve zvogëluese-përkëdhelëse të cilat e rritin shprehësinë e poezisë së tij, ndërsa sa u përket pjesëve të ligjëratës emrat janë ata që zotërojnë shumicën e fjalës të deminutivizuar. Kështu veçojmë këta emra që marrin prapashtesën zë (ëz dhe z): zemrëzën (e ndeshim edhe trajtën zembrëz), vashëza, motrëzën (e ndeshin edhe trajtën e deminutivizuar motriçka, që mbase pasqyron ndikimin e deminutivizimit në të folmen lokale), klithmëz, hapëza,



thembërzat, qipallëzën, shkronjëz, pasqyrëz, cipëzën, lesh-verdhëza, këngëzën, fjalëzë, mesditëza, herëzën, fluturëz, pushkëzën, gunëz, korijëza, lëndinëza, bimëzat, lodërzat, gropëzën, napëzën etj. Lasgushi nuk ngurron që ta deminutivizojë edhe ndonjë emër të përveçëm, siç ndodh me emrin e Nafijes (të fejuarës dhe më vonë gruas së tij), të cilën në ditarin lirik të paraluftës e quan Nafijezë. Pra, nga sa mund të shihet me këtë prapashtesë, në pajtim me natyrën e shqipes janë deminutivizuar emra të gjinisë femërore, mirëpo po me prapashtesën zë (ëz dhe z) Lasgushi provon të krijojë deminutivë edhe nga pjesë të tjera të ligjëratës (folje, përmemër pronor) te fjalët: shihmëzë, shqipëzuar dhe (shoqe) të mijëza etj. Madje, në krijimin Zemra (Këngë), kur është fjala për përdorimin e prapashtesës zvogëluese zë, hetojmë prirjen e Lasgushit që këtë përdorim të saj ta shtrijë edhe te ndajfoljet:

Ha! tek bëj kështuzë,

Hop! të shoh këtuzë!

Ha tek bën ashtuzë,

Hop! buzë-për-buzë.



Deminutivizimi i fjalëve te Lasgushi shtrihet edhe në përngjitjet e tij aq të shpeshta. Bie fjala, në poezinë Naim Frashërit, në vargun E shashtisur po nga flaka pendë-shkruarëza flutur, ai deminutivizon përmes mbaresës ëz fjalën e dytë të përngjitjes pendë-shkruarëza, përkatesisht trajtën mbiemrore shkruarëza. Një trajtë tjetër e deminutivizimit të emrave të gjinisë femërore, të cilën e gjejmë në ditarin e tij lirik dhe që bëhet nën ndikimin e të folmes di-

alektore, realizohet edhe përmes prapashtesës kë: unaskë, karafilkë, gjilpërkë, nusk e lalës, siskën (ndeshet edhe trajta cickat), façkat etj. Krahasuar me numrin e emrave të gjinisë femërore që deminutivizohen emrat e gjinisë mashkullore në këtë kontekst dalin më të paktë nga numri i tyre dhe më të rrallë nga shpeshësia e përdorimit. Është e natyrshme që Lasgushi, poet i madh i dashurisë, butësinë e tij prej këngëtari ta shprehë ndaj botës femërore dhe aspekteve që identifikohen me të. Megjithatë, ai u jep kuptim zvogëlues e përkëdhelës edhe disa emrave të gjinisë mashkullore të cilëve ua shton prapashtesat përkatëse th dhe ush: zëth, mëmëdhethit, mjerush, trimush etj. Lasgushi gjithashtu deminutivizon edhe trajtën mbiemrore i ardhur në poezinë Korrik te vargu:

Ri në shullër fatlum një zog ardhushi

Megjithëse deminutivizimi i fjalëve në poezinë e Lasgushit nuk është gjithnjë funksional, ngase aty-këtu ky veprim del në funksion të strukturës së caktuar të rimave dhe jo të ndonjë aspekti përmbajtësor, për-

mirëpo vlera më e madhe është se i shton aftësitë shprehëse-emocionale të gjuhës së tij poetike nga njëra anë dhe nga ana tjetër e veçon stilin e tij poetik, duke krijuar një fakt më shumë për origjinalitetin e tij krijues, sidomos kundruall poetëve bashkëkohës. Duhet të theksojmë me këtë rast se ngritja e deminutivizimit në nivelin e një përbërësi stilistik të një autori të letërsisë shqipe, megjithatë, nuk nis me Lasgushin, ngase ai, si edhe në shumë aspekte të tjera të krijimtarisë, del pasues i rrugës që kishte hapur më parë rilindësi ynë i madh, Naim Frashëri. Akademiku Rexhep Qosja, duke e njohur zvogëlimin si një nga përbërësit e stilit të Naimit, në monografinë Porosia e madhe, konstaton: Megjithëse në krijimtarinë e tij nuk kanë shtrirjen e zmadhimeve dhe megjithëse nuk janë shprehëse sa ato, edhe zvogëlimet janë një mjet letrar, që e karakterizon stilin e Naim Frashërit... Zvogëlimi në krijimtarinë e tij... mund të luajë edhe role të tjera kuptimore, emocionale dhe stilistike: mund të jetë mjet i shprehje që tregon afrinë, mëshirën, dashurinë, ironinë apo, kur e kur, edhe vogëlsinë e asaj që paraqitet. Një studim tjetër me interes për rolin e deminutivëve për përcaktimin e veçorive stilistike e gjuhësore në një vepër letrare është edhe ai i Shefkije Islamajt Deminutivët dhe hipokoristikët, pjesë e monografisë Gjuha e Jakov Xoxës veçori leksiko-semantike dhe stilistike. Përveç faktit se e ka argumentuar vlerën dhe rëndësinë e deminutivëve në veprën e njërën nga stilistët tanë më të mirë përgjithësisht, Shefkije Islamaj ka bërë edhe këtë konstatim të rëndësishëm dhe përgjithësues mbi funksionin gjuhësor e stilistik të deminutivëve: Si njësi shprehëse gjuhësore, deminutivët jo vetëm se shprehin emocionalitet, por edhe ngjyresa vlerësuese, intensiteti i të cilave dallon nga konteksti në kontekst, për çka teksti zakonisht del në pikëpamje gjuhësore e stilistike shumë më i motivuar e shprehës, madje në shumë raste, kur gërshetohet me njësi tjera shprehëse, teksti merr ton lirik të theksuar.... Me gjithë vlerën përgjithësuese të këtij definicioni dhe me gjithë faktin se ka pikënisje veprën e një autori tjetër, mund të thuhet lirisht se, si i tillë, mjaft mirë e qartëson edhe kontekstin e përdorimit dhe të funksionalizimit të deminutivëve në veprën e Lasgushit Poradecit. Përfundimisht, Lasgushi nuk është poet që mund të krenohet për kuantitetin e fjalës poetik, sepse, siç dihet, ai është tejet i kufizuar, dhe mund të thuhet se është ndër autorët tanë më përzgjedhës në këtë drejtim, por të veçantë si poet e bën fakti se ai mbështetet në përpunimin e fjalës, në lëmimin e shprehjeve e vargjeve dhe deminutivët janë veçse aspekt i zbatimit të këtij koncepti poetik. Teoricienë të letërsisë për dallimin ndërmjet gjuhës dhe stilit poetik, jo rrallë, e kundërojnë në shmangien e qëllimshme të shkrimtarit nga ai që konsiderohet kumtim i rëndomtë, në zgjedhjen e mënyrës që ta thonë ndryshe atë që mendojnë dhe ndiejnë. Nëse do ta merrnim parasysh këtë përkufizim në rastin e Lasgushit do të mund të përfundonim se deminutivët, vërtet, janë një nga zgjedhjet e çrëndomësimi gjuhësor, përkatësisht të formësimi të stilit të tij si krijues.

Shkoqitje

# ALBANIZMA LETRARE E KANUNIT

**Albanizma është cilësuar nga kritika si një vepër që shpreh vullnetin dhe dëshirën që më në fund shqiptarët, pasi kanë përmbushje detyrat historike, të flasin për vetveten**



**Afrim REXHEPI**

Teoria e letërsisë në dy shekujt e fundit njihet katër sisteme teorike: pozitivizmin, fenomenologjinë, semiologjinë dhe dekonstrukcionin, pa i shënuar fraksionet paradigmatiche të tyre. Sistemet e shënuara teorike, treguan se përpjekjet për të kapur sistemet totale (edhe atëherë kur bënin përpjekje asimetrike si për shembull sistemi i dekonstrukcionit), përfunduan në mbeturina metateorike. Është fakt i pamohueshëm që sistemet e shënuara teorike – metodologjike, bënin përpjekje për të projektuar një sistem të aftë për të kapur kuptimin e tekstit letrar. Me strukturalizmin, leximi subjektiv dhe interpretimi / kritika, kaloi në krizë të heshtur, sepse nuk mund të përcaktohej vlera estetike e një vepre letrare. Në fakt, strukturalizmi përjashtoj kritikën si disiplinë dhe nuk bëri dallimin midis të kuptuarit dhe interpretantit. Edhe post-strukturalizmi dhe dekonstrukcioni nuk arritën të bëjnë më tepër në pjesën për kritikën. Nëse do të pranohej koncepti dekonstruktiv i kuptimit, atëherë do të duhej të pranohet fakti që gjuha nuk mund ta shpreh realitetin objektiv. E nëse gjuha nuk e ka aftësinë e duhur për ta shpreh realitetin objektiv, atëherë përse nevojitet kritika, përse parashtrahet pyetja epokale, A kanë vlerë estetike veprat letrare, kur dihet që vepra letrare shkruhet përmes gjuhës, e gjuha gënjen. Zgjidhja e një

problemi të tillë ndodhen në ridizajnimin e teorisë së semiologjisë dhe strukturalizmit përmes funksionalizimit të teorisë triadike të Persit, duke i përjashtuar pozicionet binare të semiologjisë dhe dekonstrukcionin që nuk është teori, por një metodë për të kritikuar teorinë. Në këtë kontekst, zgjidhja e kërkuar kalon përmes semiotikës si urë lidhëse midis teorisë dhe kritikës letrare, sipas konceptit triadik të Persit: shenja, objekti dhe interpretanti, ku interpretanti është shenjë subjektive që interpretohet nga interpretuesi. Janë variante teorike këto, të vlefshme për krijimin e sistemeve teorike, në kontekst edhe në krijimin e sistemit teorik të Sabri Hamitit. Në përcaktimin për Bioletrën, Sabri Hamiti shprehet se Bioletra si teori, shkrimin e leximin letrar i trajton si procese të ndërliqshme e të lidhura njerëzore që kanë burim individin dhe botën e tij e jo rrethanat sociale e ideologjike të kolektivitetit. Kjo është kërkesë që letërsia t'i kthehet natyrës së vet të vërtetë, krijimit të vlerave shpirtërore dhe shijimit e njohjes së këtyre vlerave. Bioletra është një ftësë për t'u kthyer në fillim, në pafajësi, në zbulim të vetvetes e të botës, pa njohur asfarë konvence. Në këtë hapje të përgjithshme krijuesi e takon lexuesin e kohës së vet apo të kohëve të tjera për ta relativizuar kohën me përjetësinë e artit.

\*\*\*

Albanizma: Kanuni është një doku-

ment kulturor dhe historik në aspektin e së drejtës tradicionale të shqiptarëve. Siç dihet, deri në kohërat moderne, kemi trashëguar kanunin e lekëve ose Kanuni i Lek Dukagjinit që ishte zbatuar në viset mbilumin Drin dhe kanuni i gegëve ose Kanuni i Skënderbeut që ishte zbatuar në të gjithë pjesën tjetër veriore të Shqipërisë, kurse në Shqipërinë e jugut, kanuni (e drejta zakonore), funksiononte në formë fragmentare. Në fakt, modeli më i plotë i organizimit tradicional të jetës së shqiptarëve është Kanuni i Lek Dukagjinit, shënon studiuesi Shaban Sinani dhe e përcakton Kanunin përmes përkufizimit "botë e mbyllur". Një botë e mbyllur e përcaktuar përmes referencave: Barazia, Mikpritja, Nderi, Besa ose fjala e dhënë. Pra, Kanuni, kjo botë e mbyllur, me në thelb fjalën (fjalën e dhënë), që në përkufizimet metodologjike të semiologjisë, i nënshtrohet procesit të semiozës. "Besa, ose kulti i fjalës së dhënë, lidhet në burim me mitin biblik të fjalës: "Në fillim qe fjala!". Më parë se të ishte shkrimi, kontrata, marrëveshja, noteria, gjyqi, shteti, popujt, njeriu, bota vetë, ishte fjala. Ky kult madhështor, i cili në popujt euro-perëndimorë, pak nga pak mori karakterin e një idiome fetare kishtarë, te shqiptarët ruajti gjurmën e burimit". Fjala e dhënë apo Besa, që nuk ka barazi kuptimore me asnjë fjalë a frazeologjizëm të ndonjë gjuhe tjetër, është autentike, një

dukuri e botës shqiptare, e shprehur përmes koncepteve metateorike të akademik Sabri Hamitit, si Albanizma. "Shenjat kombëtare: himni e heroi, imazhet historike, figurat e veçanta dhe zhargonet e autenticitetit, janë shenjat e para të këtyre shkrimeve, që krijojnë koncepte të veçanta shqiptare, të quajtura Albanizma. Një jetë autentike, e përkthyer në letërsi autentike". (Hamiti, 2010: 375) Në aspektin e teorisë të funksionalizuar në qindvjetshin e kaluar, Sabri Hamiti krijoi teorinë e vet origjinale për një poetikë të historisë letrare shqipe e sintetizuar në tre kapituj Bioletra – Tematologjia dhe Albanizma. Në fakt, çështje Albanizma? Albanizma ka të bëjë me një nocion që përfshin identitete kulturore dhe letrare shqipe, domethënë karakteristika të përsëritshme dhe të përsëritura të kësaj kulture dhe të kësaj letërsie, të cilat duken në shoqëri dhe reflektohen në letërsi. Këto janë albanizmat. Për shembull duke iu referuar Kanunit, Albanizma është tema e Besës e përkthyer në letërsi. Është novela me një poetikë intertekstuale e Ismail Kadaresë, Kush e solli Doruntinën? Është drama Besa e Sami Frashërit, është drama Nita e Josip Relës e shembujt tjerë. Paratekstualiteti i veprave të cituara, është Kanuni, konkretisht Albanizma Besa – fjala e dhënë. Procesi i semiozës në letërsinë shqipe, është në funksion. Për hir të kriterëve metodologjike, do të përcaktojmë

poetikën intertekstuale të novelës Kush e solli Doruntinën? Në kontekst, G. Genette është interesant, me dispozitat e tij teorike mbi palimpsestin. Sipas tij, "Tema e poetikës nuk është teksti i përcaktuar në veçantinë e tij (që është shumë më tepër vepër e kritikës), por arkitekti, d.m.th., arkitektualiteti i tekstit (që zakonisht quhet "literaritet"), d.m.th. një grup kategorish të përgjithshme ose llojesh transcendent të ligjërit, mënyrave e të të shprehurit, e gjinive letrare etj., të cilave u referohet çdo tekst individual. Sot, do të thosha, në një kuptim më të gjerë, subjekti i poetikës është transtekstualiteti ose transcendenca tekstuale e tekstit, të cilin më pas e përkufizova "si gjithçka që e vë tekstin në raport, të dukshëm apo të fshehur, me tekstet e tjera". (**Parateksti:** Balada për vëllain e vdekur, një motiv i njohur që ka të bëjë me rastin e martesës së motrës pas shtatë muajve. Në Shqipëri kjo legjendë gjendet me emrin Halil Garia ose kënga e Dhoqinës. Pas një fatkeqësie, që

ngjet në shtëpi, i vëllai duke dëgjuar zërin e nënës që i kërkon premtimin se do t'i sjellë vajzën kur të jetë nevojë, ngrihet nga varri dhe shkon e ia sjell. Në këtë legjendë tregohet edhe se sa e lartë është fjala e dhënë. **Interteksti:** Në fillim të novelës, njëri nga personazhet, kapiten Stresi, me të dëgjuar ndodhinë e misterhme, menjëherë fillon të gjurmojë se kush në të vërtetë e ka sjell Doruntinën në shtëpi. Në fakt kapiten Stresi, bashkë me ndihmësin e tij mendonin që Doruntinën e ka sjell ndonjë mashtrues. Pas shumë kërkimeve dhe interpretimeve të gjurmëve, kapiten Stresi kupton që Doruntinën e ka sjellë vëllai i saj, Konstatini). Pra, G. Genette përpiket të riformulojë intertekstualitetin në aspektin poetik, dhe konsideron se objekti i poetikës nuk është teksti i eksploruar në veçantinë e tij, por transtekstualiteti ose tërësia e marrëdhënieve ndërvepruese që teksti vendos me tekstet e tjera. Pra, është poetika ajo që hap tekstin, mes teksteve të tjera të lidhura, në kontekst me paratekstualitetin e besës

së kanunit e të folklorit. Intertekstualiteti nuk është një fenomen letrar që nuk e mbyll tekstin, por e hap tekstin në raport me tekstet e tjera, në raport me kulturën, në raport me kontekstin, sepse autori është fillimisht lexuesi i teksteve të tjera, e më pas autori që krijon veprën gjuhësore të artit, të lidhur ndërtekstualisht me ndikime dhe vlera të ndryshme referimi. Ajo që intrigon novelën është përcaktimi i poetikës intertekstuale, sepse vepra të tilla që ngritën mbi një tekst folkloristik Konstatini dhe Doruntina e variante të tjera, i shënuar si paratekst, përmes fenomenit të intertekstualitetit, është letrarizuar novela Konstatini dhe Doruntina e Ismail Kadaresë, legjenda mbi vëllain e motrën dhe besën e dhënë. Në fakt, novela është letërsi që ngritët mbi një paratekst, mbi një tekst folkloristik. Një paradigmë e tillë teorike, e krijuar përmes poetikës intertekstuale, në vazhdimësi kërkon një lexues intertekstual, e Ismail Kadare nuk është vetëm shkrimtar, por edhe një lexues

i pashoq intertekstual. Në funksion është fakti që fenomenet psiko – historike, siç për shembull është edhe fjala besa, fjala e dhënë, nyje botëkuptimore si albanizëm, e shohim së pari si fenomen jetësor – kontekstual, së dyti si fenomen letrarë dhe së treti si esencë e thurur në veprën letrare, me funksionin e ripërtëritjes së fenomenit.

\*\*\*

Albanizma është cilësuar nga kritika si një vepër që shpreh vullnetin dhe dëshirën që më në fund shqiptarët, pasi kanë përmbushje detyrat historike, të flasin për vetveten. A do të vijë koha, thotë Eqrem Çabej, që letërsia shqipe të mos kenë detyra historike dhe politike, por të bëhet literaturë për vetveten. A do të bëhet letërsia shqipe, letërsi e vlerave estetikë, jashtë kritereve ideologjike dhe politike, siç kërkoi Dr. Ibrahim Rugova "me një refuzim estetik dhe me një prani të theksuar të ontologjisë së veprës letrare".

*Poezi: Ali Musaj*

## I SHTRIRË NË HAPËSIRË

*Hijes së dajës tim, Bajram Currit*

E dëboi dhimbjen  
gjembat i ndrydhi me duar  
i thau lotët  
sytë s'i mbështolli me leckë  
e piu gjakun e pëllumbit  
e krojet e shterura pështyu  
u betua në këmbët e thyera-  
i shtrirë në hapësirë!  
Marshoi drejt dritës –  
ai që nuk vdiq i tërë  
ai që lindi sërish  
me lindjet e përmortshme  
ai petrit i zjarrtë në zjarr  
-trup shkëmbi  
me shpirt furtunë!  
Ai- e dëboi dhimbjen  
gjembat i ndrydhi me duar  
i thau lotët  
sytë s'i mbështolli me leckë  
dhe – mbërrin tek ne  
i madhërisëm  
me atë gjoks stolisur-  
ngadhënjim;  
me atë kokë mbi supe –  
ngritur flamur!  
Vetëm Ai –  
përherë kudo sinorëve  
i shtrirë krenar në hapësirë!

(Gjakovë, 1980)

## BUZË VARRIT

Seç më plasi zemra  
si kripa në zjarr  
Seç m'u këputën damarët  
si litari i palaços  
Seç m'u ndërkryen ëndrrat  
si trutë e dërrit të egër  
Seç më plandosën flakët  
si kërpudhën shirat pikërenë  
Seç u gëzuan hienat  
si nimfat kur puthen me diellin  
Seç më la kënga vetmitar  
si cung mes pyllit të prerë  
Seç m'u shter lumi i shpresës  
si lotët e mallit për tokën e shkriftë  
E – asgjë s'më mbetet për dashurinë  
asnjë ashkël ngazëllimi  
asnjë trohë shendi  
asnjë shëndetje dore  
asgjë veç frymimit  
e një klithje namëmadhe  
rreth kërthizës së kotësisë  
buzë Varrit tim...!

(Gjakovë, 12. IX. 1995)

## NË EMËR TË PREHJES

Të flakësh lotin nga syri  
njësoj është si të vrasësh vdekjen  
me vdekje barku  
në emër të jetës  
në emër të prehjes  
të të gjitha rrugëve të gjakut  
të të gjallëve dhe të të vdekurve në ne,  
të flakësh lotin nga syri  
mjafton që deri te lumturia  
vetëm me lumturi  
i lumtur të jesh sa ora  
dhe pastaj të vdesësh  
i gjallë në emër të vdekjes  
në emër të skeletit të gjallimit tonë  
në ne dhe –  
në degët  
e të gjitha zbrazëtimeve tona...

(1972)

## SINQERISHT POHOJ

Pas vdekjes sime të qetë  
s'kërkoj pavdekësi  
Mbi varrin tim  
s'dua kurora dafinash  
dua vetëm kujtim zemre  
të shokëve të mi bonjakë  
të syve të trëndafiltë  
që në jete më soditën urtësisht  
dhe më dhanë durim  
dhe më falën dritë  
për jetën time bubullimë  
të thërrmuar në furtuna  
ndër currat e fëmijërisë  
dhe – sërish të sajuar  
në motet e ardhmërisë  
që do t'ju takojnë  
pinjovje tanë syshqiponja  
si shigjetat në shënjestër  
termales së Jetës –  
me gjokse graniti  
me duar çeliku  
dhe hapa si troku i atit zemërshkëmb...!  
Andaj –përherë do ta puth dorën time  
për vargun e lënë peng  
dhe këngën  
që do të përsëdytet ndër brezni!

## RRUGA IME

Ja krisi shiu sërishmi  
lag e çull çdo gjë  
djeg e freskon shpresa  
e unë s'di assesi esëll  
si të përmytem mallshëm  
shtjellave krahrrembyese  
rrugëtimi im s'ka shenjë  
as emër cirku  
as mbishkrim varri  
-vetëm me shiun çlodhet  
e hapësira pëlçet  
zëshëm me buçimë  
çuditshëm si rrufeja  
o rruga ime e pa skaj...!

## PROKLAMATË

I paudhi është i natës  
I verbër i errësirës  
Rrugëtimet e tij parashihen  
Tek ndeshet me bijtë e Dritës  
Sheshazi e shkoqurazi  
Barbaritet me Djallin  
Shkallësisht panda lehet  
Rrethe përqark Njëmendësisë  
E në te mbjell egër  
E djeg e prish grunaja  
Shqelmin shëlbimin në jetë  
S'lejon njeri të pjesojë riskun e vet  
Është horr i stërfëlliqur  
I ndërkryer e i pafytyrë  
Vetëm ditëlumja e sqotës  
Qafet do na heqë  
Të ta puthim shlirshëm  
Agimin e fatit tonë të bardhë  
E këngës sonë gëzimplotë  
Shteg të ri t'i çelim  
Të të përqafojmë të plotë  
Nënëlokja jonë –KOSOVË...!

(12 tetor, 1995)

## GJYMTIM

Mundem edhe pa sy  
mundem edhe pa duar  
mundem edhe pa këmbë –  
të përhidhem në vallen e jetës  
mes jush o njerëz të mirë si toka,  
por kurrsesi s'do të mundem  
as t'ju flas  
i ngarkuar me barrët e rënda  
të përgojimeve qyqare –  
smirëzeza e tinëzare  
mbi kurrizin tim garravaç  
që s'rëndon mbi supet tuaja!  
s'mundem jo –  
vetëm për hir të gjymtimit tim –  
që flet me gjuhën e vet  
dhe kurrë Bukurinë s'e vret –  
mbi kokat tuaja njerëz të mirë si varri...!

(Sokograd, korrik 1978)

Bob Dylan

## ERË IDIOTIKE



Dikush më ka halë në sy, dhe po sa-  
jojnë historira të paqena kundër  
meje në shtyp  
Kushdo që është dëshiroj që ta ndër-  
pres këtë vaki, ama kur do ta bëjnë  
këtë nuk mund ta di  
Thonë se e kam vvarë një njeri të  
quajtur Gray dhe ia mora gruan me  
vete në Itali  
Ajo trashëgoi një milion dollarë dhe  
kur ajo vdiq, paratë më takuan mua  
S'kam ç'të bëj, nëse jam me fat

Njerëzit më shohin gjithë kohën dhe  
thjesht nuk u kujtohet se si duhet të  
sillen  
Mendjet i kanë plot me ide të mëdha,  
imazhe dhe fakte të shtrembëruara  
Bile edhe ti, dje u desh të më pyesësh  
se ku kishte ndodhur  
Nuk mund të besoja se pas gjithë  
këtyre viteve, ti nuk më paske njohur  
aspak  
Zonjë e ëmbël

Erë idiotike, që shkulmon sa herë që  
ti çel gojën  
Që fryn rrugëve anësore në drejtim  
të jugut  
Erë idiotike, që shkulmon sa herë që  
ti cakëllon dhëmbët  
Ti je idiote, vashë  
Është çudë që ti ende di si të marrësh  
frymë

Rastisa një fallxheshë, e cili tha ruhu

nga rrufeja që mund të të godas  
Nuk kam njohur paqe dhe qetësi për  
një kohë të gjatë, sa që nuk i mbaj  
mend më  
Ja një ushtar vetmitar në kryq, tymi  
rrjedh nga dera e vagonit  
Ti nuk e ke ditur, ti nuk mendoje se  
kjo mund të bëhej, në fund të fundit  
ai i fitoi luftërat  
Pasi që kishte humbur çdo betejë

U zgjova buzë rruge, duke fantazuar  
në lidhje me atë se si janë gjërat  
ngandonjëherë  
Vizionet e pelës sate ngjyrë gështen-  
je ma përshkojnë mendjen dhe më  
detyrojnë t'i shoh yjet  
Ti i lëndon ata që unë i dua më së  
shumti dhe e mbulon të vërtetën me  
gënjeshtër  
Një ditë do të mbarosh në hendek,  
mizat do të fluturojnë rreth syve  
Gjak në shalën tënde

Erë idiotike që shkulmon mes luleve  
në varrin tënd

Që shkulmon mes perdeve në  
dhomën tënde

Erë idiotike që shkulmon sa herë që  
ti cakëllon dhëmbët  
Ti je idiote, vashë  
Është çudë që ti ende di se si të mar-  
rësh frymë

Ishte graviteti që na tërhoqi në  
humnerë, ndërsa fati na ndau  
Ti e zbutë luanin në kafaz-  
in tim, ama kjo thjesht nuk qe e  
mjaftueshme për t'ma ndryshuar  
zemrën

Tash gjithçka është pak si mbrap-  
shtë, bile edhe rrotat janë ndalur  
Ajo që është e mirë është e keqe, ajo  
që është e keqe është e mirë, këtë do  
ta kuptosh kur të mbërrish në majë  
Tash je në fund

E vërejtja në ceremoni, sjelljet tua  
të degjeneruara përfundimisht të  
kishin bërë të verbër  
Fytyrën tënde nuk e kujtoj më, goja  
jote ka ndryshuar, sytë e tu nuk shi-  
kojnë më në sytë e mi  
Prifti ishte veshur me të zeza në  
ditën e shtatë dhe rrinte ulur çehren-  
grirë derisa ndërtesa digjej  
Të kam pritur në shkallare, ndanë  
selvive, derisa pranvera ngadalë u  
shndërrua në vjeshtë

Erë idiotike që fryn në qark rreth kaf-  
kës sime  
Nga Great Coulee Dam deri në Kapi-  
tol  
Erë idiotike që shkulmon çdo herë që  
ti cakëllon dhëmbët  
Ti je idiote, vashë  
Është çudë që ti ende di se si të mar-  
rësh frymë

Nuk mund të të ndiej më, bile as li-  
brat qëi ke lexuar nuk i prek me dorë  
Sa herë që zvarritem pranë derës  
tënde, dëshiroj të isha dikush tjetër  
Teposhtë autostradës, teposhtë hek-  
urudhës, teposhtë rrugës për në ek-  
stazë  
Të kam ndjekur nën yje, i përndjekur  
nga kujtimi për ty  
Dhe tërë lavdia jote e tërbuar

Më kanë tradhëtuar për herë të fun-  
dit dhe tash më në fund jam i lirë  
I dhashë puthje lamtumire bishës  
ulëritëse në vijën kufitare që të ndau  
ty nga unë  
Ti kurrë nuk do ta dish ç'vuajtje kam  
përjetuar e as dhimbjen mbi të cilën  
jam ngritur  
Dhe as unë kurrë s'do ta di të njëjtën  
gjë për ty, shenjtërinë tënde apo llo-  
jin tënd të dashurisë  
Dhe kjo më bën të ndihem shumë  
keq

Erë idiotike, që shkulmon tejpertej  
pullave të palltove tona  
Që fryn mepërmes letrave që i kemi  
shkruar  
Erë idiotike, që fryn nëpër pluhur në  
raftet tona  
Ne jemi idotë, loçkë  
Është çudë bile që ende mund të ush-  
qejmë veten

Përktheu: Fadil Bajraj

# DIÇKA SHUMË E RËNDË KA PËR TË NDODHUR

**Gabriel Garsia MARKEZ**

Imagjinoni një fshat shumë të vogël në të cilin jeton edhe një zonjë e moshuar me dy fëmijë: një djalë 17 vjeç dhe një vajzë 14 vjeçe. Nëna është duke u shtruar drekën bijëve të vet, por në fytyrë ka njëfarë shqetësimi. Fëmijët e pyetën se çfarë i kishte ndodhur dhe ajo u përgjigj:

– Nuk e di, por sot jam zgjuar me parandjenjen se diçka shumë e rëndë ka për të ndodhur në këtë fshat.

Ata qeshën me ato që tha nëna e tyre. Sipas tyre këto qenqeshin parandjenja pleqsh, gjëra që diheshin. Djali shkoi të luante bilardo dhe në çastin që do të godiste një gur, ishte një karambol fare i thjeshtë, lojtari tjetër i thotë:

– Unë vë bast një peso që ti nuk ke për ta goditur dot.

Të gjithë qeshën. Qeshi edhe i biri i gruas së moshuar. E goditi gurin dhe nuk e bëri dot karambolin. Ndërkohë që i jep peson kundërshtarit, të tjerët e pyesin se ç'paskësh ndodhur me të që nuk arriti ta bënte dot atë karambol aq të lehtë. Dhe ai përgjigjet:

– Keni të drejtë, por më ka ngelur mendja te një gjë që më tha sot në mëngjes ime më: se diçka e rëndë do të ndodhë në fshat.


Të gjithë qeshën me të. Ai që fitoi peson u kthye në shtëpinë e tij ku gjeti të ëmën e vet me mbesën e saj ose me një të afërt tjetër dhe duke treguar peson i lumtur thotë:

– I fitova një peso Damastos, dhe ia fitova aq lehtë ngaqë është budalla.

– E pse qenka budalla?

– Hëm, dëgjo këtu, ai nuk mundi të bëjë dot një karambol fare të thjeshtë. Ishte i shqetësuar sepse e ëma na qenqesh ngritur sot me idenë se në fshatin tonë dashka të ndodhë diçka shumë e rëndë. Atëherë e ëma i thotë këtij:

– Mos u tall me parandjenjat e pleqve sepse nganjëherë dalin të vërteta. Mbesa e saj e dëgjo dhe u ngrit e shkoi te kasapi për të blerë mish. Ajo



i thotë kasapit:

– Më bëj një kile mish, – dhe, papritur, ndërsa ai priste mishin, shton: – E di ç'ke, më mirë bëj dy kile, sepse thonë, lart e poshtë, se paska për të ndodhur diçka shumë e rëndë në fshatin tonë, kështu që është më mirë të jemi të përgatitur.

Kasapi i jep mishin asaj dhe kur vjen një zonjë tjetër për të blerë një kile mish, i thotë:

– Më mirë merr dy kile se njerëzit më thonë që do të ndodhë diçka shumë e rëndë, prandaj po përgatiten duke blerë gjëra. Atëherë plaka i thotë:

– Po është ashtu, më bëj katër kile, se unë kam shumë gojë për të ushqyer. Dhe merr katër kile. Për të mos e

bërë tërkuzë tregimin, po ju them se kasapi për një gjysmë ore e mbaroi mishin dhe shkon e ther një lopë tjetër, e shet edhe atë të gjithën, ndërkohë që vazhdon ta përhapë lajmin. Dhe vjen një moment, kur të gjithë njerëzit në fshat po prisnin të ndodhte me të vërtetë diçka. U paralizua gjithë veprimtaria e zakonshme dhe aty nga ora dy pasdite, si gjithmonë, shtrëngoi vapa. Dikush tha:

– E vini re se ç'vapë po bën sot?

– Po në këtë vend gjithnjë bën vapë!

(Aq vapë bënte në atë fshat sa muzikantët që i kishin instrumentet të arnuara me mballoma, gjithnjë u binin në hije, se, po të luanin në diell me to, do t'u binin copat sheshit.)

– Por ora dy pasdite është koha kur vapa arrin kulmin.

– E vërtetë është ajo që thua zotrote, por kurrë nuk ka bërë si sot.

Në këtë fshat të shkretë, mu në mes të sheshit të shkretë, ulet një zog dhe lëshon një zë.

– Shikoni, është një zog mu në qendër të fshatit.

Dhe të gjithë, të habitur, shikojnë zogun.

– Zotërinj, po ka bërë vaki shumë herë që ulen zogj në sheshin e fshatit.

– Po, po, vërtet, por jo në këtë orë.

Dhe, që thua ti, vjen një çast tensioni të tillë për banorët e fshatit, sa të gjithë i mbyten dëshpërimi dhe të gjithë duan të ikin, por nuk e marrin guximin ta bëjnë.

– Unë do bëhem burrë! – bërtiti njëri.

– Unë po iki.

Merr gjërat e tij, fëmijët e tij, ato pak bagëti që kishte, i fut në një karrocë dhe përshkon rrugën qendrore ku është mbledhur i tërë fshati i mjerë e po e shikon. Dhe në atë moment njerëzit thonë:

– I lumtë që mori guximin, o burra, hajde të ikim edhe ne.

Dhe fshati u bë rrëmujë; të gjithë po përfillëshin për t'ia mbathur. Po merrnin gjërat, kafshët, gjithçka.

Dhe njëri nga ata të fundit që braktisën fshatin thotë:

– Nuk dua që fatkeqësia të futet shtëpinë time, – dhe i vë flakën shtëpisë së tij.

E të gjithë bënë si ai. U vunë flakën shtëpive të tyre. Dhe ia mbathën me një panik të tmerrshëm e të vërtetë, thua se ishte një ikje nga lufta.

Midis të ikurve ishte edhe zonja e moshuar që kishte dhënë lajmin ogurzi. Atëherë ajo klithi e tha:

– Çudi, kur unë thashë se diçka shumë e rëndë ka për të ndodhur, të gjithë më thanë se qenqesha e çmendur.

(Përktheu nga origjinali Bajram Karabollit)

## Mite

# RRËMBIMI I PERSEFONIT

**Miti i Persefonit simbolizon ardhjen e pranverës që përkon me ardhjen e saj në tokë, ndërsa rikthimi në Had pas gjashtë muajsh, përkon me ardhjen e vjeshtës**

**Gavrosh HAXHIHYSENI**


Njerëzimi ka lënë pas një kohë të artë plot mite e legjenda pagane, ku toka, qielli, bimësia, etj, lidheshin ngushtësisht me perënditë, të cilat drejtonin çdo gjë mbi tokë. Po kush ishte Persefoni (lat. Prozerpina) e mitologjisë greko-romake? Më poshtë po japim variantin e latinizuar të mitit. Në fillim të kohëve, perëndesha Demetra (Çerere), merrej pa u lodhur me mbjelljen e bimëve dhe

bënte që pemët të lulëzonin e të jepnin fruta. Ndërsa Ajo punonte, vajza e saj, Persefoni, luante në pyjet e Sicilisë, dhe në darkë ktheheshin në shtëpi duke kënduar e kërcyer së bashku... Një ditë, Plutoni, perëndia e ferrit, i lodhur nga terri i mbretërisë së tij, vendosi të dalë në dritë e të shikojë pak nga kjo botë... Pas një shëtitje të gjatë e të lodhshme u shtri me në fund mbi një lëndinë të bukur që ndodhej rrëzë malit Ena, në Sicili. Aty pranë shtrihej Perguza, liqeni

kaltërosh, që ushqehet nga përrënjtë gurgullues, zburuar me lule lloj-llojesh, aromat e përziera të të cilave të jepnin ndjesi erëmirë e aq të forta sa të dehnin... Menjëherë, sa ktheu vështrimin, dalloj në një lëndinë një grup vajzash që po mbledhnin lule duke qeshur e lodruar, dhe midis tyre Persefonin e bukur. U dashurua përnjëherë me të, por duke e ditur se Demetra nuk do të pranonte t'ia jepte vajzën për grua, vendosi ta rrëmbejë me dhunë, pasi mori

dhe pëlqimin e Jupiterit. Të dy u ngjiten mbi karron e tij të zeze dhe revan mbërritën në lumin Akeront, që ndan botën e të gjallëve nga bota e të vdekurve. Persefoni thërriste e qante aq fort sa dhe vetë lumit i erdhi keq për të, ndaj ai e mbërtheu Plutonin nga këmbët dhe tentoi ta hedhi në ujë. E dëshpëruar Persefoni hoqi nga vetja kordonin me lule dhe e hodhi në lumë, me qëllim që t'ia dërgonte si mesazh nënës. Plutoni dhe Persefoni mbërritën në mbretërinë e të

të vdekurve, e ndërsa Plutoni mundohet ta qetësonte duke i premtuar se do ta bënte mbretëreshë, në tokë ra muzgu. Demetra e kërkoi më kot duke i rënë e dëshpëruar botës përqark, dhe nga dhimbja e dëshpërimit e la bimësinë të thahet dhe hoqi dorë nga mbjellja e tyre, kështu që gruri dhe frutat nuk u rritën më. Nëntë ditë e nëntë net pa vënë gjumë në sy e pa ngrënë, Demetra u ul e lodhur në bregun e një lumi, dhe në atë çast pa aty pranë një kordon me lule. Më pas Heliosi, perëndia Diell, i rrëfeu të vërtetën si kishin rrjedhur ngjarjet. Nga dhimbja, Demetra nuk u kujdes më për tokën dhe i ktheu fushat pjellore në djerrina. Jupiteri kur pa se uria po shfaroste popuj të tërë, dërgoi lajmësit e tij ta qetësonin Demetrën e zemëruar, e cila, pa lëvizur nga vendi, iu përgjigj atyre se do të kujdesej për tokën vetëm kur Persefoni të kthehej sërish tek ajo. Jupiteri vendosi të dërgojë menjëherë Mërkurin që të takonte Persefonin e ta këshillonte që të mos prekte ushqim me dorë. Plutoni në fakt kishte përgatitur një drekë të shijshme, nepsndjellëse edhe pse




Persefoni nuk kishte aspak dëshirë e uri të hante. Më në fund, me këmbënguljen e Plutonit dhe nga uria ajo u dorëzua para shegës së kuqe e plot lëng të ëmbël që perëndia e të vdekurve ia kishte vënë në dorë me marifet. Plutoni i dha dymbëdhjetë kokrra shege dhe kur mbërriti Mërkuri, Prozerpina, për fat të keq, kishte ngrënë gjashtë prej tyre. Vajza shpërtheu në lot kur mësoi ligjin hyjnor sipas të cilit, ai që ha qoftë dhe një kokërr nga shega në mbretërinë e të vdekurve nuk mund të rikthehet më në tokë. Jupiterit i erdhi keq dhe vendosi që Persefoni, e cila kishte ngrënë vetëm gjashtë kokrra shege, do të jetonte gjashtë muajt e vitit në mbretërinë e të vdekurve me Plutonin dhe gjashtë muajt e tjera në tokë me nënën e saj Demetrën. Miti i Persefonit simbolizon ardhjen e pranverës që përkon me ardhjen e saj në tokë, ndërsa rikthimi në Had pas gjashtë muajsh, përkon me ardhjen e vjeshtës. Për fat ne e takojmë Persefonin vit pas viti bashkë me pranverën. I madhi Bernini e skaliti mjeshtërisht këtë mit në mermer.

## Profile

# GAUGUIN, NGA MOSKUPTIMI NË ARTIN E VËRTETË

**Gauguin e kishte vendosur: do të ikte, larg, sa më larg... nëpër ishujt dhe kolonitë, ndoshta në Madagaskar, mbase në Saint Domingue apo Martinique... diku në Polynesie... larg, veç të ikte**



### Luan RAMA


Atelieri i dikurshëm i Paul Gauguin në "Rue Vercingetorix" pranë Montparnasse, është dy hapa nga shtëpia ime, pasi ndërpritet me "Alfred Durand-Clay" ku banoj. Ishte befusuese për mua që këtë piktor e adhuroja që në mesin e viteve '70... ai më kishte zbuluar hapësira të panjohura nga bota... madje akoma më shumë nga ai planet ku jetonim ne! Një ditë shkova të shikoja se ç'bëhej

me atë vend ku Gauguin punoi dhe jetoi gjatë dy vjetëve, para ikjes së tij përfundimtare drejt Polinezisë, drejt ishujve Marquise... Bashkëkohësit e tij e kujtonin shpesh atë atelier... Vështroja atë ndërtesë dhe imagjinova kohën e ngjizur në të, përfytyroja atë piktor të dëshpëruar në kërkim të horizonteve të reja, edhe pse në zemër të Parisit. Ishte fundi i viteve 1880..... Paul Gauguin dhe Van Gogh e kishin lenë Parisin dhe kishin zbritur drejt Arles dhe Saint Remy për

të kërkuar imazhe të reja, diçka të re e moderne, larg akademizmit të pëlqyer në sallonet parisiane të artit. Ata ishin të ngjashëm me poetin e tyre bashkëkohës Arthur Rimbaud, i cili ngaqë e kuptoi se poezia e tij nuk ishte e mirëpritur në rrethet poetike të kohës së "Parnasienëve" dhe nuk kuptohej, i bindur për vlerat e veçanta që kishte poezia e tij, ai i ktheu krahët Parisit letrar për të gjetur horizonte të reja, ashtu siç e shkruante dhe në poezinë e tij: "Po e lë Europën.

Ajri detar do m'i përcëllojë mushkëritë. Klimat e largëta do më kalisin..." Po, kështu shkonin gjenitë kur nuk e gjenin veten e tyre dhe vlerësimin për artistin. Edhe ikja e piktorëve Gauguin dhe Van Gogh drejt jugut të Francës ishte si shkas i moskuptimit, pasi piktorët nuk e gjenin vetveten në mjediset e artit. Shkas u bë edhe zënka me mikun e tij të afërt Van Gogh, pasi Van Gogh donte që ai të rrinte me të dhe se ikja e tij do ta trishtonte shumë. Ata flinin në të





njëtin apartament edhe pse krijim-taria e tyre ishte e ndryshme nga njëri-tjetri. Një natë, Gauguin kishte hapur sytë në gjumë dhe sipër tij kishte parë fytyrën e çoroditur të mi-kut të tij.

– Çfarë ke Van Gogh! – i kishte thënë ai.

Por Van Gogh ishte larguar pa folur drejt shtratit të tij.

Një ditë tjetër, Van Gogh i kishte hedhur gotën e pijes së absintin në fytyrë e një herë tjetër, ato ditë kur Gauguin më së fundi po bëhej gati të largohej, në rrugë ai ndjeu hapa që nxitonin pas tij dhe i njohu që ishin hapat e mikut të tij. Ktheu kokën dhe pa Van Gogh-un me një brisk në dorë... Por Van Gogh-u kishte shkuar më tutje pa thënë asgjë... Po atë ditë, kur Gauguin i ishte afruar apartamentit të tyre, ai pa policët aty pranë dhe kur u ngjiti pa Van Gogh-un e fashuar që rrinte në trisht me kokën e fashuar. Kishte prerë veshin. Një gjymtim që donte të bënte nga dhimbja për ikjen e shokut të tij, siç do ta shohim dhe më pas në një autopotret të tij. Menjëherë Theo, vël-lai i Van Gogh, erdhi të kujdesej për të vëllain dhe disa ditë më vonë, pasi e lanë piktorin e sëmurë në spitalin e Arles për tu qetësuar psiqikisht, ata u larguan drejt Parisit. Gauguin e kishte vendosur: do të ikte, larg, sa më larg... nëpër ishujt dhe kolonitë, ndoshta në Madagaskar, mbase në Saint Domingue apo Martinique... diku në Polynesie... larg, veç të ikte. Rrethi i piktorëve nuk e konsideronte fare dhe atë e mbanin për një piktor të vogël. Po kështu dhe gru-aja me fëmijët e tij ishin larg në Kopenhagë... Gauguin ishte një lloj bohemi. Dhe kështu, i përbuzur, me anijen më të parë që shkonte drejt Polinezisë, ai u nis i ngarkuar me telajo dhe kanavacë për krijimet e tij të ardhme. Hipur në anijen "Australien" ai më së fundi u nis. Tre muaj më pas Gauguin dalloj brigjet e Tahitit ku do të fillonte një aventurë e re pikturale: ajo e diellit dhe ngjyrës ekarlate, e fortë, spikatëse, si e dalë nga një llavë vullkani të harruar në ato mle-që i ngjiteshin qiellit thikë, rrethuar nga një gjelbërim i pafund... dhe

deti, deti, e kaltra dhe ngjyra metise, okër-kafe e atyre indigjenëve të mirë e të paqtë, e banorëve të atyre ishujve që deri atëherë nuk e kishin gjetur veten në pikturën e metropolit francez, në penelat e një Monet, Degas, Van Gogh, Renoir... Dhe Gauguin kishte besim se një piktorë tjetër do të prezantonte atë me dinjitet në sallonet parisiane. Dhe kështu, shumë shpejt, peizazhet dhe figurat e tahitianëve do të krijoheshin në telajot e tij, do të shfaqeshin vetvetiu me buzët e tyre të trasha dhe vështrimin e paqtë, të sinqertë, me gjinj-të e xhveshur dhe zemrën e hapur, ku mund të hyje pa trokitur. Papete ishte atëherë me 3000 banorë. Gjete një shtëpi të vogël druri, një verandë dhe filloi të mësojë gjuhën, folklorin, madje u vendos larg qendrës së banuar. Ai donte të ishte larg qytet-ërimit perëndimor që kishte mbërritur ndërkohë deri aty... por ai donte sa më afër qytetërimit vendas... Në fillim në Parca, pastaj në Tetuani, ku ritet fetare indigjene ishin të gërshtuara me katolicizmin, prandaj dhe Jezuja që krijoi ai ishte ndryshe nga ajo që bënin piktorët perëndimorë. "Je vous salue Marie!", "Ju përshëndes Mari", dhe poshtë kësaj tabloje me këtë titull ai vendosi fjalët tahitiane "Ia orana".

Edhe pse i dëshpëruar dhe larg fëmijëve të tij, ishte piktura që e shpëtoi atë: "Gjithë ekzistenca ime ka qenë e tillë, – shkruante ai në një letër drejtuar miqve të tij në Paris. – Shkoj gjer në cep të greminës dhe nuk bie!" Dhe që të ketë një model, por dhe të ketë pranë seksin tjetër, ai merr një nga ato vajzat brune dhe shtatlarta që në gjuhën e vendit i quajnë "vahine". Dhe Teha'amana shkon të jetojë me të në kasollen e tij.

– Ti nuk ke frikë nga unë? – i kishte thënë ai, duke shkruar për takimin e tyre parë.

– Aita! (Jo!)

– A do të banosh në shtëpinë time?

– Aha! (Po!)

– Ke qenë ndonjëherë e sëmurë?

Vitet kalonin dhe tablotë e tij, edhe pse vuante e jetonte gjithnjë në mjerim, shtoheshin dhe tashmë shumë prej tyre i kishte nisur te galeristi i

tij në Paris. Tahiti ishte larg metropolit. Të tjerat mendoi t'i merrte me vete dhe mendoi të merrte rrugën e Francës për të bërë të njohur punët e reja të tij. Një ekspozitë ishte hapur ndërkohë në Kopenhagë, nën kujdesin e gruas së tij, Mette. Dhe ai nis: "Kur lashë skelën, pashë për herë të fundit Teha'amana-n që kishte disa netë rresht. E trishtë, por e qetë ajo qëndronte e ulur mbi gur, me këmbët e varura mbi ujin e kripur!..." Kthehej me katër franga në xhep. Tablotë ishin pasuria e vetme e tij. Më 30 gusht 1893 mbërriti në Marseille, nga ku i dërgon një letër gruas së tij. Por e zemëruar me të, ajo nuk i ktheu përgjigje. Po kthehej me besimin që kishte patur poeti Rimbaud që shkruante në librin e tij poetik Një stinë në ferr: "Do të kthehem me këmbë hekurt, – kishte shkruar ai, – dhe me syrin e furishëm, e sipas fytyrës do më gjykojnë si pinjollin e një race të fortë". Vallë, si do ta priste Parisi i letrarëve e artistëve? Që nga viti 1877 ai kurrë nuk kishte ekspozuar në Paris. Tashmë piktura e tij ishte një tjetër piktorë, tablo me një intensitet e ngjyrë të jashtëzakonshme, me personazhe e subjekte të një botë të largët që zbarkonin aty në zemër të Parisit... Mallarmé që i pa ato tablo me ato gra të fuqishme buzë detit e lumit, me shpatulla të mëdha dhe një sensualitet të fuqishëm, kishte shkruar: "Si mund të vendosësh kaq shumë mistere në një tablo dhe kaq shumë shkëlqim?!" Por kur Gauguin i kërkoi të shkruante diçka si parathënie të ekspozitës së tij, Mallarmé heshti... Ato kohë, Anne, një metise, "Anne javanaise" siç e quanin, erdhi të jetonte në atelierin e tij të habitshëm me ato xhama të lartë dhe shumë gjëra ekzotike që ai kishte sjellë nga Tahiti, ku dhe muret tashmë i kishte llyer me ngjyra të forta, veçanërisht të verdha. Në atelier mbante madje dhe një papagall. Aty i priste miqtë. Aty kishte shkuar një ditë dhe dramaturgu i madh August Strindberg, autori i dramës së famshme "Zonjusha Zhuli"... aty dhe miku arvanitas, poeti Jean Moréas, i cili e kishte deklaruar në një mbrëmje të

tij festive si simbolistin e pikturës franceze. Idetë e Moréasit dhe programi i tij për shkollën simboliste e kishin joshur piktorin, i cili i kishte bërë madje dhe një karikaturë të bukur dhe mjaft të gjetur. Ai i kërkoi Strindberg-ut t'i shkruante diçka për parathënien e ekspozitës së atyre ditëve, por Strindberg iu përgjigj: "Ju keni krijuar një tokë të re, një qiell të ri, por unë nuk e ndjej veten në mjedisin e krijimeve të tua...". Atëherë Gauguin e shkroi vetë parathënien duke botuar letrën e Strindberg dhe përgjigjen e tij, ku ndër të tjera, duke iu referuar figurës së pikturuar të Evës që ekspozonte, ai i shkruante: "Eva, sipas konceptit tuaj të qytetëruar ju bën, apo pothuaj na bën të gjithëve mizozhinë. Por Eva e lashtë në atelierin tim, e cila ju frikëson, mund tu buzëqeshë një ditë më me pak hidhësi... Eva që unë kam pikturuar mund të qëndrojë nudo para syve tanë..." Parisi, Franca, Europa, i dukej atij e ftohtë, mospërfillëse. Vallë nga njerëzit primitive që kishte pikturuar? Mikripritës ishte veçse Degas e ndonjë tjetër, që duke i blerë ndonjë tablo kërkonin ta ndihmonin që të mund të jetonte. I zhgënjyer nga ëndrrat se do të prezantonte në Paris një art të ri, Gauguin e gjeti veten të braktisur, të tepërt. Kohë e moskuptimit. Ç'vlerë kishin Eva-t e tij, ajo botë njerëzore e largët që mbartete thelbin e vet njerëzor me ngjyrat e ngrohta të tokës, diellit, ngjyra që ai i shikonte si një muzikë inkandeshente të gëzueshme e jetëdhënëse. Dhe përsëri ai nis drejt Tahitit. Përsëri brigje, ishuj, diell dhe ata njerëz pagan me ritet e tyre shekullore. Gjen një tjetër grua, të quajtur Vaeoho. Ajo ishte gruaja e shtratit dhe modelia e tij. Kohë më pas ai i shkruan miqve të tij në Paris se "së shpejti do të jem përsëri me fëmijë. Dreq o punë. Më duhet të mbjell farën ngado..." Ndryshe nga tri gratë e para të tij në Tahiti, që nuk i shohim aq në tablotë e tij, Vaeoho na shfaqet shpesh e gjerësisht, sensuale, si vetë dielli dhe bregdeti tahitian, femra e çlirët, pagane, ashtu siç ishte krijuar nga mëma e vet. E vetmja lidhje që e mbante me familjen larg në Kopenhagë ishte Aline, vajza e tij e madhe, e brishtë si një lule. Në krishtlindjen e vitit 1893 ai i kishte shkruar: "Tashmë je 16 vjeç, je rritur. Zonjushë, shko në ballo... A di mirë të kërcesh? A të kujtohet para tre vjetëve kur më thojë se do të ishte gruaja ime? Unë qesh tani me fjalët e tua dhe medimin naiv. Ah, fëmijët e mi të varfër, mos e qortoni atin tuaj që nuk u sjell para në shtëpi. Por një ditë ju do të mësoni se ai ishte ati më mirë në botë!..." Por jo shumë kohë më vonë, një lajm i tmerrshëm tronditi ekzistencën e tij. Aline, vajza që donte më shumë nga fëmijët dhe që i shkruante letra shpesh, kishte vdekur. "Sapo më ka vdekur vajza, – shkruante ato ditë ai. – Tani nuk e dua më Zotin. Ash-tu si dhe nëna ime, ajo quhej Aline. Çdo njëri do në mënyrën e vet: për disa, dashuria është e ekzaltuar në qivure, për të tjerë nuk e di... Ah, varri i saj atje... Lule! Por kjo është në dukje. Varri i saj është këtu, pranë meje: lotët e mi janë lule të gjalla!... Dhe Gauguin mbytet në dëshpërim. Mjerimi i tij i përditshëm është gjithnjë e më i madh. Pikturat shit-en rrallë. Një tablo e kish blerë ambasadori turk, arnauti Halil Bey, ai që kishte blerë te piktori Courbet Origjinën e Botës. Tabloja quhej Jeta

dhe vdekja. A ishte thua kështu për Gauguin? Më 1897 pas temës së tij të gjatë "Nevermore, o Taiti", ai pikturoi një figurë vajze, interesante, të shtrirë ashtu si një odaliskë e Edouard Manet, por me ngjyra të ndezura, e vetmuar... një vajzë e shtrirë, një jastëk i verdhë, pas saj dy figura grash që bisedojnë dhe një korb që përgjon... mos vallë "Korbi" i Edgar Poe-s që poeti Mallarmé ua lexoi një mbrëmje gjithë entuziazëm grupit të simbolistëve?... Po kështu një tjetër tablo: një vajzë e shtrirë si në një tablo, një Venus i Lucas Cranache (i Vjetri). Piktura ishte e vetmja gjë që e bënte të harronte dhimbjet e shpirtit dhe ato të trupit. Tabloja "Kur do të marthohesh? (Nafeaa fa ipoipo) mbetet një nga tablotë e përkryera e më të mira të tij, ku spikat shpirti polinezian, sensualiteti dhe ai primitivizëm i dashur i tij, për çka do ta admironin nga të parët piktorët Matisse dhe Picasso (ky i fundit u influencua së tepërmi në tablonë e mëvonshme të tij Zonjushat e Avignon-it) Por një nga tablotë më tronditëse të Gauguin është padyshim dhe autoportreti i tij i gjetur në shtëpi pas vdekjes "Autoportret pranë Golgotës", ku spikat dhimbja e pakufishme e një njeriu që kërkon një lloj shpëtimi. Por ai e ndjen se asgjë nuk mund ta ndihmojë tashmë. Bota e artit të metropolit ende e mban larg, në heshtje. Por ai e di se një ditë atje do ta duartrokas, por ai s'do të jetë më. A nuk kishte ndodhur kështu dhe me mikun e tij Van Gogh?... Kështu, vazhdimisht, gjithnjë e më shumë, ai mendonte të vriste veten. "Ah, vitin që shkoi, gabim që nuk e vrava veten!" – shkruante ai. Në nëntor të atij viti, Gauguin shkruan se

nga kjo botë "kërkon vetëm heshtje". Le ta lenë të lirë, të harruar, diku, larg... Ai nuk ha, nuk ka uri. E vetmja gjë që mund ta shpëtojë është piktura dhe ai ngrihet sërrish të pikturojë një tablo të re edhe pse kanavaca tashmë i mungon gjithnjë e më shumë. Duhet para. Në vitin 1899 e dashura e re Pau'ura vjen të jetojë me të. Në prill lindi një djalë, e quajten Emile dhe Gauguin ishte i lumturuar: ja më së fundi një fëmijë pranë tij. Ai kërkon që të shkruhet në bashkinë e Papete-s si ati i tij, madje kërkon të martohet me Pau'ura, por prifti nuk pranon, meqë ai figuron i martuar me dikë tjetër që është në Kopenhagë, edhe pse nuk ka asnjë lajm për të.... Në këtë kohë pikturon dhe tablonë Mëmësia e pastaj Dy tahitianet e po kështu "Te Aarii Vahine" (Vajza me mang), me një të verdhë të bukur dhe kontraste të forta siç dinte t'i krijonte vetëm ai. E dinte se ishin vepra të përkryera, siç i shkruante dhe galeristit të tij në Paris për një tablo që sapo kishte mbaruar: "Sapo kam krijuar një tablo që besoj se është nga më të mirat që kam bërë deri tani... një mbretëreshë lakuriq, shtrirë në një lëndinë jeshile, me një shërbyese që këput fruta"... e pak më vonë ai shtonte: "Ah, e çmendur, e trishtë dhe e keqe kjo aventura ime në Tahiti". Në vitin 1901 shkon të jetojë në ishullin pranë, HivaOa, ku janë 500 banorë. Peizazhi i ri e mrekullon, po kështu figurat njerëzore dhe shtëpinë e tij të re, të drunjte, ai e quan "Shtëpia e gëzimit". Paleta e tij tahitiane është e kuqja, okra, roza si dhe jeshilja e bluja e detit. Por ai gëzim ishte i përkohshëm. Ndërkohë ai largohet akoma më larg nga qendra e banuar për në ishujt Marqueses, një nga vendet

më të virgjëra, më të bukura e më të vetmuara, ku janë vendosur dhe disa misione fetare. "Në dritaren time, – shkruante ai, – këtu në Autona të Marqueses, gjithçka po errësohet, vallet kanë mbaruar, meloditë e ëmbla janë shuar. Por nuk është qetësi. Në kreshendo, era vërtitet nëpër degë dhe vallja e madhe fillon. Cikloni gjëmon. Olimpi shfaqet. Jupiteri ua dërgon rrufetë, titanët bien nga shkëmbenjtë dhe lumi del nga shtrati...". Një dekor i vërtetë vagnerian. Është 2 janari i vitit 1902. Shira të tmerrshme bien mbi shtëpinë e tij. Erërat e forta të furtunës apo një cunami, i marrin kasollen dhe ia çojnë tutje, mbi një shkëmb. Ishte forca e papërballueshme e natyrës. Një stuhi e paparë. Dhe për më tepër tashmë sëmundja e tij është bërë kritike. Ekzema e këmbëve e pengon të ecë dhe mjekimet e pareshtura nuk e mposhtin atë sëmundje të tmerrshme, ku për më tepër vuante dhe nga sifilisi. Tani merr morfinë që të qetësojë dhimbjet. Ashtu nëpër delirin e dhimbjeve ai vazhdon të pikturojë. E megjithatë është i kënaqur që pikturat e tij ndërkojnë po i vlerësohen dhe galeristi i tij Vollard i kërkon piktura të reja. Madje tashmë ai ka një pagesë mujore. Degas kishte blerë një tablo të Gauguin! Ja më së fundi vlerësimi. Piktorin e handakosur tutje botës tashmë po e vlerësonin dhe për më tepër piktorë me emër si Degas e të tjerë. I sëmure dhe në dhimbjen e madhe të vetmisë ai pikturon një tablo të madhe, më e madhja e tij ku poshtë shkruan: "Nga vijmë? Kush jemi? Ku shkojmë? Problem i përhershëm që godet krenarinë tonë. O dhimbje, ti je Zoti im!"... Dhe tabloja do të quhej "Nga vijmë? Kush jemi? Ku shkojmë?"

(D'où venons-nous? Qui sommes nous? Où allons nous?)... Një pyetje filozofike e ekzistencës njerëzore. Një ditë ulet dhe shkruan: "Mbrëmjen që shkoi pashë se kisha vdekur dhe u habita sepse ishte momenti kur vërtet e ndjeva veten të lumtur!"... Tashmë sëmundja po e dërmon gjithnjë e më shumë. Dhimbjet janë akoma më të mëdha. Morfinë, zvarritje, bojra, telajo, pikturë... atje i rrethuar nga tablotë, nderur në atë kasolle të mjerë. Ç'bënte ky piktor në fund të botës? Një mëngjes, një indigjen e gjeti pa frymë dhe shkoi të lajmërojë të tjerët: "I bardhi ka vdekur!"... "I bardhi ka vdekur!" Ishte data 8 maj 1903. Arkivolin për në varreza e shoqëroi prifti i ri dhe katër njerëz të mjerë të atij ishulli vullkanik që e mbanin për ta çuar në varrezat e misionit katolik në majë të kodrinës. Më vonë, një pllakë guri ishte vendosur në varrin e tij: "Ci-git Paul Gauguin, artiste français, juin 1848 – mai 1903, Société des études océaniques" (Këtu prehet Paul Gauguin, artist francez, qershor 1848-maj 1903, Shoqata e studimeve oqeanike"). Kur tablotë e Gauguin erdhën dhe një ekspozitë u hap, bota e artit të metropolit zbuloi atë që nuk e kishte kuptuar si dhe dramën e tij, zbuloi Gauguin-in si një artist të madh... Mjerisht, unë do t'i shikoja vonë riprodhimet e tablove të tij në botimet franceze që qarkulluan fshehurazi në Tiranë në vitin 1974. Ndërsa ngjyrat e pikturave të tij, ato që të rrëmbejnë dhe të çojnë larg Francës i pashë veçse kur erdha në Paris, në sallonet e Musée d'Orsay... Ai ishte atje, në një sallë më vete, me hirit dhe lavdet e piktorit të madh, me ngjyrat e forta që për një kohë të gjatë nuk më shqiteshin nga kujtesa...



NUMRI I ARDHSHËM MË 30 MAJ

# HEJZA

15 Maj, 2024

Kryeredaktor i Hejzës: **Avni Halimi** (avni65halimi@gmail.com)

Editon Produksioni **TAKAT STUDIOS**

Faqosjen dhe dizajnin:  
**Drian Shala - Shala & Rexhepi**

Rruga e Kaçanikut nr.208, Shkup, 1000